TITULLI I PROJEKTIT

LOTI 1: "HARTIM I PROJEKT PREVENTIVAVE TË ZBATIMIT PËR DISA SPITALE RAJONALE DHE BASHKIAKE"

SPITALI RAJONAL LEZHË

KLIENTI

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE

GRUPI I PROJEKTIMIT

ATELIER 4
ARCHITECTURE & CONSULTING STUDIO

Rr. e "Kosovarëve", Ndërtesa 35, Hyrja 6, Ap.4/1,
Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri
tel: +355 4 24 30 195 / 4 22 22 804
fax: +355 4 24 30 194
mobile: +355 69 20 38 958
e-mail: info@atelier4.al
web: www.atelier4.al

ARCHIMED S.P.S
CONSULTING & ENGINEERING STUDIO

Rr. "Zef Jubani", Pallati Bjorn, Nr. 7/3,
Tiranë, Shqipëri
tel / fax: +355 4 24 33 202
mobile: +355 69 21 05 507
e-mail: info@archimedsps.com
e-mail: archimedsps@gmail.com
web: www.archimedsps.com

KEJSI-05
CONSULTING & ENGINEERING STUDIO

Rr. "Zef Jubani", Ndërtesa 7, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri
mobile: +355 68 40 38 122
mobile: +355 68 20 77 941
e-mail: info@kejsi05.com
web: www.kejsi05.com

KODI I DOKUMENTIT

SRB	.	D	.	A	.		.	0
KODI		FAZA		DISIPLINA		KATI		RISHIKIM

NR. I VIZATIMIT

A - 00

EMËRTIMI I DOKUMENTIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

DATA: SHKURT 2019

PËRSHKRIMI I FAZËS

PROJEKT ZBATIM

RISHIKIM	DATA	FAZA E PROJEKTIT	RISHIKIM	DATA	FAZA E PROJEKTIT

PËRMBAJTJA

1. PARATHËNIE 1
2. PRISHJA E OBJEKTEVE EKZISTUESE DHE PASTRIMI I INERTEVE 1
3. PUNIME DHEU 8
4. STRUKTURA BETONI TE DERDHURA NE VEND 16
5. PUNIMET STRUKTURA METALIKE 27
6. ASHENSORËT 30
7. MURATURA 30
8. TARRACAT DHE TARRACAT ME STRUKTURE METALIKE 39
9. HIDROIZOLIMI 48
10. RIFINITURA E MURATURES 57
11. VESHJET E DYSHEMEVE DHE MUREVE (punime shtresa) 74
12. RIFINITURA E TAVANEVE 91
13. LYERJA DHE VESHJET 96
14. DYERT 101
15. DRITARET 116
16. PUNIME METALIKE 123
17. PUNIME SISTEMIMI Të JASHTME 125
18. PEIZAZHI 140
19. SPECIFIKIMI, MOBILIMI DHE INSTALIMI I NYJEVE HIGJENO-SANITARE 144

1. PARATHËNIE

Ky dokument, titulluar Specifikime Teknike, të cilave do t"u referohemi "ST" jane hartuar si pjese per realizimin e projektit: Loti 1 "Hartimi i projekt preventivave te zbatimit per disa Spitale Rajonale dhe Bashkiake" . Spitali Rajonal Lezhë.

Ky dokument te konsiderohet si pjese perberese e Dokumentacionit te Projektit Zbatimit dhe Preventivit Perfundimtar per objektin e mesiperm.
Informacioni i dhënë ka për qëllim specifikimin e punimeve dhe instalimeve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me standardet për të përmbushur objektivat e projektit. Kontraktoret e Punimeve te Ndertimit duhet t'u referohen specifikimeve teknike te atyre zerave te punimeve te cilat perfshihen ne pershkrimet e Vizatimeve, ne Preventivin Perfundimtar si dhe ne Pershkrimin e Punimeve.

Kapitulli 1 _ këto SPT duhet të lexohen së bashku me çdo detaj shtesë të përmendur në:

Kapitulli 2 Specifikimet Teknike për punimet Elektrike (STE)
Kapitulli 3 Specifikimet Teknike për punimet Mekanike (STM)
Preventivat e Punimeve (P)
Vizatimet në bazë të Listës së Vizatimeve
Raportet Teknike

1.1 SPECIFIKIMET TEKNIKE

Çdo kapitull kryesor përbëhet nga maksimumi TRE seksione për kapitull:

(Pjesa 1) E Përgjithshme:
Specifikimet e referencave të përgjithshme dhe procedurat.
(Pjesa 2) Produktet:
Specifikimet e të dhënave dhe kërkesave në lidhje me produktin.
(Pjesa 3) Ekzekutimi:
Specifikimi i proceseve të instalimit dhe ekzekutimit.
Të gjitha seksionet në një kapitull janë të lidhura me njëra-tjetrën .

Këto specifikime SPT janë të vlefshme, si për punimet e prishjeve, rikonstruksionin dhe ndertimin e ri.

2. PRISHJA E OBJEKTEVE EKZISTUESE DHE PASTRIMI I INERTEVE

2.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

2.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në sasinë e marrë në reference. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

2.1.1.1 Rregullat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

2.1.1.2 Deklaratat

Të paraqiten procedurat e prishjeve dhe të heqjes dhe largimit para se puna të fillojë. Duhet të parashikojne heqjen e kujdesshme, hedhjen e materialeve dhe koordinim me punë të tjera që vazhdojnë, një plan të nderprerjes së shërbimeve komunale, të gjitha lejet nga shërbimet komunale, një përshkrim të detajuar të metodave dhe pajisjeve që duhet të përdoren për secilin operacion dhe pasojat e operacioneve.

2.1.2 KËRKESAT

Puna përfshin pastrimin dhe heqjen e inerteve të treguara apo të specifikuara. I gjithë materiali që rezulton nga puna e prishjeve, përveç i asaj që është treguar/specifikuar ndryshe, duhet të largohet nga kantieri çdo ditë. Plehrat dhe mbetjet do të largohen nga kantieri çdo ditë, akumulimi i një materiali të tillë është i ndaluar si brenda edhe jashtë godinave. Materialet të cilat nuk mund të hiqen nga kantieri çdo ditë duhet të ruhen në mënyrë të duhur në zonat e përcaktuara. Duhet të jepen kontenierë të duhur për heqjen dhe largimin e mbetjeve të ndryshme të ndërtimit dhe duhet ti zbrazë këto sa më shpesh të jetë e mundur. Të gjithë kontenierët duhet të mbulohen gjatë të gjithë kohës në mënyrë që të parandalohet ngritja nga era e pluhurit dhe mbetjeve. Nëse identifikohen kalbësi në dru apo azbestos gjatë punimeve te prishjeve ai duhet të ndërmarrë masat e duhura parandaluese për shëndetin dhe sigurinë, te propozohen masat e duhura të eliminimit .

2.2 PJESA 2 - PRODUKTET

NUK APLIKOHET

2.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMI

2.3.1 GODINAT EKZISTUESE

2.3.1.1 Nënstacionet

Nënstacionet ekzistuese duhet të prishen përveç rasteve kur nuk kërkohet ndryshe. Të prishet çdo siperfaqe betoni përveçse kur thuhet ndryshe.

2.3.1.2 Kanalizimet dhe paisjet e nevojshme

Me kujdes të largohen shërbimet komunale ekzistuese të zbuluara nga puna siç është treguar dhe të përfundohet në një mënyrënë përputhje me rregulloret/udhëzimeve Evropiane të cilat mbulojnë shërbimet specifike dhe siç janë të udhëzuara nga Mbikëqyrësi. Nëse kanalizimet e shërbimeve komunale nuk tregohen në skica, të kontaktohet Mbikëqyrësi për udhëzime të mëtejshme.

2.3.1.3 Kanalizmet /shkarkimet e brendshme

Para se të fillojnë punimet e prishjes së objekteve ekzistuese, kanalizimet në zonën përkatëse duhet të hiqen nga funksioni në mënyrë që të parandalohet rivendosja në punë në mënyrë të paqëllimshme.

2.3.1.4 Prishja e suvatimeve

Gjatë shkatërrimit të elementëve të suvatuar si mure, suvaja duhet të pritet në mënyrë të pastër në limitet e seksionit të shkatërruar.

2.3.1.5 Shtrimet dhe soletat

Shtresat e betonit, asfaltit ose bitumi te priten në një thellësi prej 5 centimetrash poshtë nivelit ekzistues. Të mundësohen prerje të drejta dhe të rregullta në kufijtë e heqjes së shtresave. Matrapikët duhet të përdoren vetëm deri tek prerja e sharrës dhe nuk duhet të përdoren në vend të prerjes.

2.3.1.6 Betoni

Të kryen prerjet e betoni gjatesore të drejta në një thellësi prej jo më pak se 5cm.

2.3.1.7 Kunjat prej Druri

Gjatë punimeve te prishjes të gjitha kunjat prej druri duhet të hiqen nga muret dhe tavanet.

2.3.1.8 Muret

Gjatë prishjes të mureve dhe/ose modifikimeve për të hapur mure ose hapësira kujdes duhet treguar për të siguruar një përfundim të pastër në sasinë e seksioneve të prishura. Kujdes i duhet treguar që dyshemetë të mos mbartin goditje të shtuar që vjen si rezultat i mbetjeve që bien mbi të.

2.3.2 GËRMIMET

Të mbushen të gjitha gërmimet, kanalet e hapura dhe gropat, dhe hapësirat e tjera të rrezikshme në përputhje me masat e dhëna në kapitujt pasardhës.

2.3.3 RREGULLIMET

Kurdoherë që sipërfaqet ekzistuese të punimeve permanente dëmtohen nga kontraktori gjatë kryerjes së punimeve, Kontraktori duhet të riparojë, rregullojë dhe përfundojë sipërfaqe të tilla për ti ngjarë sipërfaqeve të tjera ngjitur të cilat janë të padëmtuara.

2.3.4 LARGIMI DHE E DREJTA E MATERIALEVE

2.3.4.1 Largimi i materialeve Ekzistuese dhe Pajisjeve

Përveç se aty ku tregohet ose specifikohet ndryshe në seksionet e tjera, të gjitha materialet dhe pajisjet e hequra dhe të mos ripërdorura, duhet të largohen nga kantieri.
Materialet dhe pajisjet nuk duhet të shihen nga blerësit perspektiv dhe as t'u shiten atyre në kantier.

2.3.5 KONTROLLI I ZHURMAVE DHE VIBRIMEVE

Në rastet kur prishjet ndodhin në godina që janë ende në funksionim; punimet intensive me zhurmë dhe tronditje nuk do të lejohen gjatë orarit normal të punës në mënyrë që shqetësimi mbi veprimet të ruhet në minimum. Koordinimi i punimeve të tilla do të kryhet me Mbikëqyrësin.

2.3.6 KONTROLLI I NDOTJES

Duhen ndermarre veprimet e duhura për të kontrolluar shpërndarjen e pluhurit dhe për të shmangur krijimin e papastërtive në zonën përreth. Te përmbushen të gjitha rregulloret mbi ndotjet të vendosura në kantier nga agjencitë vendore të ndotjes së ajrit. Gjatë prishjes së godinave që janë ende në përdorim, duhen përdorur rrjeta pluhuri për të mbrojtur nga pluhuri ne ajer, ato zona që ende do te jene ne perdorim. Kur prishen elementë të cilët përmbajnë materiale fibre, kujdes i veçantë duhet ndërmarrë për të

shmangur zhvendosjen e fibrave dhe në këtë mënyrë thithjen e tyre në rrugët e frymëmarrjes. Lagia e materialeve të tilla dhe përdorimi i maskave kundër pluhurit do të konsiderohet si masë minimale mbrojtëse. Ndalohet shpimi i materialeve fibroze.

2.3.7 MBROJTJA

2.3.7.1 Punimet Ekzistuese

Para fillimit të punimeve duhet inspektuar dhe identifikuar gjithë elementët ekzistues të cilët duhen ruajtur ose ripërdorur. Punime të tilla ekzistuese e cila është: (a) për të qëndruar në vend, (b), për tu ripërdorur, ose (c) të mbetet në kantier si pronë e Përfituesit, do të ruhet duke përdorur mbulesa të përkohshme, mbështetjen dhe ankorimin. Artikujt të cilat do të qëndrojnë dhe të cilat dëmtohen gjatë kryerjes së punimeve do të riparohen në kushtet e tyre fillestare ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e kontraktorit. Të mos mbingarkohen elementët strukturorë. Të mundësohen mbështetje të reja dhe përforcime për ndërtimet ekzistuese të dobësuara nga punimet e prishjes së ndërtesave. Nëse vërehet humbje e stabilitetit strukturor (shmangie të tepërta, kolaps, etj.), atëherë Kontraktori duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të siguruar punimet dhe të largojë dhe bllokojë zonën dhe të informojë Mbikëqyrësin.

2.3.7.2 Ulja e Materialeve

Kur materialet ose mbetjet ulen nga lartësitë, duhet pasur kujdes për të parandaluar tundjen e tyre, rënien ose projektimin e tyre në të tillë mënyrë tillë që të krijojnë rrezik për sigurinë e personelit ose pronës publike të çdo lloji.

2.3.7.3 Hinke Mbetjesh

Hinka e Mbetjeve për të transferuar mbetjet nga katet e sipërme të një godine për në kontenierë, duhet të jenë të lidhura në mënyrën e duhur dhe të instalohen nga personel me eksperiencë dhe duhet të jenë të izoluara tek puthitjet. Kontenieri pritës duhet të jetë i mbuluar me materialet e duhura, i cili në mënyrë respektive duhet të jetë i mbyllur rreth hinkes ndërsa futet në kontenier në mënyrë që të parandalojë pluhur të tepërt dalë nga kontenieri. Akses i sigurt dhe i duhur duhet të mundësohet në majë të hinkes për të siguruar kushte të sigurta pune gjate depozitimit te mbetjeve në rrëpirë.

2.3.7.4 Shërbimet Ekzistuese

Kabllot elektrikë ekzistues dhe përcjellësit të cilët duhet të mbeten duhet të shkëputen me kujdes nga lidhësit/ ankorimet e tyre (pa i shkëputur), të rivendosen larg rrugëkalimeve të operacioneve ndërtimore, dhe të ruhen nga dëmtimet. Para punimeve prishese Kontraktori do të kontrollojë vendndodhjen e shërbimeve të fshehura.

2.3.7.5 Dëmtimet gjate stines se Dimrit

E gjithë godina duhet të ruhet nga kushtet atmosferike dimërore, si për shembull ngrirja e tubacioneve të ujit etj., gjatë punimeve të prishjes së godinave ekzistuese.

2.3.7.6 Zëvendësimi i Dyerve dhe Dritareve

Gjatë zëvendësimit të dyerve dhe dritareve duhet të sigurohet se artikujt ekzistues hiqen dhe zëvendësohen në të njëjtën ditë në mënyrë që godina të jetë e sigurt gjatë natës.

2.3.7.7 Punimet në Tarraca

Gjatë punimeve në tarraca, duhet të sigurohet që godina të mbetet e izoluar ndaj motit gjatë të gjithë kohës. Materiale të përkohshme për tarracat duhet të mundësohen kur dhe ku të jetë e nevojshme. Në përgjithësi heqja e shtresave të tarracës do të kryhet me faza në bashkëveprim me punimet e tarracës, në mënyrë që kërkesa për tarracë të përkohshme të mbahet në minimum.

2.3.7.8 Periudhat e Mbylljeve

Gjatë periudhave të mos paraqitjes në kantier duhet të sigurohet që të gjitha punimet e përkohshme dhe të përhershme të jenë të sigurta.

2.3.8 SIGURIA DHE SHËNDETI NE KANTIER

2.3.8.1 Mbikëqyrja me Eksperiencë

Të gjitha punimet e prishjeve të godinave ekzistuese do të jenë nën një mbikëqyrje të përhershme nga një përgjegjës i kualifikuar dhe me eksperiencë.

2.3.8.2 Ruajtja e Këmbësorëve

Aty ku rrezikohet siguria e këmbësorëve dhe shoferëve nga punimet e prishjeve të godinave ekzistuese, përdorimi i barrikadave të trafikut me drita sinjalizuese (gjatë orëve të natës) dhe sinjalistika e duhur për të ridrejtuar trafikun larg zonës së prishjes së objekteve ekzistuese. Mundësoni mbulesa të rrugë kalimeve të përkohshme për të ruajtur kalimtarët.

2.3.8.3 Punimet me materiale të Nxehta

Ruajtja e cilindrave të gazit nën presion në depo, shkallë, korridore dhe rrugë shpëtimi është e ndaluar.

2.3.8.4 Veshjet e Sigurisë

Gjatë punimeve të prishjes së godinave ekzistuese, të gjithë punëtorët duhet të veshin rrobat e duhura të sigurisë duke përfshirë minimalisht mbrojtjen e syve, maskat e pluhurit, këpucët e sigurisë doreza të rënda pune dhe kapele sigurie.

2.3.8.5 Prerja e Metaleve

Gjatë punimeve prerëse përdorimi i trapanëve ose saldatriçeve dhe metodave të ngjashme veçanërisht në tunelet e shërbimeve Kontraktori duhet të sigurohet që shkëndijat dhe metali i shkrirë të mos bie në zonat e pakontrolluara.

2.3.9 SHËRBIMET E JASHTME

Të mbrohen të gjitha shërbimet elektrike dhe ato komunale. Duhet verifikuar rrjeti nëntokësor në kantier para fillimit të gërmimeve. Lejet për gërmime duhet të merren nga furnizuesit e shërbimeve Aty ku specifikohet apo tregohet spostimi i shërbimeve apo shtresave ekzistuese, të mundësohen barrikada, mbulesa të përkohshme të zonave të ekspozuara dhe shërbime të përkohshme dhe lidhje për sistemin energjik apo atë komunal. Nqs për prishjen e godinave ekzistuese përdoren pajisje mekanike si vinça, ekskavatorë apo pajisje hidraulike dhe thërrmues dheu, duhet pasur kujdes për tu siguruar që asnjë pjesë e

makinerive të tilla të mos bjerë në kontakt me kabllot elektrike ose telefonike nëntokësore ose mbitokësore ose në afërsi të tyre.
Në përgjithësi linjat ajrore të cilat kalojnë rrugët automobilistike ose shtigjet do të jenë qartësisht të shënuara duke përdorur shiritin e kuq/bardhë dhe me paralajmërimin "lartësia maksimale x,xxm" me tabelat e ngritura 5m në secilën anë të linjës.

2.3.10 SKELERIA

Të gjitha skelat do të jenë të përcaktuara dhe të ngritura në përputhje me standardet e duhura. Vetëm ngritësit e skelave me eksperiencë dhe kompetentë do të kryejnë ngritjen e skelave. Punimet në skelat e pa miratuara janë tërësisht të ndaluara.
Kujdes duhet ndërmarrë që ngarkesa e mbetjeve që qëndron në skela të mos tejkalojë ngarkesën maksimale të skelës. Ngarkesat maksimale të lejuara të skelës duhet të jenë qartësisht të dukshme në të gjitha pikat hyrëse në nivelin tokësor. Të gjitha masat e nevojshme duhen ndërmarrë për të parandaluar që mbetjet aksidentalisht të shkëputen nga platforma.
Skelat prej hekuri të tipit me këmbalec, në përputhje me standardet dhe rregullat vendase, duke përfshirë furnizimin e mbështetësve, mirëmbajtjen, montimin, ankorimin, çmontimin, etj., shtroje 15cm duhet të mundësohen në të gjitha nivelet. Shtresat ndaj motit ose të paktën një rrjetë mbrojtëse duhet të mundësohet nga jashtë skelës.

2.3.11 SHPËRTHIMET

Përdorimi i eksplozivit nuk lejohet.

2.3.12 DJEGJA

Djegia nuk lejohet.

2.3.13 PASTRIMI

2.3.13.1 Mbetjet dhe Plehrat

Nuk duhet të përdoren qese apo kazanë për plehra shtëpiake për të hequr mbetjet e ndërtimit ose materialin e shpërbërë, por duhet të përdoren materialet e duhura për largimin e materialeve të hedhshme ose mbetjeve dhe duhet ti transportojë këto materiale jashtë kantierit sa me shpesh të jetë e nevojshme. Largimi dhe transportimi i mbetjeve dhe plehrave në një mënyrë që do të parandalojë derdhjen e tyre në rrugë apo në zonat përreth.

2.3.13.2 Pastrimi

Godina duhet të pastrohet nga i gjithë pluhuri dhe mbetjet pas përfundimit të prishjes së objekteve ekzistuese.

2.3.13.3 Rregulloret

Të pajtohet në mënyrë strikte me të gjitha rregullat Shqiptare në fuqi për sa i përket eliminimit dhe hedhjes së mbetjeve të kantierit.

2.3.14 PUNIMET PËR PASTRIMIN E KANTIERIT

2.3.14.1 Heqja e pemëve dhe e shkurreve më të larta se 1,5m

Në përgjithësi duhet kushtuar kujdes gjatë punimeve të pastrimit për të mos dëmtuar ato pemë të cilat nuk pengojnë në rivendosje dhe në ndërtimin e një godine të re. Në rastet kur heqja e tyre është e nevojshme ose e specifikuar atëherë masat e duhura parandaluese duhen marrë për të mos dëmtar personelin dhe objektet rreth zonës së shembjes së objektit. Për pemë më të larta se sa 10m, prerja e tyre duhet kryer më ndarje prej 3m. Pjesa e prerë duhet lidhur me litarë ose e një kabull të balancuar dhe duhet ulur me litar ose me kabull të balancuar nga pjesa ku personeli ose godinat janë të sigurta.

2.3.14.2 Heqja e strukturave, rrethimeve

Duhet te të ulen me kujdes dhe të pastrohen vetëm ato struktura që jane udhëzuar.Pjesët përbërëse duhet të çmontohen, pastrohen, stivohen në grumbuj të veçantë. Materialet të cilat nuk janë për ripërdorim duhet të largohen nga kantieri në një vend grumbullimi.

2.3.15 PUNIMET E PRISHJES SË OBJEKTEVE EKZISTUESE

2.3.15.1 Çmontimi i çative

Çmontimi i çative dhe tjegullave ose mbulesave me fletë metalike dhe strukturave të tyre ndihmuese si trarë e të tilla, duke përfshirë materialet izoluese ose skeletet e përbëra nga trarë dhe ulluqe si dhe pjesët lidhëse duke përfshire edhe oxhaqet.

Shkatërrimi i izolimit të tarracave e çative duke përfshirë trarët mbajtës dhe nyje me suvatim si dhe punimet elektrike.

Heqja e shtresave hidroizoluese duke përfshirë dhe ato të kthyera, gjithashtu kur ato të kthyera gjenden pranë oxhaqeve, të përbëra prej shtresave bituminoze, ku përfshihet heqja e materialeve izoluese e fashat mbyllese metalike pranë parapeteve.

Prishja e shtresave ne sipërfaqet vertikale në një lartësi prej të paktën 30cm, për vendosjen e shtresave të reja izoluese kundër ujit.

2.3.15.2 Prishja e ndertimeve prej guri

Prishja totale ose pjesore e ndertimeve prej guri, duke përfshirë edhe punët deri në themele. Te merren të gjitha masat e nevojshme përforcuese për konsolidimin e strukturës dhe të godinave të tjera përreth (nëse ka).

2.3.15.3 Prishja e ndertimeve prej tulle

Prishja totale ose pjesore e punimeve prej tulle ose i elementëve prej tulle të parafabrikuara duke përfshirë edhe punimet me pllaka dhe themelet e tyre. Kontraktori duhet që gjithashtu të vë në dispozicion të gjitha masat e nevojshme përforcuese për konsolidimin e strukturës dhe të godinave të tjera përreth (nëse aplikohet).

2.3.15.4 Prishja e strukturave prej betonarmeje

Prishja totale ose e pjesshme dhe heqja e strukturave të përcaktuara prej betoni dhe elementëve duke përfshirë strukturat e tyre të themeleve.

2.3.15.5 Prishja dhe heqja e elementëve metalike dhe zgarave metalike

Heqja, prerja dhe ruajtja e zgarave metalike ose të elementëve të tjerë metalikë (p.sh. membranave strukturore) dhe zhvendosja e tyre brenda kantierit, duke përfshirë përzgjedhjen e tyre të mëvonshme dhe renditja e stivoja brenda kantierit në zonën e specifikuar për ripërdorim.

2.3.15.6 Struktura & elementët e ndotur

Duhet te hiqen te gjithë elementët dhe strukturat të cilat janë të identifikuara si të ndotura (nga vajra, kimike ose materiale të tjera të dëmshme para përdorimit) në një vend ndodhje të posaçme në bazë rregulloreve vendore dhe atyre Shqiptare.

2.3.15.7 Dheu i ndotur

Dheu nën këto struktura të ndotura duhet të emërohet si i rrezikshëm nga një specialist i liçencuar në lidhje me nivelin e tij ndotës ose duhet të hidhet në mënyrë direkte në një vend grumbullimi të specializuar siç është nënvizuar më lart (minimumi i nivelit të gërmimit prej nën 0,5m nën nivelin më të ulët të strukturës së themelit të gërmuar.

3. PUNIME DHEU

Punimet tokësore do të përfshijnë Gërmimin, Mbushjen dhe Ngjeshjen.

3.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

3.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në sasinë e marrë në reference. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë

3.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

3.1.2 PËRCAKTIMET

3.1.2.1 Shtresa e punueshme

Gërmimi i materialeve të shtresës së punueshme ose i formacioneve të dheut të paprekur, me grimca të vogla, materialet që i kanë rezistuar motit mbi sipërfaqe ose në mënyrë të drejtpërdrejtë poshtë tij si dhe ndonjë lëndë organike pjesërisht e tretur. Shtresa e punueshme e dheut mund të jetë me ngjyrë të errët, e shkrifët, me kripë ose material ranor me një përqindje të lartë të lëndëve organike të mirë tretura, që shpesh herë përmbajnë gjurmë nga një material i ngurtë. Materiali duhet të jetë përfaqësues i dheut prodhues aty pranë.

3.1.2.2 Materiali i Fortë

Gurët e qëndruar jashtë për një kohë të gjatë, depozitimet e dendura dhe të bashkuara, ose materialet e përbëra të cilat nuk janë të përfshira në përcaktimin e "gurit" por të cilat zakonisht kërkojnë përdorimin e pajisjeve të rënda të gërmimit, dhembë të fortë shpërbërës, ose matrapikë për heqje.

3.1.2.3 Material i cili nuk Lëviz

Gurët ose dheu me gurë në fund të transhesë i cili mbulon një material me të shkrifët ose një shtresë e veçantë për të shmangur çarjen e tubacioneve.

3.1.2.4 Materiali i cili nuk përmbush standardet

Dheu apo materialet e tjera të identifikuara që nuk kanë fuqinë dhe stabilitetin e duhur për të mbajtur mbi to peshën e caktuar në mbushje të transheve pa një ngjeshje të madhe ose që krijojnë humbje të stabilitetit. Gjithashtu materiali i cili hidhet për mbushje që përmban mbetje, materiale të ngrira, gurë të mëdhenj, plehra dhe materiale të tjera që mund ti shkaktojë kësaj mbushjeje të mos kompaktësohet.

3.1.2.5 Materiali i Paqëndrueshëm

Materiali në fundin e transhesë i cili nuk ka forcën për të ruajtur rregullsinë dhe që të parandaloje fugat qe mund te krijojne ndarje në tub, ose lëvizje të strukturës gjatë mbushjes. Ky material, ndryshe i identifikuar si i përshtatshëm i cili ka qenë i ngacmuar ose i ngopur me ujë.

3.1.2.6 Mbushja

Material i përdorur në mbushjen e transhesë ose të ndonjë gërmimi tjetër, është gërmuar në këtë kantier dhe duhet te jete pa gurë, ose materiale të huaja te tretura ose me përmbajtje argjitore.

3.1.2.7 Ngritja

Një shtresë dheu e vendosur për një mbushje tjetër, sipër dheut të papërgatitur ose jo të cilësisë së kërkuar te përdorur më parë.

3.1.2.8 Ngjeshja

Çdo metodë stabilizimi mekanik të materialit duke shtuar dendësinë e tij në kushte të kontrolluara lagështie. "Shkalla e Ngjeshjes" është marrë si një përqindje dendësise maksimale duke ndjekur procedurën e kërkuar të testimit.

3.1.3 RRJETI EKZISTUES

Vendndodhja e rrjetit ekzistuese tregohet si e përafërt. Duhet verifikuar vendndodhja dhe thellësinë /lartësinë e rrjetit ekzistues të treguar para fillimit të ndërtimit. Duhet të koordinohet përcaktimi i rrjetit /kanalizimeve ekzistuese.

3.1.4 MAGAZINIMI I MATERIALEVE

Materialet e gërmuara të klasifikuara si dhe' i kënaqshëm duhet të ruhen aty ku udhëzohet, deri në momentin kur kërkohen për mbushje ose rimbushje. Këto duhet të vendosen, gradohen dhe formatohen për kullimin e duhur dhe të ruhen në mënyrë të tillë që të mos lejohet ndotja dhe ndarja. Materialet e

kërkuara gjatë punës duhet të vendosen dhe të ruhen në një distancë të mjaftueshme nga cepi i gërmimeve për të parandaluar renien ose rreshkitjen gjate gërmimit dhe të parandalojë shkarjet. Materialet e mbetura si për shembull materialet e gërmuara të klasifikuara si të pakënaqshme, plehra, mbetje dhe teprica duhet të largohen dhe eliminohen në baze të udhëzimeve të Mbikëqyrësit.

3.1.5 KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Ekzekutimi duhet të kryhet si më poshtë:
Ngritjet /mbushjet në sipërfaqe duhet të jenë si të treguara.
Që asnjë tubacion ose pengesa të tjera artificiale përveç atyre të treguara do të shihen.
Që material i fortë nuk do të ndeshet.
Që uji nëntokësor eshte ai qe në bazë të shpimeve dhe skicave, në kohën e investigimit te kryer nën sipërfaqe, nuk përfaqëson domosdoshmërish rritje permanente të nivelit të ujit nëntokësor.
Në rast se kushtet aktuale ndryshojnë thellësisht nga ato të thëna ose treguara, pjesa e kontratës e cila tregon një rregullim për kushtet e ndryshuara aplikohet, në vartësi të kërkesave për lajmërim që jepen nga ai moment. Materiali i fortë duhet të përcaktohet si gur i palëvizshëm, masa jo të shtresëzuara por shumë të çimentuara të depozitave që përmbajnë karakteristikat e gurit solid jo zakonisht të hequra pa një shpim sistematik dhe shpërthim dhe çdo gur, tullë, ose beton përveç pllakave që i tejkalon 0.4 m3 në volum.

3.2 PJESA 2 - PRODUKTET

3.2.1 MATERIALET

3.2.1.1 MBUSHJA POROZE

Ku aplikohet një barrierë uji per kapilaritet (e treguar si mbushje poroze) nën pllakat e betonit, duhet të përmbajnë një gur të pastër të shtypur, zhavorr, ose çakell, 90-100 % duke kaluar në një sitë prej 20mm dhe me një kalim prej 0-5 % kalon një sitë 4,75mm me rërë të barabartë me jo më pak se 50. Mbushja me grimca mund të përbëhet me një kombinim të duhur të rërës dhe gurëve të shtypur për të përmbushur kërkesat për gradim si më sipër. Barrierat kapilare duhet të vendosen direkt mbi nënshtresë. Barriera duhet të ndërtohet në shtresa që nuk kalojnë 10cm trashësi të ngjeshur, dhe secila shtresë duhet të jete kompakte me një minimum të dy kalimeve të modelit të operimit me pllake.

3.2.1.2 MATERIALET E DHEUT

3.2.1.3 Shtresa e punueshme

Shtesa e punueshme duhet të jetë pa nënshtresa. Mbetje, trungje, gurë mbi 3cm, shkurre, barëra të këqij dhe materiale të tjera që parandalojnë rritjen e bimëve. Shtresa e punueshme do të merret nga një zonë e miratuar dhuruese e shtresës së punueshme.

3.2.1.4 Materiali i Kënaqshëm i Dheut

Materialet e kënaqshme të dheut të përdorura si rimbushje për transhetë, kullim dhe për strukturat duhet të përbëhen nga materiale vendase të klasifikuara si dhe nga rërë të mirë graduar, rërë me përmbajtje balte ose argjile të cilat janë të pastër nga mbetjet, rrënjët, drunjtë, materiale të tjera vegjetale si dhe plehra.

3.2.1.5 Mbushja Përzgjedhëse

Materiali i përzgjedhur për mbushje duhet të përbëhet nga rëra dhe gurët e shtypur. Rimbushja do të kryhet duke shtypur shtresat për të arritur nivelin e 96% të standardit Proctor në rastin e materialit të

ngjeshur, ose Id>0.67 në rastin materialit jo të ngjeshur. Materiali që duhet të përdoret do të miratohet nga Mbikëqyrësi.

3.2.1.6 Rërë Lumi

Rëra duhet të jetë rërë natyrore lumi, e përbërë nga grimca të forta dhe të pastra, të qarta në ngjyrë dhe në formë sferike. Rëra duhet të jetë e pastër dhe pa substanca organike, baltë, apo papastërti të tera. Përbërja e granulimit të rërës duhet të jetë nga 0,5mm deri në 1,0mm.

3.2.1.7 Materialet e Shtratit

Duhet të jetë rërë e imët dhe me një granulim nga 0 mm deri në3.0 mm.

3.3 PJESA 3 - ZBATIMI

3.3.1 PREGATITJA E SIPËRFAQES

3.3.1.1 Ruajtja e Shtresës së Punueshme

Dhe' i përshtatshëm për pastrim nga kantieri ku gërmimi kryhet dhe ndahet në mënyrë të veçantë nga materiali tjetër i gërmuar. Material i papërshtatshëm për tu përdorur si shtresë e punueshme do të largohet nga kantieri. Pozicionimi i shtresës së sipërme, në mënyrë që materiali të jete lehtesisht i lexueshem per shkallen e perfundimit. Kur të gërmohet shtresa e sipërme dhe ajo nuk përmbush standardet e kërkuara, duhet të mundësohen materiale të përshtatshme përdorimi te shtresës sipërme.

3.3.2 GËRMIMI

3.3.2.1 E përgjithshme

Gërmimi do të përfshijë heqjen dhe hedhjen e të gjithë materialit për të marrë të gjithë ngjitjet nën shkallë sipas specifikimeve.

3.3.2.2 Ruajtja e Personave dhe Pronës

Të gjitha gërmimet do të kryhen pas rrethimeve dhe të kenë shenja paralajmëruese gjatë orëve të natës. Strukturat, kanalizimet, trotuaret pllakat dhe ndërtimet e tjera menjëherë ngjitur me gërmimet do të ruhen ndaj dëmtimeve duke përfshirë zhvendosjen, lëvizjen anësore, heqjen e bazamentit dhe rrëshqitjet. Barrierat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që ngarkimi i mjeteve pranëgërmimeve të shmanget. Trungje parandaluese duhet të vendosen në cepin e gërmimeve për të parandaluar që mjetet të mos kalojnë në zonën e gërmimit kur ecin mbrapsht.

3.3.2.3 Gërmimi për Struktura

Gërmimi për strukturat duhet të konfirmojë me dimensionet dhe mbushjet e treguara me një tolerancë plus minus 15cm dhe do të shkojnë në një distancë të mjaftueshme nga themelet për të lejuar mundësi të mjaftueshme punimi minimalisht 50cm për vendosjen e formave të betonit, instalimin e shërbimeve dhe të ndërtimeve të tjera të treguara, si dhe për inspektim. Në gërmimet për bazamentin e themeleve, të bëhet kujdes që të mos ngacmohet fundi i gërmimeve. Në përgjithësi 10cm e fundit të gërmimeve duhet të largohen pak para se të hidhet betoni.

3.3.2.4 Gërmimi i Transheve

Gërmimi do të përbëhet nga gërmimi për themelet ose kanalizimet dhe transhetë e vendosjes së bimëve. Të pergatiten transhe aq vertikale sa të jetë e mundur përveç se kur lejohet skarpata.

3.3.2.5 Gërmimi për Gropat e Ndërtimit dhe Themelet

Punimet e Gërmimit duhet të përfshijnë gërmime për thellesi gropash te pjerrta apo te drejta ne varesi të godinave duke përfshirë përgatitjen themeleve, duke niveluar dhe ngjeshur. Për më tepër duhet të përfshijë gërmimet për thellesi gropash ndertimi duke përfshirë transportin deri në 2km dhe të mbushë dheun duke e ngjeshur.

3.3.2.6 Gërmimi për Zonat e Shtruara

Gërmimet do të kenë në përbërje të tyre klasifikimin për zonat e shtruara; gërmimi dhe nxjerrja e të gjithë materialeve të papërdorshme pavarësisht karakterit të tyre, nga nënshtresat; dhe hedhjen e të gjithë materialit të gërmuar, siç është specifikuar në përputhje me vijat, klasifikimet, seksionet dhe dimensionet e përcaktuara në skica, dhe për të zëvendësuar materialet e papershtatshme nga germime te tjera dhe operacione klasifikuese.

3.3.2.7 Gërmimet e Paautorizuara

Gërmimet e paautorizuara të cilat përmbajnë heqje materialesh përtej ngritjeve të treguara të nënshtresave ose të dimensioneve anësore pa miratimin specifik të Mbikëqyrësit do të rivendosen pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues. Gërmimet e paautorizuara në bazamentin e themeleve prej betoni ose me një mbushje të përzgjedhur të mirëngjeshur, pa ndryshuar lartësinë maksimale të miratuar. Kudo që të kryhen gërmimet e paautorizuara do të rimbushen dhe ngjeshen në baze të klasifikimit të gërmimeve të autorizuara.

3.3.2.8 Qëndrueshmëria e Gërmimeve

Anët e gërmimeve mbi një thellësi prej 1,5m duhet të jenë me pjerresi, me kënd mbështetës për materialin e gërmuar, ose do të mbahen dhe lidhen aty ku animi nuk është i mundur ose sepse ka kufizime në hapësirë ose për arsye të materialeve të gërmuara. Anët dhe pjerresite e gërmimeve do të ruhen si të tilla deri në perfundim te mbushjeve apo vendosje në kushte të sigurta deri në sistemim ose lidhje. Kujdes i duhet kushtuar për të parandaluar rrezimin e aneve, kur gërmimet janë subjekt i lëkundjeve nga trafiku i mjeteve ose veprimit të makinerive apo nga ndonjë burim tjetër.

Materialet e gërmuara nuk duhet të jenë pranë buzez të skarpates se perforcuar, por në largësinë jo më shumë se një e treta e thellësisë së transhesë. Për transhetë e pa perforcuara, kjo distancë do të varet nga thellësia e gërmimeve, përmbajtja e lagështisë dhe fuqia ngjitëse e materialit dhe profili i gërmimit. Në përgjithësi, materiali i gërmuar duhet të vendoset jashtë me një anim prej 45 gradësh që kalon nga fundi i gërmimit.

3.3.2.9 Perforcimet dhe Mbeshtetjet

Materialet e përdorura për perforcimin dhe mbeshtetje, si nyje e formave dhe madhësive të ndryshme duhet të jenë në kushte të mira shërbimi. I gjithë druri i përdorur duhet të jetë i mirë dhe pa nyje të mëdha e të hapura. Perforcimet dhe mbështetjet në gërmime duhet të ruhen pavarësisht kohëzgjatjes së gërmimeve ose kohës që gërmimi qëndron i hapur. Të gjitha perforcimet dhe mbështetjet duhen çuar ne

nivelin e gërmimeve. Kurdoherë që heqja e tyre mund të lejojë lëvizje anësore të dheut nën strukturat ngjitur, duhet të përdoret dru i presuar dhe platforma metalike si dhe të lihen e te priten në mënyrë permanente në vend, në bazë të kërkesës.

3.3.2.10 Largimet e Ujrave

Gërmimet duhet të kryhen në një mënyrë që të parandalojnë ujin sipërfaqësor ose nëntokësor, të përmbytë kantierin dhe zonën përreth. Uji nuk duhet lejuar që të grumbullohet në gërmim.
I gjithë uji duhet të largohet nga gërmimet në mënyrë që te mos ndodhe paqendrueshmeria e fundit të themeleve, animi i pilotave dhe ndryshimet në dhe' që përkeqësojnë qendrueshmerine e nënshtresave dhe të themeleve. Pompat thithëse dhe linjat e shkarkimit si dhe sistemet e tjera të largimit të ujit me gjithë përbërësit e tyre duhet të mundësohen dhe të mirëmbahen sipas nevojës për të çuar ujin larg gërmimeve. Operacionet e heqjes dhe largimit të ujit duhet të jenë të vazhdueshme deri në rimbushjen totale dhe deri në momentin kur ndërtimi i cili është subjekt i presionit të ujit, të ketë marrë fuqinë e nevojshme. Në të gjitha hapat, operacionet e largimit të ujit duhet të vazhdojnë sa kohë që uji mund të futet ose mblidhet në gërmime. Uji i larguar nga gërmimet dhe uji i shiut duhet larguar në kanalizimet ujëmbledhëse sipas miratimit të Mbikëqyrësit. Kanalet e përkohshme të tharjes dhe shmangiet e tjera duhet të jepen dhe ruhen jashtë kufijve të gërmimeve për secilën strukturë. Përdorimi i gërmimeve të skarpatave për shërbime në kantier si kanalizime te përkohshme të tharjes nuk do të lejohen.

3.3.3 RIMBUSHJE & MBUSHJE

3.3.3.1 E përgjithshme

Rimbushja do të konsistoje në vendosjen e materialit të specifikuar rimbushës, në shtresa, në gërmimet e nënshtresave të treguara. Mbushja duhet të përbëhet nga vendosja e materialeve të specifikuara në shtresa, mbi sipërfaqen e tokës për nivelin e treguar, për çdo zonë siç është klasifikuar më poshtë:

3.3.3.2 Rimbushje dhe Materialet Mbushes

Materialet e dheut për rimbushje duhet të jenë të pastra nga mbetjet e argjilës, gurë ose zhavorr më të mëdhenj se 6cm. Mbetjet dhe ndonjë material tjetër i dëmshëm i çdo madhësie duhet të hiqet. Mbushjet duhet të jenë me material të kënaqshëm.

3.3.3.3 Përgatitja e Sipërfaqes se Tokes per mbushje

Bimësia, mbetjet, materialet e dheut të cilat nuk janë të kënaqshme, pengesat dhe materialet e dëmshme duhet të largohen nga sipërfaqja e nivelit te tokes para vendosjes së mbushjes. Sipërfaqet e pjerrta me pjerresi nga nje vertikale ne katër horizontale, duhet të plugohen, pastrohen ose tharmohen në të tillë mënyrë që materiali mbushës të lidhet me materialin ekzistues. Kur sipërfaqja e tokës ka një dendësi më pak se sa ajo e specifikuar për zonën e veçantë të klasifikuar, sipërfaqja e dheut duhet të copëtohet, kthehet në pluhur, dhe te permbaje kushte lageshtie më të mirat e mundshme të materialit të dheut në thellësinë e kërkuar dhe përqindje dendësisë maksimale.

3.3.3.4 Rimbushja e Transheve

Transhetë duhet të rimbushen me kujdes me materialet e specifikuara dhe depozituar në shtresa maksimale prej 15 cm, ne thellësi të lirë. Materiali i nevojshëm përreth (për sa i përket fundit) duhet të barazohet nga të gjitha anët e kanalizimeve në të gjithë gjatësinë, dhe duhet të ngjeshet tërësisht dhe me kujdes deri sa

kanalizimi të ketë një shtresë mbuluese prej jo më pak se 30cm. Duhet pasur kujdes që tubacioni ose kanalizimet të mos dëmtohen, apo lyerjet dhe bojërat speciale që rrethojnë kanalizimin ose tubacionin. Pasi të vendoset kjo shtresë, duhen vendosur shenja dalluese/treguese për kanalizimet përkatëse. Pjesa tjetër e materialit rimbushës duhet të depozitohet në transhe në shtresa të pangjitura prej 30cm dhe të ngjeshet me makineri ngjeshëse të operuara me dorë. Transhetë dhe gropat e gërmimit që nuk janë mbushur siç duhet aty ku ndodh sedimentimi, duhet të rihapen në thellësinë e kërkuar për të marrë ngjeshjen e duhur e më pas të rimbushen dhe ngjeshen me sipërfaqen e kthyer në shkallën e kërkuar të ngjeshjes.
Për të parandaluar humbjen e materialit nëpërmjet efekteve të drenazhimit në materialin e poshtëm dhe atë përreth në transhetë e pjerrta, barriera te papershkrueshme materiali si masa argjirore, duhet të instalohen në të gjithë gjerësinë e gërmimit të paktën 30m me qendër të matur përgjatë vijës së transhesë.

3.3.3.5 Përgatitja nën Shtresore për Zonat e Shtruara

Pas perfundimit te fazes dhe menjëherë përpara depozitimit të materialit sipërfaqësor, nënshtresa duhet të sillet në trajta te duhura, sipas kategorise dhe prerjeve te duhura te dhena në përputhje me këto specifikime. Të gjitha gropat dhe shtypjet duhet të hiqen duke i tërhequr dhe me teh në mënyre që të sigurohet njëtrajtshmëri në sipërfaqe. E gjithë nënshtresa duhet të sillet në një sipërfaqe të fortë dhe kompakte, në një vijë të drejtë duke rrotulluar mbi to rrulat e miratuar, deri sa të ngjeshet tërësisht. Ky veprim duhet të përfshijë lagien dhe riformatimin e kërkuar për te marrë ngjeshjen e duhur. Të gjitha vendet e buta dhe jo kompakte duhet të hiqen tërësisht dhe hapësira të rimbushet me materialin e përshtatshëm dhe të ngjeshet tërësisht. Në ato zona duhet vendosur nje shtrese stabilizuese, nga lart nën shtresa nuk duhet të tregojë një devijim më të madh se sa 12mm. Ngjeshja e nënshtresave duhet të shtrihet deri tek anët për një distance prej të paktën 30cm përtej skajit të shtreses stabilizuese apo shtrimit. Nënshtresa duhet të mirëmbahet në kushtet e përfunduara deri kur të jetë vendosur shtresa e pare e sipërfaqes.

3.3.3.6 Përgatitja për Zonat e Mbjella

Zonat e mbjella duhet të kategorizohen nga dimensionet, pamjet dhe prerjet e tyre sipas treguesve në skica. 10 cm e sipërm të këtyre zonave do të përbëhen nga dhe' i punueshëm, i cili duhet të ngjeshet lehtësisht. I gjithë materiali poshtë shtresës së punueshme duhet të ngjeshet sipas specifikimeve për përgatitjen e nënshtresave.
Shtresa e punueshëm do të përhapet në mënyrë uniform në zonat e përcaktuara dhe të përhapet në mënyrë të barabartë më një trashësi mesatare prej 10cm me një trashësi minimale prej 8cm. Para se të hidhet shtresa e punueshme, nënshtresa e ngjeshur nga trafiku mbi të apo shkaqe të tjera, duhet lehtësuar me përdorim të diskut ose plugës në një thellësi prej 6cm për të lejuar lidhjen e nënshtresës. Shpërndarja duhet të kryhet në të tillë mënyra që mbjellja të mund të vazhdojë me pak përgatitje të dheut ose plugim. Çdo rregullsi në sipërfaqe e cila rezulton nga hedhja e shtresës së punueshme ose e ndonjë veprimi tjetër do të korrigjohet në mënyrë që të parandalojë formimin e gropëzave ku mund të mblidhet uji. Shtresa e punueshme nuk do të vendoset kur nënshtresa është tepër e lagur, tepër e thatë ose në kushte të këqija për plugimin e duhur.

3.3.4 NGJESHJA

3.3.4.1 E Përgjithshme

Ngjeshja e materialeve të dheut për rimbushje dhe mbushje, do të kryhet me përdorimin e pajisjeve ngjeshëse të përshtatshme për materialin e dheut që ngjeshet për përdorim në zonën ku po punohet. Ngjeshja e dheut duhet të kontrollohet gjatë ndërtimit për përputhshmëri në përqindje te dendësisë maksimale për çdo klasifikim zonal sipas specifikimeve.

3.3.4.2 Vendosja dhe Ngjeshja

Materiali mbushës dhe rimbushës do të vendoset në shtresa prej jo më shumë se 15 cm në thellësi. Para ngjeshjeve, çdo shtresë mbushëse ose rimbushëse duhet të njomet ose ajroset sipas nevojës për të dhënë përqindjen optimale të lagështisë së materialit të dheut. Materiali mbushës dhe rimbushës do të jetë i ngjeshur me dendësi maksimale prej 95% në një thellësi prej jo më pak 25cm për çdo klasifikim zonal në bazë të specifikimeve. Asnjë material mbushës ose rimbushës nuk do të vendoset në sipërfaqet të cilat janë me baltë, të ngrira ose që përmbajnë ngrica apo akull. Materialet për mbushje dhe rimbushje pranë strukturave duhet të sillen në mënyrë të barabartë rreth strukturës në thellësinë e materialit të mbushjes ose të rimbushjes (të matur nga fundi i themeleve ose i mureve mbajtës) deri në nivelin përfundimtar, e duhet të ngjeshen me makineri ngjeshëse të operuara me dorë. Mbushjet poroze duhet të ngjeshen me minimumin dy kalime të një ngjeshësi lëkundës të operuar me dorë.

3.3.4.3 Ngjeshja

Dheu i nënshtresës në prerje duhet të ketë një dendësi prej ta paktën 95% në thellësinë 25cm nën sipërfaqen e nënshtresës. Mbushjet, anët dhe/ose rimbushjet poshte soletes se betonit dhe 30cm e sipërme në zonat e shtruara duhet të ngjeshen në jo më pak se 95% të dendësisë maksimale; rimbushjet e tjera pranë por që nuk mbështesin elementë strukturorë të paktën 90%. 30 cm e sipërm të transheve duhet të ngjeshen në të paktën 95% si dendësi maksimale.

3.3.5 GRADIMI

3.3.5.1 E Përgjithshme

Të gjitha zonat brenda kufizimeve të shkalles nën këtë seksion, duke përfshirë zonat e kalimit do të jenë ne shkalle uniforme. Sipërfaqet e përfunduara do të sheshohen me tolerancat e specifikuara.

3.3.5.2 Zonat me Bar

Zonat me siperfaqe te perfunduar për të marrë shtresen finale nuk do të jetë më shumë se 3cm mbi ose nën pamjet e treguara nënshtresa.
Përqindja minimale me peshë të farës së gjallë do të jetë 88%.
Plehu do të jetë 12% nitrogjen, 18% fosfor dhe 12% potasium (12-18-12) dhe në përbërje uniforme, me derdhje të lirë dhe i përshtatshëm për përdorim
Nivelimi:
Parregullsitë në sipërfaqe nga plehërimi ose veprime të tjera duhet të nivelohen përpara se të hidhet fara.
Mbjellja e farave:
Të gjitha punimet e farave do të kryhen gjatë sezonit më të favorshëm të mbjelljes për speciet e përcaktuara.

3.3.5.3 Zonat e trotuareve

Sipërfaqja e zonës nën trotuare do të trajtohet në kufi, sipas shkalles, prerjeve dhe rifinitures sipërfaqja e përfunduar nuk do të jetë më shumë se 1-2cm poshte pamjeve te shtresave të treguara.

3.3.6 PERPUNIMI I ZONAVE TË NGJESHURA

Ku është e duhur zonat e ngjeshura mund te preken nga ndërtimet e mëpasshme ose moti i keq, sipërfaqja duhet të riformulohet dhe ngjeshet siç specifikohet më lart, në dendësinë para se të kryhen ato ndërtime, ri-ngjeshja mbi kanalizimet nëntokësore duhet të kryhen me makineri të operuara me dorë.

3.3.7 MARRJA E KAMPIONEVE DHE TESTIMET

3.3.7.1 Testimi

Të gjitha testimet duhet të kryhen siç specifikohet më poshtë:

3.3.7.2 Testimi i mbushjeve me grimca

Testi i gradimit duhet të kryhet në çdo shembull. Testet duhet të kryhen për çdo 100 m3 material të përdorur ose një pjesë e saj dhe kurdoherë që ndryshon burimi.

3.3.7.3 Testi i Ngjeshjes

Testet e ngjeshjes duhet të kryhen në vendndodhje si më poshtë:

Materialet	Frekuenca e Testeve
(1) Mbushje dhe rimbushjet	1 për ngritje për çdo100m2
(2) nënshtresa (dendësia që është në vend)	1 për ngritje për çdo800m2
(3) mbushja e transheve poshtë shtresave	1 për ngritje për çdo200m transhe

4. STRUKTURA BETONI TE DERDHURA NE VEND

4.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

4.1.1 REFERENCAT

Standartet e references jane standartet shqiptare dhe standartet e vendeve te bashkimit Evropian EEC si dhe ato te Shteteve te Bashkuara (AFNOR, ASTM, AASHTO etj) qe konsiderohen si ekuivalente.
Sipermarresi per standartet duhet paraprakisht te marre miratimin e Supervizorit te punimeve perpara fillimit te punimeve.

4.1.2 Njesite

Dokumentat dhe specifikimet teknike jane hartuar duke perdorur sistemin metrik nderkombeter (SI) te njesive. Ne kete specifikim perdoren shkurtimet e meposhtme:

Njesite	Shkurtim
Milimeter	mm
Meter (linear, katror, kub)	m, m^2, m^3
Diameter	D
Ore	h
Litra	L
Rezistenca	MPa
Rezistenca	N/mm^2

Ngarkesa	Ton, [kg]

4.1.3 Ligjet dhe Normat e aplikueshme

a) Normat Shqiptare

b) Normat dhe standardet Evropiane

DIN EN 12350-1 : 2001	Kampionet e betonit të marra në kantier
DIN EN 12390-2	Përgatitja e testeve të betonit
DIN EN 12504-1	Kampionet e betonit të forcuar
DIN EN 12390-3	Testet ne shkatërim të betonit ne shtypje
DIN EN 934-2	Perzjeresit e betonit dhe metodat e kontrollit
DIN EN 206	Betoni, specifikimet, performanca, prodhimi dhe konformiteti
DIN EN 12350-2	Testimi i betonit te Freskët –Testi i konsistences se betonit te fresket
DIN 18331	Procedurat e kontratës së ndërtimit (VOB) Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike në kontratat e ndërtimit . Punimet me beton
DIN 18541-1	Rripat ngjitës termoplastik waterstop per mbylljen e nyjeve te strukturave te betonit. Format, dimensionet, standartet.
DIN 18541-2	Rripat ngjitës termoplastik waterstop per mbylljen e nyjeve te strukturave te betonit. Testimet dhe inspektimet ne kantjer.

4.1.4 DOKUMENTACIONI

a) Të dhënat e Prodhuesit

Per cdo material te perdorur ne kantjer duhet te mbahen dhe te paraqiten paraprakisht tek mbikqyresi i punimeve certifikatat dhe karakteristikat teknike. Per perdorimin e materialeve te ndertimit duhet te merret miratimi me shkrim nga supervizori i punimeve.

b) Vizatimet Teknike

Nga fillimi i punimeve ne kantjer inxhinieri i kantjerit dhe supervizori duhet te pajien me dokumentacionin teknik te projektit.

Dokumentacioni teknik permban te gjithe dosjjen e vizatimeve teknike te nderhyrjeve ne strukturat ekzistuese dhe ne ndertimet e reja.
Permasat dhe pozicionet e elementeve strukturale duhet te verifikohen ne vend. Kjo kerkese eshte shume e rendesishme ne rastin e nderhyrjeve ne strukturat ekzistuese pasi mund te kete nderhyrje te realizuara ne kohe te mevoneshme nga ndertimi fillestar dhe te pa dokumentuara.
Vizatimet teknike per strukturat betonarme paraqesin dimensionimin e kallepeve dhe detajimin e armatures se celikut per cdo element struktural.
Gjate zbatimit te merret parasysh fakti se gjatesite e xhuntimit te shufrave jane dhene ne vlerat minimale te tyre. Cdo ndryshim duhet te jete ne vlera me te medha se ato te percaktuara ne vizatimet teknike
Vizatimet teknike per strukturat metalike paraqesin dimensionimin per cdo element struktural.
Gjate zbatimit ne nderhyrjet e strukturave ekzistuese permasat duhet te verifikohen ne vend.

4.1.5 DORËZIMI DHE RUAJTJA E MATERIALEVE.

Materialet e paketuar duhet të dorëzohen në vendndodhjen e projektit në kopje origjinale te tyre, te paketuar ne pako apo kontenier të pahapur. Pakot duhet të mbajnë emrin e prodhuesit qartësisht të identifikueshëm, emrin e markës, materialin, peshën ose volumin, dhe informacione të tjera identifikuese, të ruajtura në origjinalin e tyre, pako ose kontenier të pathyer në një vend të thate dhe padepërtueshëm nga agjentet atmosferike, deri sa të jenë gati për përdorim. Përbërësit e papaketuar duhet të ruhen në mënyrë që të evitohen ndotje nga materialet e tjera.
Armatura e celikut duhet te depozitohet në grumbuj të veçante, mbi toke për të shmangur ndryshkjen, ndotjen nga ndotësit si graso, vaj, pluhur etj. Per cdo paketim te thyer apo te hapur duhet te behet identifikim i sakte.
Betoni plastik i pergatitur duhet te jete i gatshëm per kantjer pasi te jene realizuar kallepet dhe te jete lidhur armatura e celikut per strukturat betonarme.
Soletat e parafabrikuara qe perdoren kryesisht ne mbulesen e depos se karburantit do të dorëzohen dhe ruhen në kantjer pa u dëmtuar.

4.1.6 CILËSIA E BETONIT

Betoni klasifikohet bazuar ne:
a) Rezistencen
b) Klasen e ekspozicionit
c) Klasen e konsistences se betonit plastik
a) Rezistenca e betonit identifikohet nepermjet klasave te rezistences se betonit sipas tabeles me poshte. Perdorimi sipas Euronormave percaktohet per cdo element nese nuk percaktohet ndryshe ne projekt.

Klasat e rezistences se betonit	
C 8/10	Beton mbushes
C 12/15	Shtresa
C 16/20	
C 20/25	Themele, kolona, trare, soleta
C 25/30	Themele, kolona, trare, soleta
C 30/37	Themele, kolona, trare, soleta
C 35/45	Suporte, ura, vepra te rendesise te vecante
C 40/50	
....	....
C 100/115	Ultra performance

b) Klasa e ekspozicionit percaktohet sipas pozicionimit te elementit ne strukture.

Klasa e ekspozicionit	Veprimi
XC	Karbonatizim
XD	Kloride
XS	Uji i detit
XO	Korrozioni
XF	Ngricat
XA	Kimik

c) Klasa e konsistences se betonit plastik

EN		
Klasa	Perdorimi	Masa e hapjes [mm]
S1	Cati, mbushje,	10 deri 40
S2	Themele, soleta, struktura te tjera	50 deri 90
S3	Themele, soleta, beton i pompueshem	100 deri 150
S4	Themele, soleta, shtresa, beton i pompueshem	160 deri 210
S5	Nivelim	>210

Klasat e rezistences percaktojne paraprakisht perdorimin e betonit ne elementet e vecante strukturale. Percaktimi perfundimtar merr ne konsiderate edhe faktoret e tjere si klasen e ekzpozicionit te elementit dhe klasen e konsistences.
Per cdo element prej betoni ose betoni te armuar identifikimi i klases se betonit te perzgjedhur duhet te plotesoje tre tabelat e mesiperme nese nuk ka specifikim tjeter ne projekt.

4.2 PJESA 2 - PRODUKTET

4.2.1 BETONI DHE BETONI I ARMUAR

4.2.2 Kërkesat e rezistences

Rezistenca e betonit duhet te plotesoje kerkesat sipas projektit teknik per nderhyrjet strukturale ne godinat ekzistuese dhe ndertimin e lementeve apo strukturat e reja.
Referuar projektit teknik struktural klasa e betonit e kerkuar eshte C30/37.
Per punimet e tjera si shtresa, mbushje punime jo strukturale kerkesat per punime betoni i referohen tabelave te seksionit 1.6.

4.2.3 Cilësitë e betonit

Të përgjithshme

Betoni duhet të ketë një shtangesi minimale ngjeshjeje siç është treguar, në tabelën e paragrafit 6.2.1.1 vetëm nëse përcaktohet ndryshe.

Betoni duhet te plotesoje testet e rezistences per mostrat standarte kubike me brinje 15cm ose cilindrike me lartesi 30cm dhe diameter 15cm pas 28 ditesh i trajtuar ne kushte temperature dhe lageshtie standarte.

Betoni i gatshëm

Sipas DIN EN 206-1. Betoni i gatshëm është përcaktuar në specifikime si beton i prodhuar nga ndërmarrje tregtare dhe të dërguara tek blerësi në gjendje plastike. Betoni i gatshëm duhet përdorur nëse:
Fabrika ka kapacitete të mjaftueshme dhe pajisje transportimi për të dërguar betonin në normën e dëshiruar.
Intervali ndërmjet ngarkesave për zbrazje nuk i kalon 30 minuta.
Koha e shkuar ndërmjet hedhjes së ujit ne përpërzierje me çimenton dhe agregatet, ose çimentos me përbërësit, dhe vendosjes së betonit në pozicionin përfundimtar në forma, nuk duhet të kalojë me shume se një orë.
Betoni i gatshëm duhet të përzihet dhe dërgohet sipas një nga mënyrat e mëposhtme:

Përzierje qendrore

Përzierja qendrore duhet bërë duke përzier betonin plotësisht në një mikser të palëvizshëm në fabrikë dhe betoni i përzier të transportohet në vendndodhjen e punës me një betoniere ose me një mjet përzierës që punon gjte transportit.

Përzierje tranzite

Përzierja transite duhet bërë në një betoniere. Përzierësit dhe tundësit duhen drejtuar brenda limiteve të kapacitetit dhe shpejtësisë së rrotullimit të përcaktuar nga prodhuesi, dhe duhet të jenë të aftë të prodhojnë një përzierje homogjenë dhe me ngjyrë uniforme.

Çimento

Ne pergjithesi duhet të jetë çimento Portland, nëse nuk është percaktuar ndryshe. Çimento Portland duhet të jetë në përputhje me (DIN 1164) ose (EN-2). Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të sjellë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standardeve.

Uji

Uji duhet të jetë i freskët, i pastër jo agresiv ndaj perberesve te betonit. Uji qe do te perdoret ne prodhimin e betonit duhet te jete i paster nga substancat qe demtojne ate si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe subtsanca te tjera organike. Ne pergjithesi, uji i tubacioneve te furnizimit te popullsise (uji i pishem) rekomandohet per perdorim ne prodhimin e betonit.

Agregatet

Agregatet për betonin duhet të jenë në përputhje me standardet ISO apo standarde të barasvlefshme. Klasa duhet jetë e tillë që të prodhojë beton me përmasa dhe dendësi te caktuar sipas kerkesave te projektit dhe që të jetë i gatshem per tu perdorur. Madhesia e agregateve te holle dhe te trashe percaktohet ne varesi te klases se perzgjedhur te betonit. Per rastein e betonit te kerkuar ne projekt nuk duhet te kaloje madhesine 22mm.

4.2.4 Depozitimi i materialeve

Depozitimi i materialeve qe do te perdoren per prodhimin e betonit duhet te plotesoje kushtet e meposhtme:

• çimentoja dhe perberesit duhet te depozitohen ne ate menyre qe te ruhen nga perzierja me materiale te tjera, te cilat nuk jane te pershtatshme per prodhimin e betonit dhe e demtojne cilesine e tij.
• çimentoja duhet te depozitohet ne ambjente pa lageshtire dhe qe nuk lejojne lagien e saj nga uji dhe shirat.

Aditivet

Përzierësit shtese për betonin duhet të jenë sipas DIN EN 206-1. Suplementet shtese per përzierje duhet të jenë nga i njëjti prodhues i përzierësve shtese, ose duhet të jenë certifikuar për të qenë të pajtueshëm me të githë elementet perberes te betonit per te arritur rezistencat e kerkuara.

Armatura

Sipas ENV 10080 armatura duhet të jetë çelik i vjaskuar me rezistence 500 N/mm^2 dhe me diametër minimumi 6mm. (BSt 500 S gjermane sipas DIN 488).
Karakteristikat dhe perberja e celikut te armatures per strukturat betonarme duhet te kontrollohen paraprakisht sipas certifikates se prodhimit.
Testet e provave ne terheqje dhe perkulje duhet te realizohen paraprakisht per te kontrolluar cilesine e celikut e krahasuar me certifikaten e prodhimit.

4.3 PJESA 3 - ZBATIMI

4.3.1 Kallepet

Kallepet realizohen prej druri ose ne raste te vecanta metalike.
Duhet te kushtohet kujdes ne percaktimin dhe projektimin e elementeve te kallepeve sipas pozicionit. Kallepet standart per realizimin e strukturave jane elementet me gjatesi 0.9, 2.70m etj. per elementet vertikale te brendshem dhe te jashtem.
Perforcusesit e kallepeve duhet te pozicionohen dhe te percaktohen lidhjet midis tyre sipas standarteve evropiane ne lidhje universale ose jo universale, cepat e brendshem dhe te jashtem me permasa minimale 0.3m, pajantimet dhe konsolat.
Kallepet duhet te jene në vijë të drejtë dhe te niveluara. Para derdhjes së betonit, kallepet të lyhen ne sipërfaqet e kontaktit të formave me një përbërës që formon një shtresë e cila siguron heqjen e kallepeve pa demtuar betonin. Betoni për themelet dhe kolonat fundore mund të vendoset në gërmime pa kallepe, pas inspektimeve dhe miratimit të Mbikëqyrësit. Gjerësia e gërmimit do të jetë një minimum prej 30cm më e madhe se permasimi i kallepeve.
Kontraktori duhet të jetë përgjegjës për projektimin e kallëpeve dhe duhet të furnizojë dhe të rregullojë të gjithë kallëpet, bashkë me skelat shoqëruese, lëndë druri, mbështetjen, përforcimin, etj., që kërkohen për vendosjen e betonit. Gjate perdorimit te skelerise se drurit, sipërfaqja e kallëpit, kur vjen në kontakt me betonin e njomë duhet bërë me dru të vjetruar në mënyrën e duhur, me trashësi të mjaftueshme që ti rezistojë betonit të njomë ndërkohë që ai vendoset dhe derdhet, pa asnjë keqformim.

4.3.2 Armatura

Armatura duhet të pozicionohet në kallepe dhe të vendoset ne menyre qe te krijoje mundesine e realizimit te shtreses mbrojtese te betonit.

Shufrat e armatures do te mbeshteten ne distancatore metalike. Për soletat ne nivelin e mbeshtetjes ne toke shufrat ose rrjeta metalike duhet të mbështetet mbi blloqe betoni të parafabrikuar, të vendosura në

intervale të kërkuar nga madhësia e armatures që do të përdoret, për të ruajtur armaturen dhe per te realizuar shtresen mbrojtese në lartësinë minimale te specifikuar mbi nënshtresën e themeleve. Armatura duhet të pozicionohet duke përdorur tela lidhës dhe duhet të vendoset në mënyrë të sigurt dhe të lidhet në çdo bashkim me tela bari me diametër 1,6mm. Fundet e telave lidhës duhet të jenë larg formës. Saldimi i shufrave të kryqëzuara nuk do të lejohet por vetëm nëse nuk autorizohet në mënyrë specifike nga Mbikëqyrësi.

4.3.3 Ankorimi i armatures

Ankorimi i armatures duhet të jetë 40_50 here diametrin e shufres nëse nuk ka një përcaktim ndryshe ne projekt.
Sipas ENV 10080 armatura duhet të jetë çelik i vjaskuar me rezistence 500 N/mm² dhe me diametër minimumi 6mm. (BSt 500 S gjermane sipas DIN 488).

4.3.4 Shtresa mbrojtese e betonit

Minimumi i shtresës përforcuese të betonit duhet të jetë:

Themelet pllake dhe plinta	50mm
Elementet strukturale trare kolona	30mm
Soleta	20mm
Mure	25_ 30mm

Vendosja e Materialeve të Ndryshme

Të vendosen dhe ankorohen në vend bulonat, "kemishat" e tubave, tuba dhe materialet te tjera para se të derdhet betoni. Të lidhen bulonat ankorues dhe të kontrollohet vendndodhja dhe lartësia.

4.3.5 Betonimi

Betoni duhet të derdhet në mënyrë monolite. Betoni i gatshem në betoniera ose makineri do të jetë i pranueshëm nëse permbushen kerkesat e meposhtme:
Betoni i parapërgatitur qe vjen nga nyjet e betonit do të furnizohet nga prodhuesi me fatura dublikate në çdo dërgesë betoni për në kantier, një për Mbikëqyrësin dhe një për Kontraktorin. Ne fatura shenohen:
Lloji dhe klasa e çimentos
Sasia e çimentos për metër kub të betonit
Madhësia maksimale e përbërësve
Përmbajtja totale e ujit e shprehur me raportin Ujë/Çimento
Identifikimi i Kamionit
Volumi i kamionit të betonit
Koha e ngarkesës
Betoni duhet te derdhet ne vend brenda 90 minutave të prodhimit nëse temperatura e ajrit është më pak se 30 gradë Celsius, të ulet koha e derdhjes ne vend në 60 minuta nëse temperatura e ajrit është më e lartë se 30 gradë Celsius. Uji shtesë mund të hidhet tek betoni nëse raporti maksimal ujë-çimento nuk kalohet.
Të mos derdhet betoni nëse:
(a) kushtet atmosferike nuk jane te pershtatshme, ne rastet e temperaturave ekstreme te larta ose te ulta
(b) në zona të pambuluara gjatë periudhes se reshjeve
Para se të derdhet betoni në vend, të hiqen papastërtitë, mbetjet e ndërtimit, uji, dëbora dhe akulli brenda kallepeve. Betoni nuk duhet të lejohet të bjerë i lirë nga sillosa, nese betonimi behet i tille, nga një lartësi më e madhe se 3m.

Rekomandohet qe prodhimi dhe hedhja e betonit ne objekt te mos realizohet ne kushte te veshtira atmosferike.
Të mundësohet betonimi deri ne 10 gradë Celsius si minimum i temperaturës se ambjentit gjate betonimit.
Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit ne rast se bie shi i rrembyeshem, pasi ndikon ne klasen e rezistences se betonit.
Ne rastet e temperaturave te ulta nen 4°C rekomandohet te mos kryhet betonimi por ne qofte se kjo eshte e domosdoshme, atehere duhte te merren masa qe gjate proçesit te prodhimit te betonit, te shtohet solucioni ndaj ngricave ne masen e nevojshme qe rekomandohet nga prodhuesi i solucionit.
Prodhimi dhe perpunimi i betonit ne temperatura te larta mund te ndikoje negativisht ne procesin e ngurtesimit te betonit.
Të mundësohet temperatura 32 gradë Celsius si temperaturë maksimale motit gjate betonimit.

Trajtimi i betonit te fresket

Trajtimi i betonit ne veper fillon ne momentin qe betoni hidhet nga betonpompa ose sillosi me vibrimin ne pozicione te vibratorit qe rrezja e mbulimit te mbivendoset ne zonat e trajtuara te struktures.
Betoni duhet të trajtohet gjatë hedhjes ne veper në mënyrë që të krijojnë kushte per ngurtesim pa te plasura per efekt te tkurrjes se hershme te betonit. Per kete, gjate fillimit te ngurtesimit e ne vazhdim betoni i fresket duhet te laget ne menyre qe reaksionet kimike te ngurtesimit te zhvillohen ne prezencen e ujit dhe nxehtesia qe ato clirojne gjate ngurtesimit te betonit te mos krijoje fenomenin e gjakrrjedhes se betonit te shoqeruar me plasaritje qe ne fazen e hershme te jetes se tij.
Betoni i freskët nuk duhet të ekspozohet ndaj goditjeve, dridhjeve dhe temperaturave shume te ulta ose te larta.
Menjëherë pas vendosjes, shtresat e betonit duhet të vibrohen duke përdorur vibratorë të brendshëm betoni të mundësuar dhe të lëvizshëm me dore, shufra dhe ngjeshje. Goditjet nga jashtë ose forma të tjera të lëkundjes nga jashtë të formave nuk lejohen. Vibratorët nuk duhet të përdoren për të transportuar betonin brenda formave.
Vibratorët e brendshëm të zhytur në beton duhet të ruajnë një frekuencë minimale prej jo më pak se 8000 lëkundjesh në minutë. Zgjatja e lëkundjeve do të jetë nga 5 deri në 15 sekonda. Vibratorët duhet të aplikohen në pikat e baraslarguara prej 45cm te vendosur ne forme shahu.
Nëse fugat janë të nevojshme, pozicioni i tyre duhet te diskutohet me Mbikëqyrësin.
Pas betonimit te mundësohet aplikimi i vazhdueshëm dhe i njëtrajtshëm i spërkatjes me ujë në të gjithë periudhën e trajtimit. Trajtimi duhet të jetë aplikimi i drejt për drejtë i ujit.
Të përmbytet sipërfaqja me ujë pasi betoni të jetë forcuar mjaftueshëm në mënyrë që të mos dëmtohet siperfaqja e elementeve. Të aplikohet spërkatja me ujë për një minimum prej dy ose tre herë në ditë dhe aq herë sa diktojnë kushtet atmosferike të ambientit dhe të lejohet trajtimi i betonit me këtë metodë për nje periudhë minimale shtatë ditore.

Defektet

Të riparohen siperfaqet pas hejes se kallepeve duke shmangur gërryerjet dhe gropëzat, më të mëdha se 2cm^2 ose 6mm në thellësi, ose zona të tjera të tilla të zbuluara. Të realizohen cepat pingul me sipërfaqen dhe të riparohen me llac cimento qe nuk tkurret. Të riparohen brimat e lidhjeve dhe defekte kur hiqen kallepet. Deformimet nuk duhet të ndryshojnë më shumë se tolerancat e lejueshme që janë përcaktuar. Sipërfaqet e ekspozuara duhet të jenë të njëtrajtshme

Trajtimi dhe ruajtja

Të ruhet betoni nga veprimi dëmtues i diellit, shiut, ujit që rrjedh, ngricave, dëmtimeve mekanike, shenjave të gomave dhe njollave të vajit.
Kallepet mund të hiqen deri 48 orë pas derdhjes së betonit.
Të parandalohet trafiku më këmbë ose me makina me makineri gërryese për jo më pak se 72 orë pasi të kenë përfunduar betonimi.

Kontrolli i cilesise se betonimit, testimi i betonit

Kontraktori duhet të bëjë marrëveshjet e nevojshme për testimin e betonit të forcuar dhe të freskët në përputhje me dispozitat e EN 206 dhe duhet të furnizojë me gjithë aparateturat, fuqinë punëtore, materialet dhe transportin e nevojshëm.
Të realizohen kampionet e betonit të freskët ne forma kubike standarte për të kryer testet e rezistences se betonit. Te kontrollohet konsistenca e betonit para hedhjes ne veper.
Testet e konsistences se betonit duhet te kryhen:
(a) Ne fillimin e hedhjes së betonit,
(b) Kur pergatiten mostrat e testimit
(c) Për çdo grup ose çdo 10m^3 beton.
Të bëhen një minimum prej pesë kubesh për testim me përmasat 150/150/150mm për testimin ne shtypje te betonit. Mostrat duhet te jene te zhytura ne uje. Të testohen kubat fillimisht pas 8 ditësh dhe të rruhen kuba rezervë.
Kubat e betonit për testet e shtypjes duhet te merren jo më pak se njëherë për cdo 30 m^3 betoni. Jo më shumë se 10% të kubave të testuar lejohet te tregojnë se betoni i derdhur nuk përmbush kërkesat për specifikim ose aty ku është faktuar se cilësia është nën kerkesat e duhura duhet te raportohet. Kosto e testeve të tilla duhet të mbartet nga Kontraktori.
Betoni duhet te plotesoje kerkesat per rezistencen e nese kjo nuk duhet te zevendesohet me beton të ri pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues.

Rezultatet e Testeve

Të paraqiten rezultatet e testeve si pjesë e "Raportimeve Ditore të Mbikëqyrësit" përveç se rezultati i Testeve në shtypje duhet të raportohet.

Heqja e kallepeve

Kallepet nuk duhet të hiqen para se betoni të jete ngurtesuar mjaftueshëm për të mbajtur peshën e vet dhe ndonjë ngarkesë tjeter që vendoset mbi të. Ky kusht duhet kerkon që kallepet të qëndrojnë në vend, pas hedhjes së betonit si me poshte.

Alikimi i "eproxy resina" per lidhjen e betonit te vjeter me betonin e ri

Eproxy resina eshte materiali kimik qe mundeson lidhjen e betonit të ri me atë ekzistues.
Sipërfaqja e kontaktit duhet të ashpersohët. Duhet të hiqet pjesa sipërfaqesore e elementeve ekzistues.
Sipërfaqja e kontaktit të betonit të ri, me atë ekzistues, lyhet me penel me "Eproxy resina". Lyerja duhet të jetë e kujdesshme dhe e njëtrajtshme. Nuk lejohet lënia e zonave pa lyer me lidhes. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për të mbushur mirë me lidhës zonat e poreve. Lyerja mund të bëhet edhe me sprucim, me anët e pajisjet e posaçme.
Pas lyerjes së sipërfaqes së kontaktit duhet që brenda disa minutave te percaktuara ne instruksionin e perdorimit, bëhet derdhja e betonit të ri.

Jashtë kohes se kerkuar nuk lejohet betonimi pasi lidhësi është mpiksur dhe ai jo vetëm që nuk ndihmon proçesin e lidhjes së betonit të ri me atë ekzistues, por e pengon atë.

4.3.6 Muratura

Muratura realizohet me tulla te plota per muret mbajtes dhe tulla me birra per muret ndares. Ne strukturat ekzistuese muratura ndarese do te realizohet me mure gipsi per te lehtesuar ngarkesen e strukturave.

Specifikimi per tullat

Tulla si element i ndertimit duhet te plotesoje kushtet e meposhtme per ndertimet antisizmike:
• Rezistenca ne shtypje duhet te jete: per tulle te plote 75kg/cm^2; per tulle me vrima 80kg/cm
• Rezistenca ne prerje e cila duhet te jete per te gjitha tullat me vrima 20kg/cm^2.
• Perqindja e boshlleqeve e cila duhet te jete: per tullen e plote 0-25%; per te gjitha tullat me vrima 25-45%.
• Trashesia e pareteve perimetrale dhe te brendshem per tullat e plota te mos jete me e vogel se 20mm dhe per te gjitha tullat me vrima, trashesia e pareteve perimetrale te mos jete me e vogel se 15mm dhe e pareteve te brendshem jo me e vogel se 9mm.
• Siperfaqja e nje vrime te mos jete me e madhe se 4.5cm^2.
• Ujethithja ne perqindje duhet te jete nga 15-20%.

Specifikimi per llacin e muratures

Tipet e llaçeve

Llaçi per muret per 1m^3 llaç realizohen me keto perberje:
• Llaç bastard me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me rere ne raporte 1:0.8:8. Gelqere e shuar ne 110lt, çimento 300, 150 kg, rere 1.29m^3.
• Llaç bastard marka 25 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.5:5.5. Gelqere e shuar ne 92lt, çimento 300, 212 kg, rere 1.22m^3.
• Llaç bastard marka 15 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.8:8. Gelqere e shuar ne 105lt, çimento 300, 144 kg, rere 1.03m^3.
• Llaç bastard marka 25 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.5:5.5. Gelqere e shuar ne 87lt, çimento 300, 206 kg, rere 1.01m^3.
• Llaç-çimento marka 1:2 me rere te lare e formuar me çimento, rere ne raport 1:2 çimento 400, 527kg, rere 0.89kg.

Specifikimi per muraturen

Mur me tulla te plota 25cm / 40 cm / 55 cm

Muratura me tulla te plota mbajtese ne lartesi deri 3m, realizohet me llaç bastard M-25 sipas receptures te sipermendur me permbajtje per m^3: tulla te plota, llaç bastard 0.25 m^3, çimento 400 dhe uje per çdo trashesi muri duke perfshire çdo detaj dhe kerkese per qoshet, parmaket, skelat e sherbimit, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj. Per muraturen e katit perdhe, siperfaqja e xokolit duhet te jete e niveluar me nje shtrese llaç çimento 1:2 me trashesi jo me te vogel se 2cm.

Mur me tulla te lehtesuara

Murature me tulla te lehtesuara ne lartesi deri 3m, realizohen me llaç bastard M-25 me permbajtje per m^3: tulla te lehtesuara, llaç bastard 0.29 m^3, çimento 400 dhe uje per çdo trashesi duke perfshire çdo detaj dhe kerkese per dhembet e lidhjes, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit ose skelerine, si

dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj. Per muraturen e katit perdhe siperfaqja e xokolatures duhet te jete e niveluar me nje shtrese llaç çimento 1:2 me trashesi jo me te vogel se 2cm.

Mur ndares 12cm

Murature me tulle te plota me trashesi 12cm dhe llaç bastard m-25 me permbajtje per m^3: tulla te plota, llaç bastard 0.19m^3, çimento 400 dhe uje

4.3.7 Strukturat metalike

Prodhimi i çelikut duhet te jete bere nga kompani te liçensuara qe duhet te garantojne cilesine si dhe te dhenat e tjera te celikut (perberja kimike, karakteristikat fizikomekanike,etj) .

Celiku qe perdoret per konstruksionet mbajtese duhet t'u pergjigjet kerkesave te standarteve dhe kushteve teknike dhe te kete garanci persa i perket kufirit te rrjedhshmerise dhe permbajtjes maksimale te squfurit dhe fosforit; kurse per konstruksionet e salduara ka kerkesa per permbajtjen maksimale te karbonit.

Prerja, saldimi si dhe lidhje e elementeve prej çeliku behet ne kanierin e firmes kontraktuese dhe ata transportohen ne kantier ose keto punime mund te behen ne vendin e punes (ne objekt).

Sidoqofte, duhet qe punimet para montimit te elementeve te kontrollohen nga supervizori dhe duhet te protokollohen.

Pergatitja per saldim perfshin ate qe detajet para se te saldohen, te kene marre formen e tyre perfundimtare. Po ashtu, buzet dhe siperfaqet e pjeseve qe do te saldohen duhet te pergatiten sipas kerkesave te proçedures se saldimit dhe formave qe jepen ne pasqyrat 6, 7, 8 te KTZ 206-80 ose ne normat perkatese europiane.

Pas saldimit, detajet duhet te trajtohen termikisht per te zvogeluar nderjet e brendshme, per te menjanuar te plasurat dhe per te permisuar vetite fizikomekanike. Gjate zbatimit te punimeve per saldimin e çeliqeve duhet te mbahet dokumentacioni teknik me te dhena per çertifikaten e materialeve te perdorura, ditarin e punimeve, etj.

Lidhja me bullona

Elementet prej çeliku mund te lidhen/bashkohen edhe me ane te bulonave.

Lidhja me bulona duhet t'u pergjigjet normave dhe standardeve bashkohore (EC3 ose ndonje standardi ekuivalent).

Kualiteti i bulonave luan gjithashtu nje rol te rendesishem dhe keto te fundit po ashtu, duhet t'u pergjigjen normave te siperpermendura. Eshte me rendesi qe bulonat t'i plotesojne kushtet e rezistences se llogaritjes te bashkimeve me bulona. Lloji i gjendjes se tensionuar dhe grupi i bashkimit, te cilat duhet te permbushin kushtet e nevojshme te kerkuara nga normat/ standardet per:

- Terheqja
- Prerja
- Shtypja

Gjate zbatimit te punimeve per lidhjen me bulona te çeliqeve duhet te mbahet dokumentacioni teknik me te dhena per çertifikatat e materialeve te perdorura, ditarin e punimeve, etj.

Ngritja

Ngritja e elementeve prej çeliku behet sipas planeve te pergatitura nga arkitekti/ inxhinieri. Inxhinieri duhet te supervizoje punen e ngritjes se elementeve metalike ose konstruksioneve metalike.

Mbrojtja nga agjentet atmosferike

Mbrojtja e çelikut behet ne dy menyra:

- Duke e lyer çelikun me disa shtresa, te cilat e mbrojne ate prej korrozionit. Kjo behet duke e lyer, zhytur ose sperkatur me shtresa. Njera shtrese eshte baza, kurse shtresa tjeter perdoret edhe si dekorim i elementit

dhe mund te kete ngjyra te ndryshme. Siperfaqet ne te cilat do te vendosen keto shtresa, duhet qe me pare te perpunohen dhe te jene te lira nga vaji, pluhuri apo ndryshku.
Shtrese prej metali. Kjo mbrojtje eshte e perhershme. çeliku duhet zhytet ne zink te nxehte (450°C) dhe siperfaqja e tij te jete e lire prej pluhurit, vajit si dhe ndryshkut. Permbi te, mund vendoset ndonje shtrese tjeter si dekorim i elementit prej çeliku.
Ndalohet rreptesisht lyerja e çeliqeve per betonim me vajra.

4.3.8 Punimet e ndertimit

Punimet e ndertimit qe do te kryhen duhet te monitorohen nga Mbikqyresi i punimeve. Konkretisht duhet te monitorohen punimet e meposhtme:
1. Prishja dhe ndertimi i mureve ne godinen ekzistuese.
2. Realizimi i arkitrareve ne muret mbajtese qe mundesojne hapjen e carjeve per te realizuar skemen e shfrytezimit te spitalit. Ne projekt jane dhene dy mundesi per realizimin e tyre si arkitare metalike dhe arkitrare betonarme te parapergatitur. Kontraktori mund te perdore secilin tip. Arkitraret metalike jane me te lehte per montim dhe vendosje por duhet te realizohen e te kontrollohen me rigorozitet nga inxhinieri i kantjerit dhe Mbikqyresi i punimeve.
3. Ndertimi i maternitetit te ri. Struktura eshte realizuar prej betoni te armuar.
4. Ambjentet teknike realizohen me struktura betonarme.
5. Soleta e ambjenteve teknike te gazit medikal realizohet me konstruksion me trare metalike dhe betonarme.
6. Ura lidhese midis ambjenteve me strukture metalike.
7. Realizimi i struktures se ashensorit panoramik.
Te gjitha punimet e permendura jane punime thelbesore qe lidhen me strukturen mbajtese te secilit objekt konkret. Monitorimi nga ana e inxhinierit te zbatimit dhe Mbikqyresit te punimeve duhet te kryhet ne kerkesa te forta te zbatimit te projektit dhe kushteve teknike.

5. PUNIMET STRUKTURA METALIKE

5.1 PJESA I – E PËRGJITHSHME

5.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtyre specifikimeve në sasinë e marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë.

5.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

5.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

DIN V ENV 1993 Përcaktimi i Strukturave Metalike
DIN EN 10025 Produktet e kthyera me të nxehtë të strukturave metalike

5.1.2 PARAQITJET

Paraqisni si më poshtë:

5.1.2.1 Vizatimet Teknike

Para se të ngrihen strukturat metalike paraqitni vizatimet teknike për miratim. Riprodhimet e skicave të kontratave si vizatime teknike nuk janë të pranueshme.

Mundësoni, llojin, shkallën, përmasat dhe detajet e trarëve dhe arkitrarëve horizontalë, duke përfshirë përforcimin, aksesorët dhe ankorimet. Për më tepër mundësoni diagramet e mbledhjeve, prerjet dhe format e llojet e hekurave. Të mos shkallëzohen dimensionet nga vizatimet strukturore për të përcaktuar gjatësitë e hekurave përforcues.

5.1.2.2 Certifikatat e Përputhshmërisë

Paraqitni certifikimet e mëposhtme të prodhuesit:
Punimet e Çelikut
Dadot dhe vidat
Materiali i Lyerjes së Sipërfaqes
Elektrodat dhe

5.1.2.3 Kontrolli i Cilësisë

a) Inspektorët e saldimeve duhet të jenë të certifikuar nga Standardet e duhura Shqiptare ose baraz vlefta e tyre në normat e BE në bazë të miratimit nga Mbikëqyrës ose përfaqësues te tij.
b) Te kryhet inspektimin dhe testimi i prerjeve të vëna nga prodhuesi në se seksionet e çelikut në vendndodhje të ndryshme.
c) Testime jo shkatërruese të lidhjeve me saldim:
Te kryhen testime jo shkatërruese të lidhjeve me saldim si më poshtë:

- 1.10% të lidhjeve të momentit që përshijnë saldimet filetë, me inspektime magnetike.
- Të gjitha lidhjet e momentit dhe të gjitha lidhjet nën presion të drejt për drejtë duke përdorur saldimet me depërtim të thellë, nëpërmjet testimeve me ultrasaund.
- Kur momentet transferohen ose me saldime filetë ose me ato me depërtim në pllakat fundore në bashkimet "T", "U" dhe "L", të shikohet metali bazë për çarjet laminarie ose me thyerje, me testime me ultrasaund.
- Për instalimin e tolerancave duhet të aplikohen standardet Shqiptare dhe ato të BE.

5.2 PJESA 2 - PRODUKTET

5.2.1.1 MATERIALET E ÇELIKUT

- Materialet e reja duhet të jepen në përputhje me standardet e referuara, të fuqisë dhe cilësisë së shënuar në skicat strukturore.
- Kanalet e formuara me të ftohte:
- Të prodhohen në bazë të normave Shqiptare dhe atyre të BE.
- Bulonat ankorues: në standardet Shqiptare dhe normat e BE.
- Kunjat e salduar për pllakat e vendosura duhet të jenë në përputhje me standardet Shqiptare dhe Normat e BE.
- Kontraktori duhet të sigurojëpërputhshmëri për mbrojtjen ndaj zjarrit me spërkatje para se të aplikohet mbushësi.
- Bulonat e fuqishëm duhet të përdoren në bazë të kodeve Shqiptare dhe atyre të BE dhe gjithashtu në bazë të shënimeve në skica.

5.2.1.2 LYERJA

I gjithë çeliku strukturor duhet të jetë i galvanizuar në thellësi e nxehtësi siç tregohet kurdoherë në skica

5.2.1.3 MBROJTJA NDAJ ZJARRIT

I gjithë çeliku strukturor duhet të jetë i mbrojtur ndaj zjarrit për të arritur gamën e mbrojtjes ndaj zjarri prej 1 ore. Metoda e mbrojtjes ndaj zjarrit duhet të jetë e përputhshme me atë përfundimtar të miratuar nga Mbikëqyrësi ose përfaqësuesi i tij.

5.2.1.4 Çeliku Strukturor

Çeliku strukturor (për trarët, arkitrarët dhe trarët horizontal) duhet të përzgjidhet në bazë të EN 10025

5.2.2 DADOT, VIDAT DHE RONDELAT

5.2.2.1 Dadot

EN 24014, EN 24016, EN 24017 dhe EN 24018

5.2.2.2 Vidat

EN 24032, EN 24034, ISO 7413

5.2.2.3 Rondelat

ISO 7089, ISO 7090, ISO 7091

GALVANIZIMI: Galvanizimi pas prodhimit duke përdorur një shtresë zinku me spërkatje termale (metalizimi)

5.3 PJESA 3 - ZBATIMI

5.3.1 INSTALIMI

Pas pozicionimit fundor të pjesëve të çelikut, të mundësohet mbështetja fundore të trarëve të çelikut, të mundësohet mbështetje e plotë nën pllakat baze dhe ato fundore duke përdorur fino që nuk shtypet. Të vendoset nën çelikun strukturor siç tregohet në skica një lloj spesor i miratuar, i cili i ka dimensionet në skica. Pas pozicionimit përfundimtar të shtyllave të çelikut, të mundësohet mbështetje e plotë nën bazament dhe pllakat bazë duke përdorur fino e cila nuk shtypet. Të vendoset fino e cila nuk shtypet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

5.3.2 LIDHJET

Të mos shtrëngohen bulonat ankorues të vendosur në beton me trapan. Të shtypen, ose shtrembërohen ose të shpohen brima për bulonat. Bulonat, dadot, dhe rondelat duhet të jenë të pastra dhe të lubrifikohen menjëherë para instalimit.

5.3.2.1 Bulonat

Bulonat duhet të shtrëngohen deri sa të jenë "shtrënguar mjaft". "Shtrënguar mjaft" është shtrëngimi i cili ekziston kur elementët në një bashkim janë tërësisht në kontakt. Nëse kontakti i sigurt i nyjave dhe pllakave

nuk mund të arrihet me disa shtrëngime e rrotullime të çelësave, ose me përpjekje e plotë të një punëtori i cili përdor veglat për shtrëngim, të kontaktohet Mbikëqyrësi për udhëzime të mëtejshme.
Të testohen një minimum prej 3 lidhjesh bulona vidë dhe rondele.

5.3.3 SALDIMI

Të përdoret saldimi me hark dhe me çelik me elektrodë me pak hidrogjen. Të mos lehtesohet tensioni nga saldimet e ekspozuara por të pastrohen siç tregohet. Të mundësohen saldatorë me eksperiencë, e operatorë saldatricesh. Heqja e saldimeve të përkohshme, pjatave të cilat kalojnë saldimin dhe rripat mbështetës e testet e tyre duhet të përzgjidhen nga Mbikëqyrësi. Nëse më shumë se 20% i saldimeve të bëra nga një saldator përmbajnë defekte të treguara nga testimet, atëherë të gjitha saldimet e kryera nga ai saldator duhet të testohen nga testimet ultrasonike ose radiografike në bazë të miratimit të Mbikëqyrësit.

6. ASHENSORËT

7.3.1 Ligjet dhe Normat e Aplikueshme Shqiptare

Ndërtimi i kullës së ashensorit duhet të jetë në përputhje me Specifikimet
Vetëm nëse nuk udhëzohet ndryshe kulla e ashensorit duhet të ketë të dhënat e mëposhtme:
Ashensori i vizitorëve (dim. e kabinës 1300x1400mm), 10 persona, 1000 kg, 4 ndalesa
Ashensorët e Pacientëve (dim. e kabinës 2300x1200mm), 17 persona, 1275 kg, 4 ndalesa

7. MURATURA

7.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

7.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi në masën që janë marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë.

7.1.1.1 Ligjet dhe Rregullat e Aplikueshme Shqiptare

7.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

Puna me Blloqe/Tulla

DIN EN 771-1	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 1: Murature me njesi tulle Argjile
DIN EN 771-2	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 2: Murature me njesi tulle Silikate prej kalciumi
DIN EN 771-3	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 3: Murature me njësi me Përbërës Betoni (me agregat të dendur dhe të lehtë)
DIN EN 771-5	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 5: Murature me njesi guresh te fabrikuar
DIN EN 771-6	Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 6: Murature me njesi gurësh natyrorë
DIN EN 998-1	Specifikimet për llacin ne ndertim - Pjesa 1: suvatimi dhe shtresa finale e llaçit
DIN EN 998-2	Specifikimet për Llaçin ne ndertim- Pjesa 2: Llaçi ne murature
DIN EN 1015-1	Metodat për testimin e llaçit ne ndërtim - Pjesa 1: Përcaktimi i madhësisë së shpërndarjes së grimcave (nëpërmjet analizës me sitë)

DIN EN 1015-11	Metodat për testimin e llaçit ne ndërtim - Pjesa 11: Përcaktimi i forces ne perkulje dhe shtypje të llaçit të forcuar

Elemente ndihmes

DIN EN 845-1	Specifikim për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 1: Lidhjet, brezat, varëset dhe kllapat
DIN EN 845-2	Specifikimet për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 2: Arkitrarët
DIN EN 845-3	Specifikimetpër përbërësit lidhës në ndërtim -Pjesa 3: rrjete metalike për përforcim

7.1.2 SIGURIMI I CILËSISË

7.1.2.1 Paraqitja

Mos ndryshoni burimin ose furnitorin e materialeve pasi ka filluar fabrikimi i tullave. Tullat duhet të prodhohen njëherësh dhe nga i njëjti grup. Të përzihen të gjitha tullat për të prodhuar një pamje uniforme kur të instalohen. Një shtresëzim ose lidhje e dukshme e ngjyrave të shkaktuara nga miksimi i gabuar i tullave nuk është i pranueshëm.

7.1.3 DËRGIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

Të dërgohen materialet e çimentuara në kantier duke përdorur kontenierët e pacopëzuar, qartësisht i shënuar me emrat dhe marka e prodhuesve. Të ruhen materialet e çimentos në godina të thata ku nuk ka ndërhyrje të motit dhe të tregohet kujdes që të mos lejohen materiale të huaja që të futen aty dhe të parandalohet dëmtimi nga uji dhe lagështira. Të ruhen materialet ndërtimore nga dëmtimet dhe përveç rërës të mbahen të thatë deri në momentin e përdorimit. Të mbulohet rëra për të parandaluar futjen e ujit dhe të materialeve të cilat përmbajnë ngrica apo akulli. Të ruhen materialet që janë të dëmtueshëm nga lagështia nga shiu dhe uji në tokë.

7.1.4 PLANIFIKIMI

Të koordinohet puna në ndërtim me punën e punimet e tjera për të mundësuar artikujt e ndërtuar dhe për të shmangur prerjet dhe rregullimet /firot.

7.1.5 LIDHJA

Të parashikohet mbështetja dhe skelat e nevojshme për ndërtimin e muraturës. Të ndërtohen lidhëset për të rezistuar presionin e erës siç kërkohet nga kode vendore të ndërtimit.

7.1.6 KËRKESAT SIZMIKE

Të parashikohet përforcim sizmik. Përqindja minimale totale për muret konstruktive duhet të jetë 0.20% dhe muret ndarëse /jo-strukturore të jenë 0.15%. Trarët lidhës kërkohen në shtresën shkelëse, në pjesën e sipërme dhe të poshtme të hapjeve në tarraca dhe nivele katesh, si dhe mbi muret e parapeteve.

7.2 PJESA 2 – PRODUKTET

7.2.1 TULLAT

7.2.1.1 Specifikime të Tullave Prej Argjile

Tulla si element ndërtues duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme për ndërtimet kundër lëkundjeve sizmike:
Rezistenca gjatë shtypjes, që do të jetë për tullat 75 kg/cm^2; për tullat me brima 80 kg/cm^2; për tullat e kuqe për tavane 150 kg/cm^2
Rezistenca gjatë prerjes, e cila duhet të jetë: për tullat me brima 20 kg/cm^2.
Përqindjet ndër hapësirat të cilat duhet të jenë: për tullat 0-25%; dhe për tullat me brime 25-45%
Trashësia e perimetrit dhe e parapetit të brendshëm për tullat nuk do të jetë më e ulët se 20mm dhe për të gjitha tullat me brima; trashësia e parametrit të parapetit nuk do të jetë më e ulët se 15mm dhe e brumit të brendshëm jo më e ulët se 9mm.
Sipërfaqja e një brime duhet të jetë maksimumi 4.5 cm^2.
Hygrofiliteti në përqindje do të jetë nga 15-20%.

7.2.1.2 Tullat me brima - Mure Të Brendshme

Dimensionet mesatare të tullës do të jenë si të treguara në skica. Tullat me brima do të jenë në përputhje me DIN EN 771

7.2.1.3 Tullat me brima – Mure Të Jashtme

Dimensionet mesatare të tullës do të jenë si të treguara në skica. Tullat me brima do të jenë në përputhje me DIN EN 771

7.2.1.4 Blloqe Betoni Autoklave /Me Peshë Të Lehtë

Tullat prej betoni: njësitë me peshë të lehtë me dimensione modulare dhe të trajtuara me ajër ujë ose avull. Tullat prej betoni duhet të përputhen me muraturat prej betoni, në karakteristika ngjyre dhe sipërfaqeje.

7.2.2 LLAÇI

7.2.2.1 Cilësitë e Llaçit

Llaçi për ndërtim: Në doza për 1 M^3 do të kryhet me :

Llaç gëlqeror të llojit 15 me rërë lumi (me porozitet 40% dhe përmbajtje uji të duhur që ngrihet në volum deri në 20%) të përzier në proporcion me çimenton: gëlqere: rërë = 1: 0, 8: 8. 110 lt gëlqere të hidratuar, 150 kg çimento (lloji 300), 1.29 m^3 rërë.

Llaç gëlqeror të llojit 25 me rërë lumi (me porozitet 40% dhe përmbajtje uji të duhur që ngrihet në volum deri në 20%) të përzier në proporcion me çimenton: gëlqere: rërë = 1: 0,5: 5,5. 92 lt gëlqere të hidratuar, 212 kg çimento (lloji 300), 1,22 m^3 rërë.

Llaç gëlqeror të llojit 15 me rërë të pastër (që ka një porozitet prej 35%) të përzierë në marrëdhënie me çimenton: gëlqeren: rërën = 1: 0,8: 8. 105 lt gëlqere të hidratuar, 144 kg çimento (lloji 300), 1,03m^3 rërë.

Llaçi gëlqeror i llojit 25 me rërë lumi (të ketë një porozitet prej 35%) të përzierë në proporcion me çimenton: gëlqeren: rërën = 1:0,5:5,5. 87 lt gëlqere të hidratuar, 206 kg çimento (lloji 300), 1,01m^3 rërë.

Llaçi gëlqeror i llojit 1:2 me rërë të pastër (të ketë një porozitet prej 35%) të përzierë në proporcion me çimenton: rërën = 1:2. 527 kg çimento (lloji 400), 0,89m^3 rërë.
Uji: i pastër, i pijshëm dhe pa substanca të cilat mund të prekin në mënyrë që të dëmtojnë llaçin.

7.2.3 FINO (LLAÇI I HOLLË)

Rënia ndërmjet 200 dhe 280 mm. Të parashikohet fuqia minimale e finos prej 13,800 kPa 2000 psi në 28 ditë.

7.2.3.1 Përzierjet

Të mos përdoret ngjitja me ajër, materialet kundër ngrirjes, ose ngjitjet me klorin (përbërës klorine).

7.2.4 AKSESORËT E MURATURES

7.2.4.1 Përforcimi i Fugave Horizontal

DIN EN 845-3 prodhuar nga tel hekuri të tërhequr në të ftohtë. Teli nuk duhet të jetë galvanizuar me të nxehtë pas prodhimit. Përforcimi në këtë mënyrë do të jetë me lidhje me dy ose me shumë tela në gjatësi që saldohen me një tel diagonal, ose me llojin e shkallëzimit me tela perpendikular prej jo më shumë se 400mm. Të mundësohen seksione të sheshta me gjatësi prej 3m dhe cepa të paraformuar dhe kthesa në formë T prej përreth 800mm gjatësi. Gjerësia totale do të jetë përreth 50mm më pak se sa trashësia formale e murit.

7.2.4.2 Ankorimet dhe Lidhjet e Mureve

Të mundësohen përcaktimet e miratuara të çelikut, ankorave në formë nyje, të sheshta, bisht dallëndysheje jo më të lehta se sa 16 gjerësi dhe 22mm, me fundet kthyer lart deri në 6mm. Teli: jo me i lehtë se sa 6 gjerësi, 22mm me telin e lidhur dhe të mbyllur si lidhje.

7.2.4.3 Shufrat Përforcuese

Të mundësohen kllapat të cilat parandalojnë zhvendosjen e përforcimit gjatë ndërtimit.

7.2.4.4 Qoshet Metalike të Mureve

Të mundësohet një nga llojet e mëposhtme
Qoshet metalike të veshura me bakër: 0.2kg 7 ouns, me një fletë bakri elektrolitike, të lyer në mënyrë të njëjtë nga të dyja anët me acid, dhe kundër alkalineve, dhe me përbërës bitumoni. Të aplikohet veshja e për një peshë prej jo më pak se 1.8 kg për metër katror 6 auns për këmbë katrore (përreth 0.9 kg për metër katror 3 auns për këmbë katrore nësecilën anë).
Bakri mbi çelik për qoshet metalike: Bakri, minimumi 450 g për një peshë prej 16 auns; çeliku me trashësinë 4 mm. Të mundësohet me deformimet e fabrikës të cilat në mënyrë mekanike lidhin qoshet ndaj lëvizjeve horizontale në të gjitha drejtimet.
Qoshet metalike me membranë të përforcuar: një element prej poliestre në thelb me një shtresë fibre prej xhami e ngjitur në njërën anë. Membrana duhet të jetë e pa kalueshme nga lagështia, përkulshëm, dhe të mos preket nga alkalin kaustike.

7.2.5 KONTROLLI I BURIMIT TE CILESISE

7.2.5.1 Testet Fluoreshente

Të kryhen testes fluoreshente në njësitë e ndërtimit të cilat do të ekspozohen ndaj kushteve atmosferike. Të vendosen teste mjaftueshëm larg përpara se të fillohet puna ndërtimore për të lejuar ritestimet nëse është e nevojshme.

7.2.5.2 Përllogaritja e Fuqisë

Të përllogariten fuqitë përbërëse të sistemeve të ndërtimit. Të vihen në dispozicion llogaritjet dhe njësitë e çertifikimit dhe fuqia e llaçit.

7.3 PJESA 3 -ZBATIMI

7.3.1 PËRGATITJA

Para se të fillohet puna, duhet të verifikohen kushtet e aplikuara.

7.3.1.1 Ruajtja

Njollat ruajnë sipërfaqet e ekspozuara nga llaçi dhe njollat e tjera. Kur të vendosen fugat e llaçit, të hiqet llaçi nga sipërfaqet e ekspozuara me furça fibroze dhe lopata druri. Të ruhet baza e mureve nga njollat e spërkatjes duke mbuluar tokën aty pranë me rërë, tallash ose polietilen.
Ngarkesat: të mos aplikohet ngarkesa të njëllojta për të paktën 12 orë ose ngarkesa të përqendruara për të paktën 72 orë pasi ndërtimi me tulla të ketë mbaruar.
Të mundësohet mbështetja e përkohshme sipas nevojës.

7.3.1.2 Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqet në çdo murature duhet të jenë të drejta, të pastra dhe të mos kenë substanca të huaja në momentin kur aplikohet llaçi.

7.3.2 KONTROLLI I CILËSISË NË TERREN

7.3.2.1 Fuqia Dhe Cilësitë e Llaçit

DINEN 1015-11, për 3 ditë radhazi, dhe çdo ditë të tretë nga ai moment.

7.3.3 CILËSIA E PUNËS

Të mbahet plumbçi i ndërtimit dhe niveli. Të sigurohet dhe përdoret matësi gjatë të gjithë punës. Ndryshimet në ngjitjen apo mbështetjen pasi ka filluar puna nuk do të lejohen. Të mos ngrihet një pjesë e murit para një pjese tjetër. Të shpejtohet puna e pambaruar për të arritur nivelimin e mureve. Dhëmbëzimi nuk do të lejohet. Mos merrni përsipër një seksion muri para të tjerëve. Të ndërtohen strukturat e dyerve dhe dritareve, hapjet, ankorimet, tubacionet ndërsa vazhdon ndërtimi me tulla. Ti kushtohet kujdes ndërtimit me tulla në mënyrë që të shmangen thyerjet, copëzimet dhe ciflimet e anëve ose të pjesëve ballore. Shpimi, prerja, mbushja për të mundësuar punën e të tjerëve duhet të kryhet nga mekanikët e ndërtimit me tulla. Të priten tullat me sharrat e tyre për punën e ekspozuar. Punimet strukturore me çelik, vida, futje të ndryshme metalike të specifikuar diku tjetër duhet të vendoset në pozicionin e duhur ndërsa

vazhdon puna. Të jepen ndjekësit e dimensioneve të miratuara dhe të qëllimeve të tjera ku tregohet dhe aty ku është e nevojshme.
Mbulimet e mureve të ekspozuara dhe ndarjet të cilat nuk punohen me membranë rezistente ndaj ujit të siguruar në vend dhe të shtrirë poshtë të paktën 600mm në të dyja anët.

7.3.4 PËRZIERJA E LLAÇIT

Të maten materialet e llaçit në kontenierë prej 0,0283 m^3 për të ruajtur kontrollin dhe saktësinë e proporcioneve. Përzieni llaçin në përzierës mekanik për jo më pak se 3 ose jo më shumë se 5 minuta pasi të gjithë përbërësit janë vendosur në mënyrë që të prodhohet një përzierje e njëtrajtshme. Të shtohet uji në mënyrë graduale për të prodhuar një përmbajtje të punueshme.
Të mos mbushet përzierësi përtej kapacitetit të dhënë. Të ripunohet llaçi i cili është ngurtësuar për arsye të tharjes së ujit duke shtuar ujë për të marrë një dendësi të punueshme. Të mos ripërdoret llaçi i cili nuk është vendosur në pozicionin përfundimtar brenda afatit kohor prej 2.5 orësh nga përzierja.
Të mos përdoren përbërësit kundër ngrirjes, kripërat dhe ose substancat e tjera për të ulur pikën e ngrirjes së llaçit.
Llaçi: të përzihet llaçi në përputhje me DIN EN 998-2 për të pasur llojin e llaçit të kërkuar. Kur çimento e ndërtimit mundësohet, ti përmbahet udhëzimeve të printuara të prodhuesit të çimentos.
Fino: të mundësohet fino në hapësirat e finos më pak se 50mm në çdo dimension horizontal ose në të cilën hapësira ndërmjet përforcuesit dhe ndërtimit me tulla është më pak se 20mm.

7.3.5 FUGAT E LLAÇIT

Fugat e llaçit duhet të aplikohen në trashësi të njëtrajtshme prej 10mm vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Lidhjet e ekspozuara pak të futura të rrumbullakëta ose me një bashkues tjetër të përshtatshëm kur llaçi është forcuar. Për bashkimet horizontale, bashkuesit duhet të jenë të paktën 300mm të gjatë për punën me tulla dhe 600mm të gjatë për punën me beton. Bashkuesit do të jenë pak më të mëdhenj se sa gjerësia e bashkimit në mënyrë që kontakti total të kryhet nëpërmjet cepave të njësive, duke shtypur dhe mbyllur sipërfaqen e bashkimeve. Të pastrohen bashkimet për të hequr llaçin e tepërt dhe të lirë. Bashkimet horizontale duhet të jenë të niveluara; bashkimet vertikale duhet të maten me plumbç dhe të rregullohen nga lart poshtë murit me një tolerancë plus minus 10mm në 10m.

7.3.6 TOLERANCAT

Muratura duhet të jetë brenda kufizimeve të mëposhtme:
Faqja ballore e tullave : 1mm nga faqja e tullës më të afërt.
Faqja ballore muraturës së betonit: 2mm nga faqja e njësisë më të afërt.
Ndryshimet në trashësinë e murit: Plus ose minus 6mm.

7.3.7 PUNIMET ME TULLA

Të përzgjidhet dhe vendosen tullat në të tillë mënyrë që të ekspozohet ana më e mirë.

7.3.7.1 Testimi

Përveçse në kohë të ftohtë, të testohet argjila ose tullat në kantier, para se të vendosen në mënyrë të tillë:
Dukë përdorur një laps prej dylli, të vizatohet një rreth në madhësinë e një monedhe në pesë tulla të përzgjedhura rastësisht.

Hidhni 20 pika uji nga një pikatore në sipërfaqe brenda rrethit tek secila tullë. Nëse koha mesatare që uji është tërësisht përthithur në të pestat tulla është më pak se 1-1.5 minuta, tullat e lagura të përfaqësuara nga pesë tullat e testuara.
Të sigurohet që çdo tullë është e njomë, por sipërfaqja të jetë e thatë kur të vendosen. Gjatë kohës së ftohtë, të mbahen materialet e ndërtimit të thata deri sa të vendosen.
Bashkimet e thata ose të ngjitura nuk do të lejohen.

7.3.7.2 Përdorimi

Nëse nuk tregohet ose specifikohet ndryshe, të vendosen tullat në rresht dhe në lidhje të një pas njëshme. Të mbushen tërësisht bashkimet ndërmjet tullave me llaç. Të formohen bashkime të shtratit të trasha me llaç të cilat janë më pak se trashësia e murit; të vendoset llaçi në këtë shtrat në formë piramide ose brazde. Të formohen bashkimet në fillim duke aplikuar një trashësi të plotë llaçi në tullat që do të vendosen. Lëvizja e bashkimeve kryesore nuk do të lejohet. Të vendosen tullat me llaçin në secilin bashkim të njësive për tu vendosur në vend. Të vendosen tullat me kujdes pa shqetësuar ato të cilat janë vendosur më parë.

7.3.7.3 Murature e Jashtme Me Tulla me Brima (38 Cm)

Të vendoset muratura me tulla me mbrima me një trashësi konstante ose të ndryshme në lartësinë prej 3m. Për punime te jashtme, në tullat e parafabrikuara duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat për të përfunduar punën në mënyrë të saktë. Në shtratin e katit të poshtëm duhet të vendoset një shtresë llaci çimentoje (e llojit 1:2), 2 cm trashësi minimale. Përzgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, cilësie dhe me cepa të pa dëmtuar dhe funde me sipërfaqe të ekspozuar. Të vendosen njësite e plumbces, paralele dhe me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Tulla me bira per murature te jashme 38 cm	Tulle prej argjile me bira, me trashësi 38 cm; duke përfshirë, arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skeleri

7.3.7.4 Murature e Jashtme Me Tulla me Brima (25 Cm)

Të vendoset muratura me tulla me mbrima me një trashësi konstante ose të ndryshme në lartësinë prej 3m. Për punime te jashtme, në tullat e parafabrikuara duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat për të përfunduar punën në mënyrë të saktë. Në shtratin e katit të poshtëm duhet të vendoset një shtresë llaci çimentoje (e llojit 1:2), 2 cm trashësi minimale. Përzgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, cilësie dhe me cepa të pa dëmtuar dhe funde me sipërfaqe të ekspozuar. Të vendosen njësite e plumbces, paralele dhe me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Tulla me bira per murature te jashme 25 cm	Tulle prej argjile me bira, me trashësi 25 cm; duke përfshirë, arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skeleri

7.3.7.5 Tulle me Bira (20 Cm) per Murature te Brendshme dhe te Jashtme

Muratura me tulle me bira (6 ndarje) me një trashësi prej 20 cm dhe llaci gëlqeror duke përfshirë hapjet vertikale, cepat, skelat dhe ndonjë gjë tjetër për të përfunduar ndërtimin me tulla. Në shtratin e katit perdhe duhet të jetë i niveluar me një shtresë llac çimentoje 1:2, 2cm trashësia minimale. Të përzgjidhen njësitë për njëtrajtshmëri dhe madhësi, përmbajtjen, barazimin dhe cepat e pa dëmtuar dhe fundet e sipërfaqeve të pa

ekspozuara. Të vendosen njësite e plumbces në mënyrë paralele me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Murature me tulla me brima 20 cm	Parapet me tulla me brima me një trashësi prej 20 cm

7.3.7.6 Murature e Brendshme Me Tulla me Brima (25 Cm)

Të vendoset muratura me tulle me bira 25cm duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat e tjera për të përfunduar punën në një mënyrë të duhur. Në shtratin e katit të parë duhet të nivelohet një shtresë llac çimentoje 1:2, me 2cm trashësi minimale. Zgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri, madhësi, pastërti dhe me cepa të pa dëmtuara, e me bashkime të duhura me njëtrashësi maksimale prej 10mm. Të ruhen sipërfaqet e ekspozuara të pastra dhe pa defekte.

Tulla me bira per murature te brendshme 25 cm	Tulle argjile me brima, me trashësi 25cm; duke përfshirë arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skelat

7.3.7.7 Murature e Brendshme Me Tulla me Brima (12 cm)

Të vendosen muratura me tulle me brima me trashësi prej 12cm dhe duke përfshirë materialin për cepat, hapjet vertikale, skelat dhe ndonjë kërkesë tjetër për të përfunduar punën në mënyrën e duhur. Në shtratin e katit të poshtëm, duhet të nivelohet një shtresë llaci çimentoje 1:2, me trashësi minimale prej 2cm. Të përzgjidhen njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, përmbajtjeje dhe me cepa të pa dëmtuara per sipërfaqe të ekspozuara. Të vendosen njësite e plumbces në mënyrë paralele me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Tulla me bira per murature te brendshme 12 cm	Tulle argjile me brima, me trashësinë 12cm; duke përfshirë arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skelat

7.3.8 BASHKIMI DHE ANKORIMI

Nëse nuk tregohet ndryshe, ndarjet te shtrihen ne drejtimin dysheme-tavan. Te lidhen ose ankorohen strukturalisht muret dhe ndarjet nga njëri tjetri. Në mënyrë të sigurt të ankorohen muret e jashtëm jo mbajtës dhe ndarjet e brendshme me strukturat e betonit në një mënyrë që të jepet qëndrueshmëria laterale ndërsa lejohet shmangia e pa kushtëzuar e ndërtimit mbi të. Të vendosen tërësisht ankorimet në bashkimet me llac.
Ndërthurjet e mureve të cilët nuk mbajnë peshën e godinës dhe mureve ndarës me ndarje ose mure të tjera: të lidhen me rrjete teli lidhese ne intervalet vertikale prej jo me shumë se 60cm ose me tulla që ndërthuren.
Muret të cilat perballin elemente betoni: të lidhet muratura me betonin me ankora të llojit rrjetë të vendosura ose futura në beton. Të pozicionohen ankorime jo më shumë se 300mm Vertikalisht dhe jo më shumë se 600mm horizontalisht.

7.3.9 LLAMARINAT

Te behet zgjatimi i llamarines 6mm jashtë faqes së jashtme të mureve, lart në lidhje bashkuese jo më pak se 150 mm, të shtypet cepi i jashtëm për të formuar pikoren. Qoshet e siguruar krijojnë një lidhje permanente siç tregohet. Të mundësohen llamarinat në gjatësi sa më praktike. Fundet të mos mbarojnë jo më pak se 35mm nga nyja ndërthurëse dhe 100mm për llojet e tjera. Të izolohen fundet në bazë të nevojës për të

siguruar mos depërtimin e ujit. Të parashikohen ndalesa në fund të qosheve te llamarines, aty ku muratura me tulla bashkohet me betonin dhe aty ku qoshet e llamarines përfundojnë brenda muratures.

7.3.10 VRIMAT PËR LARGIMIN E UJIT

Kurdoherë pergjate llamarinave ne mure, të mundësohen vrimat për largimin e ujit nga llamarina, jashtë. Vrimat për largimin e ujit duhet te hapen 600mm pergjate fugave.

7.3.11 PËRFORCIMET E FUGAVE HORIZONTALE

Të mundësohen përforcimet në dy shtresat sipër dhe poshtë hapjeve në mure dhe ndarjeve të njësive të betonit. Përforcimi duhet të jetë i vazhdueshëm përveç se në lidhjet e kontrollit dhe ato të zgjerimit. Përforcimi sipër dhe poshtë hapjeve duhet të shtrihet jo më pak se 600mm përtej secilës anë të hapjeve. Të jepen bashkësitë e salduara në formë L-je dhe në formë T-je për të përshtatur përforcimin e drejtë, tek cepat dhe bashkimet e mureve dhe ndarjeve. Të mundësohet mbulimi me llac për rrjeten të paktën 16mm për anët e jashtme të murit dhe 12mm për anën e brendshme të murit.

7.3.12 NJESI BETONI, ARKITRARËT DHE TRARË LIDHËS

Të mundësohen njësi të veçanta, të mbushen qelizat plotësisht me fino ose beton, dhe të jepen jo më pak se dy shufra përforcuese Nr5, vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Përforcimi do të ndërthurë një minimum prej 40 bar në prerjet e diametrit. Njësitë e ndërtuara me beton të dhëna për arkitrarët dhe trarët lidhes duhet të kenë sipërfaqe të ekspozuara të materialit të njëjtë dhe përmbajtje si njësitë ngjitur të ndërtimit. Arkitrarët duhet të jenë të drejta dhe të kenë të paktën 200mm aftesi mbajtëse në secilën anë. Njësi të tilla duhet të përdoren në zona ku të paktën tre radhë tullash mund të vendosen mbi njësi.

7.3.13 FUGAT E KONTROLLIT

Hekuri duhet të jetë i ndërprerë tek fugat per lidhje te ndermjetme traresh . Hekuri duhet të vazhdojë pergjate fuges për të gjithe traret lidhës strukturore. Të jepet aty ku tregohet njësi murature betoni-njësi murature me tulla. Bashkimet duhet të ndodhin në mënyrë të drejt për drejtë ose kundër njëri tjetrit në marrëdhënie me murin dhe duhet të mbushen sipas specifikimeve në norma dhe referenca ose nga një gomë sintetike ose ngjitës plastik .

7.3.14 FUGAT E EKSPANSIONIT

Të jepen aty ku tregohet në muret prej tulle. Të mbushen fugat ne menyre permanente me mbushës fleksibel dhe ngjitës.

7.3.15 VENDOSA E FINOS

Të vendoset fino nga ana e brendshme e mureve, vetëm nëse nuk miratohet ndryshe. Të ruhen parvazet, cepat, daljet dhe ndonjë sipërfaqe tjetër nga fino e rënë në tokë. Të hiqet fino nga sipërfaqe të tilla menjëherë. Fino duhet të përzihet mirë për të parandaluar ndarjen dhe të jetë mjaftueshëm e lëngshme për të rrjedhur në fuga dhe pergjate përforcimeve pa lënë hapësira.

7.3.16 FORMAT DHE MBËSHTETESET

Të ndërtohet në formën, drejtimin dhe dimensionet e elementeve të treguar. Të parandalohen shmangiet të cilat mund të rezultojnë në plasaritje, thyerje ose dëmtime të tjera për muraturen mbeshtetese. Të mos hiqen derisa keto elemente të jenë trajtuar.

7.3.17 PASTRIMI

7.3.17.1 Ruajtja

Gjatë operacioneve të pastrimit, të ruhet puna e cila mund të jetë e dëmtuar, njollosur ose ti ketë dalë ngjyra.

7.3.17.2 Qëllimi

Me mbarimin e punës së ndërtimit dhe para pastrimit, të priten lidhjet me defekt të llacit dhe të futen brenda ato të dala dhe të mbushen të gjitha vrimat në mënyrë të plotë me llac të para hidratuar.

7.3.17.3 Pastrimi

Të pastrohen sipërfaqet e ndërtimit me ujë të pastër dhe furça fibroze të forta dhe të shpëlahet me ujë. Aty ku ka njolla, llaç ose pjesë të tjera dheu të vazhdohet pastrimi me ujë të ngrohtë dhe ilaçe pastruese. Aty ku mbete dheu në tulla, të vazhdohet pastrimi si më poshtë: të lagen tërësisht sipërfaqet e ekspozuara me ndërtim prej tulle me ujë të pastër dhe me furça si dhe me solucion prej jo më shumë se 1 pjesë acid muriatik (HCl) me 9 pjesë ujë të aplikuara në një sipërfaqe prej 1 deri në 2 metra katrorë njëherësh. Menjëherë të shpëlahet pasi të jetë pastruar një zonë e tillë. Të mos përdoren solucionet kaustike ose pastrimi me rërë për të pastruar sipërfaqet. Ndërtimi me tulla duhet të jetë pa njolla, fluoreshentë, llaç ose fino dhe mbetjet. Të rregullohet dëmtimi, njollat dhe puna e ç'ngjyrosur në kushtet origjinal ose të japin punë të re.

8. TARRACAT DHE TARRACAT ME STRUKTURE METALIKE

8.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

8.1.1 REFERENCAT

Publikimiet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi në sasinë e referuar. Botimeve u referohen në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

8.1.1.1 Ligjet Dhe Normat E Aplikueshme Shqiptare

8.1.1.2 Standardet dhe Normat Evropiane

DIN 52130	Shtresat e bituminoze për izolimin ndaj ujit të çative – konceptet, përcaktimet, kërkesat.
DIN 52131	izolimi me shtresa bitumii për saldimin me ngjitje - konceptet, përcaktimet, kërkesat
DIN 52132	Shtresat e bitumenit polimeri për izolimin ndaj ujit të çative- konceptet, përcaktimet, kërkesat
DIN 52133	Shtresat e bitumonit polimeri për saldimin me ngjitje–Termat dhe përkufizimet, përcaktimet, kërkesat
DIN 52143	Rripat e bitumonit të çative me baze rrjete xhami; termat dhe përkufizimet, përcaktimet, kërkesat
DIN EN 1253	Ulluqet për godinat
DIN 4102	Elementët dhe mbrojtja e materialeve të ndërtimit ndaj zjarrit
DIN 4109	Izolimi ndaj zhurmave në godina; kërkesat dhe testimi

DIN 18232	Sistemet e kontrollit të nxehtësisë dhe tymit
DIN EN 54	Sistemet e lajmërimit dhe dedektimit të zjarrit
DIN 18451	Procedurat kontraktuale për punimet e ndërtimeve - Pjesa C: specifikimet e përgjithshme teknike për punimet ndërtimore në godinë; skeleria
DIN 18336	Procedurat kontraktuale për punimet e ndërtimeve– Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimeve; punimet hidroizoluese
DIN 18339	Procedurat kontraktuale të ndërtimit - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet e ndërtimeve; punime per flete metalike mbuluese ne cati e mure.
DIN 18360	Procedurat kontraktuale për punimet e ndërtimeve - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për punimet në godinë; Punime per ndërtime metalike
DIN EN 13163	Produktet e izolimit termik për godinat – Produktet industrial prej polistireni (EPS) – Specifikimet
DIN EN 13499	Produktet e izolimit termik për godinat – sistemet e përbëra të izolimit termik nga jashtë (ETICS) - Specifikimet
DIN EN 826	Produktet e izolimit termik për përdorim në godina – Përcaktimi i sjelljes në shtypje
DIN EN 1396	Alumini dhe përzierjet e aluminit – flete mbeshtjellese e lyer për aplikimet e përgjithshme
DIN EN 546	Alumini dhe përzierjet e aluminit - Letër
DIN 1748	Xhamat në godinë – Produkte të veçanta bazë - Pjesa 1: Xhama borosilikatë Xham në godinë – Produkte të veçanta bazë - Pjesa 2: Qeramika prej xhami
DIN 17440	Çelik i pandryshkshëm – kushtet e dërgesës teknike për rrjeten e tërhequr
DIN EN 573	Alumini dhe përzierjet e aluminit – Përbërja kimike dhe format e produkteve të punuara
DIN EN 1301	Alumini dhe përzierjet e aluminit – Rrjete e tërhequr
DIN EN 612	Ulluqet anësore dhe tubacioni për rrjedhjen e shiut prej fletëve metalike – Përcaktimet, klasifikimi dhe kërkesat
DIN EN 988	Zinku dhe përzierjet e zinkut– Specifikimet për produktet role për godinat;
DIN EN 1462	Menteshat për cepat e ulluqeve – Kërkesat dhe testimi
DIN EN 10147	Rripat e çelikut të zhytur në mënyrë të vazhdueshme në zink të nxehtë dhe fletët për formimin e ftohtë – Kushtet teknike të dërgesave.
DIN EN 10214	Alumin-zink në mënyrë të vazhdueshme i zhytur dhe i lyer fletë e rrip prej çeliku. Kushtet teknike të dërgesave
DIN EN ISO 1461	Lyerjet e galvanizuara në zhytje të nxehta mbi artikujt e çelikut të fabrikuar – specifikimet dhe metodat e testimit
DIN ISO 4042	Lidhësit – lyerjet me pllakëza elektroni
DIN V ENV 1993	Vizatimi i Strukturave prej Çeliku
DIN EN 10025	Vizatimi i Strukturave prej Çeliku

8.1.1.3 Dërgesa

Të dërgohen materialet në sasi të mjaftueshme për të lejuar vazhdimësinë e punës.

8.1.1.4 Magazinimi dhe Trajtimi

Magazinimi dhe trajtimi i materialeve në një mënyrë për të ruajtur atë nga dëmtimet, ekspozimi ndaj flakës së hapur ose burime të tjera ndezëse, dhe nga lagështia, kondensimi ose thithja e lagështisë. Të ruhet në një godinë të mbyllur ose kontenier i cili mundëson një mjedis të ventiluar të thatë dhe të përshtatshëm. Të zëvendësohen materialet e dëmtuara me materiale të reja. Rolete e materialit duhet të ruhen vertikalisht.

8.1.2 KUSHTET MJEDISORE

Të mos vendoset izolimi i tarraces gjatë motit të përkeqësuar ose kur temperatura e ajrit është nën 5 gradë celsius ose kur ka prani ngricash, akulli ose lagështi të dukshme nëçati ose kur ka shumë erë.

8.2 PJESA 2 – PRODUKTET DHE MATERIALET

8.2.1 BARRIERAT AVULLIZOLUESE

8.2.1.1 Barriera avullizoluese

Asfalt-i ngopur
Element bazë për aplikimet me një shtresë, që peshon jo më pak se 17.5 kilogram për 10 m2

8.2.1.2 Barriera avullizoluese

Fletët prej Polietileni
Barriera avullizoluese do të jetë një fletë polietileni me trashësi prej 0,50mm, dhe me pershkrueshmeri avulluese më të madhe se 2-100m, me dobesim në tërheqje 450%. Fletët merren nga grimca të pastra, neutrale ose me ngjyrë të bardhë, dendësia Kg/dm3 0.95, vendosja në të thatë në bazë të njërës prej procedurave si më poshtë:
-me një kalim prej 20cm dhe kthim prej 10cm në pjesët vertikale,
-me një kalim prej 5cm, të puthitur me një bashkim të vetëm me gjerësi prej 8cm, 10cm kthim në pjesët vertikale.
Lidhjet me të gjitha pjesët që ngelen te dala me shiritin e fugave, gjithashtu të përdoren në muret vertikale.
Shtresa e ndarjes do të jetë një batanije artificiale e cila peshon 300 g/m^2.
Membrana e pershkrueshme e shtreses se varfer në nivelin tokësor do të jetë një fibër sintetike jo e thurur, e miratuar, në formë flete filtër.

8.2.2 IZOLIMI

Izolimi i tarraces do te behet me **panele polistireni** (XPS) me dendesi te larte. Paneli i polistirenit do te shërbejë si shtresë mbështjellëse, i radhitur për utilizimin e gazrave në përputhje me rregulloret e BE dhe ato kombëtare (CO_2), përçueshmëri termike λ_0 0.033 W/mK, fuqi ngjeshëse ≥3.7 kg/cm^2, faktori i rezistences ndaj difuzionit te avullit te ujit μ 160÷224. Panelet do të kenë profile si kapak te mbivendosur nga të 4 anët për eliminimin e urave termike, volumi i thithjes se ujit ≤0.10%, klasa e reagimit ndaj zjarrit duhet te jete :Euroclass E teknikisht i pershtatshem për izolim të tarracave të lehta e të sheshta në përputhje me standardet DIN.

8.2.2.1 Llojet e Izolimit

Instalimi
Panelet duhet të vendosen me kthina të përputhura

Shresa filtruese anesore te mbivendoset 75cm duke u kther vertikalisht, në mënyrë që të ruhet membrana nga dëmtimet qe ndodhin poshte izolimit për shkak të mbetjeve shkaktuar nga depertimi i ujit;
Të vendosen vrimat e tubave te shkarkimit dhe zgarat e zhavorrit, për të siguruar vazhdimësinë e shtresës së izolimit, panelet e izolimit gjithashtu do të vendosen përgjatë ose mbi kanalet kulluese, e më vonë të jenë të mbuluara me pllaka betoni;
Të përdoren hapësirat/ shtresa e zhavorrit nën shtesës fundore të rrugëkalimit për kullim uji ose në rastin e tarracave te shfrytezueshme, shtresa e duhur e betonit te varfer ose shtrese llaç çimento në përputhje me ngarkesat strukturore te llogaritura.

Izolimi i parapetit do të jetë me panele mineral me lesh guri, me përcjellje termike λ_0 0.035 W/mK, dhe koeficient rezistence për shpërndarjen e avullit μ 1, delaminimi> 10 kPa, 10% tensioni gjate shtypjes > 30 kPa, klasa e reagimit ndaj zjarrit: A1 - material jo i djegshem.

Instalimi
Është e rëndësishme që në raste zjarri, panelet, detajet fiksuese te jene projektuar brenda normave ne menyre qe te jene te qendrueshme . Prandaj:
Të gjithe elementet fiksues do të jenë prej çeliku dhe jo alumini,
Kendoret /kanalet të jenë prej çeliku me një trashësi minimale prej 1,6mm.
Të gjitha mbërthimet të jenë prej çeliku te pa oksidueshem.

8.2.2.2 Trashësia e Izolimit

Do të mundësohet në bazë të nevojës për të mundësuar rezistencën termike. Trashësia duhet të bazohet mbi vlerën e përcaktuar për izolimin "R" Izolimi mbi dyshemetë prej çeliku duhet të përmbushë si vlerën e përcaktuar R dhe trashësinë minimale për gjerësinë e valezimeve metalike në bazë të rekomandimeve të botuara të prodhuesit të izolimit. Trashësia nuk do të jetë mëpak se 30mm. Trashësia tipike do të jetë 30, 50, 80 dhe 100mm për panelet me gurë mineral, 50, 80 dhe 100mm për panelet me polistiren.

8.2.3 MEMBRANA HIDROIZOLUESE

Dy membrana hidroizoluese kundra lageshtires të parafabrikuara në bitumen elastik-plastik-merik me një shtresë fibër xhami dhe ose shtresë poliestre, të aplikuar mbi shtresen bituminoze, në sipërfaqet e anuara dhe ato horizontale, me mbivendosje prej 10cm mbi njëra tjetrën. Materiali duhet të çertifikohet si i përputhshëm me materialin izolues për të parandaluar humbjen e plasticitetit.
Karakteristika:
Zgjatimi në fundet e përbërësve të papajisur (NFT46002) 2000%,
Rezistenca ne terheqje gjatesore 90 gradë transversale 80Kg/5cm,
Zgjatimi në këputjet gjatesore 50% transversale 50%
Rezistenca ndaj lodhjes në plasaritjet aktive në 0°C 10,000 cikle - në -10°C - 1,000 cikle,
Fleksibiliteti ndaj të ftohtit - 25°C.

8.2.4 GJEOTEKSTILI

Ndarja e shtresave do të arrihet nëpërmjet furnizimit të një shtrese të vetme jo të thurur, e përbërë nga fibrat e polipropilenës, me karakteristikat si më poshtë:
Fuqia në tërheqje 12kN/m (ISO EN 10319),
Zgjatimi në keputje prej jo më pak se ose e barabartë me 42% (EN ISO 10319),
Rezistenca ndaj goditjeve të paktën 24mm (EN ISO 13433),
Efikasiteti ruajtës i barabartë me 124N (EN ISO 14574).

8.2.5 LLAÇI I ÇIMENTOS DHE RËRËS

Mastar prej çimentoje dhe rërë i vendosur për të arritur ngjitjen e shtresave te tarraces. Nënshtresa e llacit të çimentos, doza 3.00 kuintal deri në 1.00 m3 rërë, 30mm trashësia mesatare (e mirë niveluar) për betonin dhe pllakat qeramike të dyshemesë, të cilat duhet të aplikohen me ngjitës, të përfunduara me fuge ekspansioni perimetrale (pllakat me materiale të forta).

8.2.6 SHTRESAT E TARRACAVE

Shtrimi i tarracave për tarraca teknike, tarraca te shkelshme, shkallët dhe tarracat e kafazit te ashensorëve.
Shtrese beton granili t=4cm, me zgare te elektrosalduar Ø=6mm, çdo 20 x 20 cm.

8.2.7 FUGAT E SHTRIMIT

Fugat e shtrimit duhet të kryhet duke përdorur gjatë cepave 2x50x50mm material izolues nga secila anë e fugës. Një rrip ndarës do të vendoset nga të dyja anët e fuges me gjerësi minimale prej 33cm për të parandaluar ngjitjen dhe për të lejuar lëvizjen e fugave nën mbulim. Fuga duhet të mbulohet duke përdorur një rrip 75cm të gjatë të fletëve të përdorura te tarraca. Ky rrip duhet të fiksohet nga të dyja anët e fugave mbi një minimum prej 25cm.

8.2.7.1 Mbulesat metalike e paralyera për parapetet e tarracave (t=0.5mm kthimi i fletës) duke përfshirë të gjitha aksesorët

Montimi e furnizimit per mbulesat e parapeteve,llamarinat bashkimet dhe ndonjë material tjetër ose element metalik mbylles përgjatë mureve tarracës, të gjatësive të ndryshme, së bashku me ngjitjet, fugat, bulonat dhe vidat e kapëset me dado, duke përfshirë edhe puntorine për instalim; Elementët do të kryhen në fletë të paralyera të galvanizuara.
Fletët do të jenë të llojit Fe Z3; trashësia prej jo më pak se 6/10mm, me galvanizim të nxehtë e të vazhdueshëm të llojit të mesëm-rëndë të llojit 350g/m^2 lyerje me zink. Materialet do të jenë të ruajtura në sipërfaqes sipas specifikimeve si më poshtë: elementët të cilët mund të kenë vuajtur prerje, ngjitje ose ndonjë lloj punimi tjetër bashkues gjatë punimeve ose instalimit, në mënyrë që të shkaktojnë dëmtim tek shtresa me zink, duhet të jenë të mbuluara me kujdes me bojën e bazuar në bojë zinku joorganik të përbërë nga polimeri zinku joorganik me shtimin e zinkut metalik.
Aty ku përshkruhet në skicimet ekzekutive, materialet do të dorëzohen në kantier të paralyera në përputhje me procedurat e mëposhtme:
- një shtresë boje ngjitëse me dy përbërës (40-50 mikron) si shtresë fillestare për shtresat e tjera,
- një shtresë e ndërmjetme me shtresë ngjitëse me dy përbërës (60/80 mikron),
- një shtresë fundore prej poliuretani që nuk zverdhet, dhe mos bëhet si shkumës (30-40 mikron).

8.2.8 GOZHDIMI I IZOLIMIT

Fiksueset/ mberthesat duhet të jenë të përshtatshme për materialin tarracës. Nuk duhet të demtojnë çatinë në mënyrë që të shmangin shtrembërimin. Nëse soleta e tarracës nuk ka aftesi mbajtese te pershtatshme atëherë duhet të përdoren ankora injektuese.

8.2.9 ULLUQET E TARRACES

Ulluqet e tarracës duhet të kenë flanga shtrenguese në përputhje me DIN EN 1253. Zgavrat mbuluese duhet të jenë të lëvizshme.

Fletët duhet të jenë të llojit Fe Z3; me një trashësi prej jo më pak se 6/10 mm, me galvanizim të vazhdueshëm të nxehtë të llojit të mesëm-rëndë 350g/m^2 me lyerje me zink. Materialet e sipërfaqes duhet të jenë të ruajtura si më poshtë:
Elementët të cilët mund të vuajnë prerje, ngjitje ose punime të tjera mbuluese gjatë bashkimit ose instalimit, në mënyrë të tillë që të dëmtojnë shtresën e zinkut, duhet të mbulohen me kujdes me bojëra me bazë zinku jo organik të përbërë nga polimeri jo organikë me shtimin e zinkut metalik.
Aty ku përshkruhet në skicat e zbatimit , materialet duhet të dërgohen në kantier të para lyera në përputhje me procedurën e mëposhtme:
- një dorë boje me ngjitës me dy përbërës (40-50 mikron) si një bazë për strehët e mëvonshme,
- një shtresë e ndërmjetme më rrëshirëngjitëse prej dy përbërësish (60/80 mikron),
- një bojë e sipërme prej dy përbërësish prej poliuretene e cila nuk zverdhet, dhe nuk kthehet në shkumës (30-40 mikron).

8.3 PJESA 3 - ZBATIMI

8.3.1 EKZAMINIMI DHE PËRGATITJA

8.3.1.1 Inspektimi i Sipërfaqes

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të sheshta dhe të thata. Të kontrollohet shtresa e tarracës duke përfshire dhe pjerrësite deri tek kanalizimet kulluese, për defekte para se të fillohet puna. Para se të instalohet barriera avullizoluese dhe izolimi tek shtresat, te kryheti si më poshtë:
Ekzaminimin e sipërfaqes për tu siguruar që fugat janë mbushur dhe nivelimi mundëson sipërfaqe të përshtatshme për instalim të barrierës avullizoluese

8.3.1.2 Përgatitja e Sipërfaqes

Të riparohen defektet e duhura dhe pasaktësitë në sipërfaqet e tarracës për të eliminuar kullimin e paket dhe pikat.

8.3.2 INSTALIMI I BARRIERAVE AVULLIZOLUESE

8.3.2.1 Barriera Avulliizoluese Tek Shtresat E Betonit Të Parafabrikuara

Të instalohet barriera e avullit në kontakt të drejtpërdrejtë me sipërfaqen e tarracës. Barriera e avullit duhet të konsistoje ne një brez asfalti te ngopur. Të shtrohet barriera avullizoluese ne drejtim te pjerresise se tarraces. Shtresa të vendoset brenda plus minus 15 gradë celcius. Barriera e avullit duhet të jetë pa shtrembërime ose përthyerje. Të shtyhen flluskat e ajrit për të arritur ngjitje të plotë ndërmjet sipërfaqeve. Tek cepat e mureve dhe tek të daljet e tjera vertikale, të zgjatet barriera e avujve 150mm për të formuar një kthine e cila më vonë do të përthyhet mbi anet e izolimit të barrierës avullizoluese

8.3.3 INSTALIMI I IZOLIMIT

8.3.3.1 Polistiren /Panelet Me Lesh Guri

Të instalohen panele jo kopozite polistireni. Të ngushtohen dhe ngjeshen fugat e ndërthurjeve në fushë. Aty ku tregohet, të mundësohen rripat e ngushta në ndërthurjet e tarracës me muret, parapetet dhe të shtrihen përtej dhe mbi tarracë.

8.3.3.2 Izolimet e Tarracave Me Funde Të Kthyera

Për tarracat e pjerrta ose tarracat e sheshta me pak pjerresi për ujin e shiut, izolimi duhet të përshtatet me animin prej jo më pak se 2% në një thellësi mesatare prej 70mm. Në përgjithësi izolimi duhet të instalohet në mënyrë që të shmangen urat termike.

8.3.3.3 Rripat Dhe Përkuljet e Kthyera

Të mundësohen përthyerjet e cepave te të njëjtit material si izolimi i tarracës. Perthyerja e aneve kthyer duhet të ketë një inklinim prej 45 gradësh dhe një lartësi vertikale prej 100mm.

8.3.3.4 Instalimi i Ulluqeve Të Tarracave

Tek ulluqet e tarracave izolimi duhet të jetë me kënde të vogla (përreth 20mm)

8.3.4 INSTALIMI I MEMBRANËS HIDROIZOLUESE

Membranat e kundër lagështisë të parafabrikuara në bitumen polimerolast-plastik-merik, të aplikuara tek shtresa e ngjitësit të bitumenit në sipërfaqet horizontale dhe ato të pjerrta, anët e kalueshme prej 10cm, duke përfshirë punën dhe operacionet e përkohshme; me një shtresë fibër xhami dhe ose fletë poliestre përforcuese. Etiketimi i prodhuesit të topave nuk duhet të hiqet deri në momentin e përdorimit.

Për çdo dy shtresa ngjitëse ku aplikohet nxehtësia. Të hapen fletët, të vendosen në vend me 100mm anime dhe funde prej 150mm. Të aplikohet nxehtësia tek pjesa e poshtme e topit dhe në 75mm në anën e poshtme në mënyrë që membrana të ngjitet plotësisht me nënshtresën. Të sigurohet një rrjedhje e plotëbitumen prej të paktën 10mm, për të mos kaluar 25mm, në ane dhe në funde ndërsa membrana rrotullohet përpara dhe ngjitet me nënshtresën. Duhet kushtuar kujdes në mënyrë që sipërfaqja të mos tejnxehet. Pasi membrana të jetë ngjitur me nënshtresën, të kontrollohen anët me një mistri të nxehtë për të siguruar që anët janë plotësisht të ngjitura. Në anët kur ngjitja e plotë nuk arrihet, të ri ngrohen dhe të kalohet përsëri mistria. Bashkimet e membranës duhet të jenë të shkallëzuara me të paktën 50cm.

Të aplikohet ngjitja e fletëve të bitumenit në këndet e krijuara aty ku çatia ngjitet me muret, animet, ventilatorët dhe tubat dhe sipërfaqet e tjera vertikale (minimumi 150mm), në përputhje me udhëzimet e printuara të aplikimit nga prodhuesi dhe aty ku është e nevojshme të bëhet puna në mënyrë që të jetë e izoluar ndaj ujit. Këto ngjitje duhet të jenë të pozicionuara ndërmjet dy shtresave me shtresën e sipërme në mënyrë uniforme të lidhur me të. Bashkimi duhet të marrë një shtresëbitumen të lëngshëm të nxehtë. Fletët e çatisë/tarracës duhet të vendosen në cepa 100x100 mm (rripa të anuar) prej materiali izolues në cepin ndërmjet sipërfaqeve horizontale dhe atyre vertikale.

8.3.5 ULLUQET E TARRACAVE

Membrana izoluese ndaj ujit duhet të futet në pjesën që del përpara dhe të sigurohet. Ulluqet me kthesa në formë S për të parandaluar daljen e erërave duhet të mbushen me ujë. Të gjitha ulluqet duhet të jenë të zhytura në mënyrë që plotësisht të tarracën përreth dhe duhet të instalohen në mënyrë që të parandalojnë urat termike.

8.3.6 INSTALIMI I SHTRESËS SË PA THURUR

Të aplikohet rrip i tendosur i jashtëm në përputhje me udhëzimet e printuara të prodhuesit. Të zgjaten daljet e tarracave, deri tek sipërfaqet vertikale.

8.3.7 LLAÇI I ÇIMENTOS DHE RËRËS

Para se të mbulohet me shtresë izoluese, shtresa e llaçit te çimentos dhe rërës duhet të vendoset në dyshemenë e tarracës. Trashësia 50mm.

8.3.8 MBULIMI I FUGAVE

Duhet të përdoren në çati/tarracë fugat e ekspansionit. Të mos kufizohet kullimi i ujit nga çatia/tarraca.

8.3.9 MBERTHIMI I IZOLIMIT

Mbërthimi do të kryhet tek bashkimet e fletëve te çatisë/tarracës 10cm nga cepi i fletës. Të paktën 3 mbërthesa për m^2 duhet të mundësohen për godinat deri në 20m gjeresi me një minimum prej 6 mbërthimesh për metër në cepat dhe 9 mberthime për metër në cepa.

8.3.10 FIKSIMET

Fiksimet për punime metalike (vidat, ankorat dhe upat, etj.) duhet të jene të përshtatshem për materialet në të cilat ata instalohen. Duhet të shmanget ushtrimi i një force të pa nevojshme gjatë instalimit të përbërësve.

8.3.11 MBULIMET E PARAPETEVE

Veshja që mbulon parapetet e murit duhet të jenë me çelik në ngjyrën e rënë dakord me Mbikëqyrësin. Fugat në veshje duhet të nënvendosen me fletë bashkuese.

8.3.12 PËRBËRËSIT E GALVANIZUAR NË TË NXEHTË

Përbërësit e galvanizuar me të nxehtë duhet të formohen para se të zhyten. Nëse shpimi i materialeve të galvanizuara është i nevojshm pasi ato të jenë zhytur atëherë brima e shpimit duhet të trajtohet me lyerje galvanizuese të ftohtë menjëherë pas shpimit.

8.3.13 ULLUQET

Ulluqet duhen vendosur me një gradim prej të paktën 3mm për metër linar vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Ulluqet prej PVC nuk janë të lejuara.

8.3.14 TUBAT E SHKARKIMIT

Tubat vertikale të shkarkimit duhet të jenë çelik i galvanizuar. Lidhjet duhet të jenë të dukshme dhe tapat duhet të zgjaten të paktën 5cm brenda foleve. Nëse bashkimi ruhet ne skaj i atëherë ngjitja nuk do të jetë e nevojshme.

8.3.15 BASHKIMET ME NGJITJE

Mbivendosjet duhet të jenë të paktën 10mm. Për njësitë horizontale dhe pak të pjerrta ngjitjet kërkohet një saldim me gjerësi 10 mm. Hapësira e ngjitjes/saldimit nuk do të jetë më e madhe se 0,5mm për të siguruar veprim e duhur te kapilaritetit.

8.3.16 ANET E MPREHTA METALIKË

Cepat e mprehtë të fletëve metalike do të gërryhen. Për fletët deri në 1mm në trashësi, duhet përdorur një thep mbrojtës.

8.3.17 HEQJA E PRERJEVE DHE SHPIMEVE

Prerjet dhe shpimet metalike si edhe pluhuri metalik i prodhuar gjatë aktiviteteve gërryese duhet të pastrohet nga punimet permanente menjëherë pas përfundimit të punimeve prerëse.

8.3.18 RUAJTJA

8.3.18.1 Ruajtja E Izolimit Tashmë Të Aplikuar Dhe Hidroizolimit

Te mos lejohet ndërtimin me faza. Të ruhen fundet e hapura të secilës ditë pune membulesa dhe nderprerjen e perkohshme te ujit, të hiqen kur puna rifillon. Të ruhen hapësirat e lëna të hapura ndërmjet izolimit dhe parapeteve ose mureve të tjera, hapësirat në trotuare, dhe fugat e ekspansionit, deri sa te aplikohen llamarina të përkohshme. Të mos lejohet magazinimi, kalimi, me mjete me rrota ose transportimi me kamionë në mënyrë të drejt për drejtë në izolim ose në sipërfaqet me çati tarracë.

8.3.18.2 Materialet Dhe Puna E Dëmtuar

Të kthehet puna dhe materialet të cilat dëmtohen gjatë ndërtimit në kushtet origjinale ose të zëvendësohen me materiale të reja.

8.3.18.3 Punimi Me Materiale Të Nxehta

Ruajtja e cilindrave prej gazi në depo nëntokësore, në shkallë, korridore dhe hapësirat e shpëtimit është e ndaluar. Gjatë punës me materialet prej gazi të nxehta pajisjet e mbrojtjes ndaj zjarrit të mbajtura në dorë në përputhje DIN EN 3 duhet të jenë të gjindshme në mënyrë të menjëhershme ngjitur me zonën e punës.

8.3.18.4 Ruajtja e Punimeve Metalike

Të gjitha punimet metalike në nivelin e tarracave duhet të mbrohen kundër gërryerjes së bitumenit dhe ndryshkut të bardhë duke aplikuar një shtresë mbrojtëse në përputhje me materialin e çatisë/ tarracës deri në 2mm përmbi nivelit të çatisë së përfunduar.

8.3.18.5 Pastrimi

Me përfundimin e punimeve të gjitha mbetjet duhet të hiqen nga kantieri duke përfshirë edhe mbetjet të cilat kanë rënë në parvaze, ulluqe dhe përgjatë godines apo në nivelin e katit përdhe.

8.4 PANELET SANDWICH

8.4.1 TË PËRGJITHSHME

8.4.1.1 Referenca

Ky specifikim zbatohet për të gjitha veçoritë në ndërtimin dhe fabrikimin e paneleve duke përdorur panel sandwich të izoluar me lesh xhami, dhe rregullimet në produkt të lidhura me standardet dhe ligjet e mëposhtme.

Publikimet e renditura më poshtë formojnë pjesë të këtij specifikimi deri në atë masë që është referuar. Publikimet e referuara në këtë tekst vetëm në përcaktimin bazë.

8.4.1.2 Produktet

Miratimi i produktit të ofruar jepet në kantierin e ndërtimit vetëm pas paraqitjes së një kampioni të pranueshëm për secilin lloj.

8.4.1.3 Karakteristikat e Panelit me Lesh Xhami

Mbulimi me panele sandwich;
Panele të përbëra me dy fletë mbuluese alumini dhe një bërthamë minerale;
Panele muri sandwich;
Panele të përbëra me dy fletë mbuluese alumini dhe një bërthamë minerale.

8.4.2 EKZEKUTIMI

8.4.2.1 Të përgjithshme

Për të gjitha materialet që janë përdorur për instalim do të duhet të kushtohet vëmendje për të parandaluar, dëmtime apo gërvishtje.
Instalimi i paneleve sanduiic me lesh xhami do të bëhet nga një specialist i instalimit të paneleve me aftësi të mjaftueshme.
Kornizat mbështetëse do të përdoren si materiale të galvanizuara apo materiale të lyera me antindryshk.
Do të përdoret një shtresë me material të papërshkueshëm pas palosjes për pjesën e prerë e cila nuk është e mbuluar me bojë ose do të lyhet me antindryshk.
Në rast të gërvishtjeve të vogla, do të lyhet me bojë spray.

9. HIDROIZOLIMI

9.1 PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

9.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në masën e marrë për referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin e tyre bazë.

9.1.1.1 Normat Dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

9.1.1.2 Normat dhe Standardet Evropiane

DIN 18195 – 1	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 1: Parimet, përcaktimet, atributet e llojeve të izolimeve ndaj ujit.
DIN 18195 – 2	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 2: Materialet.
DIN 18195 – 3	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 3: kërkesat për materialet e tokës dhe të punës e karakteristikat e tyre.
DIN 18195 – 4	Hidroizolimi i godinave - Pjesa 4: izolimi ndaj ujit dhe lagështirës së terrenit (kapilaritetit, uji i mbetur) dhe mos akumulimi i ujit të mbetur nën shtresat e dyshemesë dhe në mure, skicimi dhe ekzekutimi.
DIN 18195 – 5	Hidroizlimi i godinave - Pjesa 5: izolimi ndaj ujit kundër ujit që nuk ka presion në dysheme dhe në zonat e lagështa; skicimi dhe ekzekutimi.
DIN 18195 – 6	Hidroizolimi i godinave dhe strukturave; fletët izoluese të nënshtruara ndaj presionit hidrostatik nga brenda; skicimi dhe puna.

9.1.2 PARAQITJET

Duhet te paraqiten:
Të dhënat e kataloguara të Prodhuesit
Panele Izoluese
Fleta e bitumenit të modifikuar me polimer
Bitum prajmer
Ngjitjet e kryera me shtypje
Ngjitjet e bashkimeve
Udhëzimet
Panele Izoluese
Fleta e bitumenit të modifikuar me polimer
Bitum prajmer
Ngjitjet e kryera me shtypje
Ngjitjet e bashkimeve

Të përfshihen udhëzime të detajuara aplikimi dhe skicat standarde të ndryshuara në bazë të këtyre kërkesave specifike. Në mënyrë specifike të identifikohet me shkrim, ndryshimet ndërmjet udhëzimeve të prodhuesit dhe kërkesave të specifikuara.

9.1.2.1 Deklarimet

Cilësimi i prodhuesit;
Cilësimi i veglës;
Çertifikoni që prodhuesi i membranës së modifikuar me bitumen përmbush kërkesat e specifikuara.

9.1.3 DËRGIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

9.1.3.1 Dërgimi

Të sigurohet shpërndarja e materialeve në kontenierët dhe roleve të pahapura origjinale të ardhura nga prodhuesi me etiketa qartësisht të lexueshme. Shënoni si të tilla dhe hiqni materialet e lageshta nga kantieri. Aty ku materialet janë të mbuluara nga një specifikim i dhënë, kontenieri duhet të ketë numrin e specifikimit, llojin dhe klasën sipas aplikimit. Të dorëzohen materialet në sasi të mjaftueshme për të lejuar që puna të vazhdojë pa ndërprerje.

9.1.3.2 Magazinimi

Të ruhen materialet ndaj thithjes së lagështisë. Të ruhen vertikalisht materialet e rrotulluara në role dhe në platforma të ngritura ose paleta një nivel më lartë në vendndodhje të thata me ventilim të duhur, si psh godinë ose kontenier i mbyllur. Rolete nuk duhet te ruhen në godina në ndërtim deri sa betoni, llaci dhe fino të ketë përfunduar dhe të jetë i tharë. Rolete te ruhen në temperatura mbi 10 gradë Celsius për 24 orë menjëherë pas aplikimit. Të mos ruhen materialet jashtë vetëm nëse nuk miratohen nga Mbikëqyrësi.

9.1.3.3 Trajtimi

Të zgjidhet dhe operohet marrja e materialeve në mënyrë që të mos dëmtohet membrana e aplikuar. Të parandalohet dëmtimi tek anet dhe fundet e materialeve në forme rolesh.

9.1.4 KËRKESAT MJEDISORE

Të mos instalohet membrana kur temperatura e ajrit është nën 4 gradë Celsius, gjatë çdo forme lagështie, shiu, mjegulle, ose kur ka akull, ngricë, lagështi të dukshme në çati/tarracë.

9.2 PJESA 2 - PRODUKTET

9.2.1 IZOLIMI

9.2.1.1 Paneli izolues

Panet izoluese për soletat e kateve përdhe, të jenë polistiren (XPS) të një trashësie siç tregohet në vizatimet teknike.

9.2.1.2 Përbërësit

9.2.1.2.1 Ngjitësi

Sipas rekomandimit të prodhuesit të izolimit.

9.2.2 HIDROIZOLIMI

9.2.2.1 Membranë e Papërshkueshme

Në polimer bitumen elastik-plastik-merik, me një shtresë prej fibër xhami ose përforcim të fletëve prej poliestre, të cilat peshojnë 3Kg/m^2 si minimum. Materiali duhet të çertifikohet si i përputhshem me materialin izolues për të parandaluar humbjen e plasticitetit. Tiparet:
Zgjatimi në fundet e përbërësve të papajisur (NFT46002) 2,000%,
Rezistenca në tërheqje gjatësore 90 gradë transversale 80Kg/5cm,
Zgjatimi në këputjet gjatesore 50% transversale 50%
Rezistenca ndaj lodhjes në plasaritjet aktive në 0°C 10,000 cikle - në -10°C - 1,000 cikle,
Fleksibiliteti ndaj të ftohtit - 25°C.

Për muret	Membranat kundra lagështisë për muret, 4mm trashësi, në bitumen polimer elastomerik, të aplikuar mbi shtresën e parë të bitumenit
Për themelet	Membranat kundër lagështirës për themelet, 4mm trashesi, në bitumen polimer elastomerik, të aplikuar në shtresën e parë të bitumenit
Për soletat	Membranat kundër lagështirës për pllakat, 4mm të trashanë bitmen polimeri elastomerik, ta aplikuar në shtresën e parë të bitumenit

9.2.2.2 Bitum i cilësisë së parë

Në një shtresë bitumi ose emulsion

9.2.2.3 Fletë Polietileni (PE)

Fletë PE e stabilizuar me UV të shtresës së parë të PE dhe në përputhje me EN 13984:2013 me karakteristikat e mëposhtme: vlera në SD > 100m, trashësia min 100µ, rezistenca e temperaturës +70°C, temperatura e aplikueshme -10°C deri në +40°C

9.2.3 FUGAT

9.2.3.1 Mbushjet e fugave

9.2.3.1.1 Fugat e ekspansionit

Mbushësi duhet të jetë i përputhshëm me materialin ngjitës të fugave. Fugat e ndalimit të ujit duhet të jenë prej fugave te ekspansionit 225mm në gjerësi, materiali: gomine. Të gjitha fugat ndërtimore dhe ato të ekspansionit janë të përfshira në çmimet e betonit.

9.2.3.2 Lidhja e ndërprerjeve

9.2.3.2.1 Materialet bllokuese

I shtypshëm, i pa zvogëlueshëm, jo reagues me ngjitës të bashkuar dhe të llojit jo absorbues si shufrat plastike, pa vajra ose bitumen. Materialet bllokues duhet të kenë një përthithje uji prej jo më shumë se 5% të peshës pas testimit. Materialet bllokuese duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e instalimit të prodhuesit të ngjitësit te fugave dhe të jenë të paktën 25% më të mëdhenj në diametër se sa gjerësia e bashkimeve si të treguara.

9.2.3.2.2 Shiriti Ndarës

Shiriti prej poliestre ose polietilene, 0,08mm 3mm trashësi minimale, ose shirit maskues, jo reagues, jo thithës, e ngjitës me gjerësinë te barabarte te fugave siç tregohet. Shiriti ndarës duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e instalimit të prodhuesit të ngjitësit te fugave.

9.2.3.3 Mbylljet e fugave

Silikon me përbërës i veçantë i Aplikuar në të ftohtë. Ngjitësi prej silikoni duhet të jetë vetë nivelues, që nuk trajtohet nga acidi

9.2.3.4 Lidhjet me kunja

Shufrat duhet të përmbushin madhësite dhe gjatësite e treguara për shufrat metalike.

9.2.4 GJEOTEKSTILI PER STRUKTURAT

9.2.4.1 E përgjithshme

Aty ku përcaktohet në vizatimet teknike ose sipas drejtimit të Mbikëqyrësit (mure fasade, tarraca, etj.), te mundesohet pëlhurë filtruese plastike (Gjeotekstil). Gjeotekstili do të jetë i përbërë nga polipropileni ose poliestra pa përdorimin e ngjitësve. Do të kryhet në përputhje me njërën si më poshtë vijon:
- me fibra të vazhdueshme,
- me fibra të ndërthurura ("përkulura e ndërthurura" me sistem thurjeje industriale),
- me fibra të duhura të ndërthurura me gjatësinë e arritur nga gjilpërat mekanike.

Te jepen detajet, me një çertifikatë e cila përcakton emrin e prodhuesit, emrin e produktit, numrin e stilit, përbërjen kimike të filamentit ose thurjeve dhe ndonjë informacion të duhur, dhe shembujt e materialit të propozuar për rishikim dhe miratim.
Gjeotekstilet e etiketuar, transportimi dhe magazinimi duhet të jenë sipas ASTM D 4873. Emërtimet e produkteve duhet të tregojnë qartësisht prodhuesin ose emrin e furnizuesit, emërtimin e stilit dhe numrin e rolese. Çdo dokument transportues duhet të përfshijë një informacion i cili certifikon se materiali është në përputhje me çertifikatën e prodhuesit.
Çdo role' gjeotekstili duhet të mbështillet me një material i cili do të mbrojë gjeotekstilin nga dëmtimet e mundshme gjatë transportit, uji, drita e diellit dhe ndotësve. Mbështjellja mbrojtëse duhet të ruhet gjatë periudhës së transportit dhe magazinimit. Gjatë magazinimit, rolete e gjeotekstileve duhet të ngrihen nga toka dhe të mbulohen siç duhet për ti ruajtur ato nga dëmtimi i karakteristikave fizike të vetive te gjeotekstilit.

9.3 PJESA 3 - EKZEKUTIMI

9.3.1 IZOLIMI

9.3.1.1 Verifikimi i Kushteve

Para instalimit të izolimit, të siguroheni se zonat të cilat do të jenë në kontakt me izolimin të jenë të thata dhe pa dalje të cilat mund të shkaktojnë hapësira, shtypje izolimi, apo shpime. Nëse ndodh izolimi poshtë soletave ose në perimetër, te kontrollohet që mbushja të jetë e sheshtë, e thatë dhe e ngjeshur mirë. Nëse krijohet lagështi ose kushte të tjera, të cilat nuk lejojnë instalimin e duhur të izolimit, të mos vazhdohet por të lajmërohet Mbikëqyrësi për kushtet e tilla.

9.3.1.2 Instalimi i Paneleve të Izolimit

Të instalohet dhe përdoret izolimi në përputhje me udhëzimet e instalimit të prodhuesit. Të ruhet materiali i thatë dhe pa materiale të huaja. Të ruhen praktikat e sigurta të punës.

9.3.1.3 Instalimi ne Murature

Të aplikohet shtresa përmbi murature me ngjitëse ose lidhëse siç rekomandohet nga prodhuesi i izolimit. Të vendosen pengesat pa ngulur shtresat në lidhëse ose ankorime. Të aplikohen në shtresa paralele fugat e shkeputjes në gjysmë të shtresave si më poshtë. Të vendosen fundet në kontakt të mjaftueshëm me izolimin ngjitur pa e sforcuarr. Të priten dhe formatohen në bazë të kërkesës për ti vendosur rreth daljeve të mureve, projektimeve ose hapjeve për të akomoduar shërbime të ndryshme. Të ngjiten prerjet me ngjitëse. Të instalohen shtresat në zgavrat e mureve në mënyrë që të lejojë një hapesire nominale ajrosjeje prej 25mm jashtë izolimit për të lejuar drenazhim te zones.

9.3.1.4 Instalimi nën soletat e Betonit

Të matet izolimi për të mbuluar sipërfaqen e soletës. Të aplikohet ngjitësi në soletë dhe të vendosen lidhesit tek ngjitësi sipas rekomandimeve të prodhuesit. Pas trajtimit të ngjitësit, të instalohet izolimi mbi lidhes, të shtrembërohen derisa të sheshohen me izolimin kapëset prej çeliku, te gjithe anët e izolimit dhe të mbyllet shiriti.

9.3.1.5 Ruajtja e Izolimit

Të ruhet izolimi nga demtimet mbi sipërfaqet vertikale gjatë ndërtimit dhe mbushja duke përdorur polistiren me trashesi prej 5cm. Të mos lejohet izolimi vertikal i pambrojtur gjatë natës. Të instalohet mbrojtes gjatë të gjithë periudhës së ekspozimit te paneleve izoluese.

9.3.2 HIDROIZOLIMI

9.3.2.1 Verifikimi i Kushteve

Të siguroheni që kushtet e mëposhtme ekzistojnë para aplikimit të materialeve të membranës:
Kullimet, pjerresite, thellimet dhe pajisjet mbështetëse janë te pozicionuara.
Sipërfaqet janë të ngurta, të thata, të sheshta dhe pa çarje, brima, dhe ndryshime të forta në lartësi.
Nënshtresa është e perresuar siç tregohet për të mundësuar kullim efektiv.
Nënshtresat e fabrikuar në vend janë lejuar të kurohen dhe thatësia e sipërfaqes me kërkesat e specifikuara të jenë përmbushur. Kurimi i nënshtresave duhet të jenë në përputhje me sistemin e membranave.
Të gjitha këndet do të rrumbullakosen duke përdorur material izolues ose llaç për të parandaluar palosjen e materialit.

9.3.2.2 Prajmer i Sipërfaqeve Me Beton

Pasi të jenë përmbushur kërkesat për thatësi, sipërfaqet e betonit të cilat do të mbulohen me fletën e membranës në mënyrë uniforme të lyhen me një shtresë prajmer bitumeni. Kjo shtresë duhet të aplikohet në gamën 130gr/m^2 dhe të kenë një minimum trashësie prej 3mm (në të thatë). Të lejohet kjo shtresë të thahet para se të aplikohet fleta e membranës.

9.3.2.3 Aplikimi

Të aplikohet membrane në bazë të specifikimeve të botuara të prodhuesit. Të ruhen materialet të thata para dhe gjatë aplikimit. Të mos lejohet ndërtimi me faza. Aplikimi i plotë i membranës në një veprim të vazhdueshëm. Të ruhen temperaturat e specifikuara për bitumen.

9.3.2.3.1 Fletët e Bitumenit Prej Polimeri Të Modifikuar

Këto fletë duhet të jenë të izoluara dhe pa vrima të vogla, grimcat e materialeve të huaja të pandara, ose të defekteve të tjera të prodhimit të cilat mund të prekin mundësinë e shërbimit. Cepat e bashkimit duhet të jenë të drejta dhe të sheshta në mënyrë që ato të lidhen me njëra tjetrën pa formuar ngrehina ose rrudha.

9.3.2.3.2 Fletët e Modifikuara të Polimerit të Bitumenit

Te aplikohet ne menyre te plote nxehtësia elektrike ose me pishtar të nxehtë tek fletët e ngjitura. Të shpalosen fletët, vendosen në vend me anime anësore prej 250mm dhe fundore 250mm. Apliko nxehtësinë nga poshtë topit dhe 100mm tek ana e topit të mëparshëm dhe të ngjitet plotësisht membrana tek nënshtresa duke ç'rrotulluar pjesën e nxehur të topit në nënshtresë. Të sigurohet një minimum rrjedhjeje të bitumenit të modifikuar prej të paktën 10mm, për të mos kaluar 25mm, tek anët dhe fundet ndërsa membrana rrotullohet përpara dhe ngjitet me nënshtresën. Kujdes duhet kushtuar në mënyrë që të mos tejnxehet sipërfaqja e sipërme e topit. Pasi membrane të jetë ngjitur me nënshtresën, të kontrollohen anët me një mistri të nxehtë për të siguruar që anët të jenë plotësisht të ngjitura. Në zonën kur ngjitja e plotë e anëve të mos arrihet, të rinxehet dhe të vendoset me mistri në vend në mënyrë që ngjitja totale të arrihet.

Nëse elementët e parafabrikuar duhet të puthiten me sipërfaqen e izoluar ndaj ujit (si për shembull dritaret e bodrumeve) izolimi ndaj ujit duhet të zgjatet të paktën brenda anës së njësisë para instalimit.

9.3.2.3.3 Pastrimi

Të hiqen mbetjet, copëzat dhe ndonjë mbeturinë tjetër i cili del si rezultat i instalimit të sistemit të mbulimit nga kantieri çdo ditë.

9.3.2.3.4 Ruajtja e Membranës së Aplikuar ndaj Lagështisë

Në fund të ditës së punës dhe kur priten reshje, të ruhet sistemi i membranës së bitumenit të aplikuar. Të aplikohet ruajtja e membanës nga drita e diellit të fortë dhe të drejt për drejtë.

9.3.2.4 Kontrolli i Cilësisë në Terren

Të kryhen teste në terren.

9.3.2.4.1 Testi për Thatësirën e Sipërfaqes

Para se të aplikohen fletët e membranës dhe të fillohet puna në zonën që do të mbulohet me çati/ tarracë. Thatësira duhet të jetë më e madhe se 0.03%.

9.3.3 FUGAT

Fugat e ekspansionit duhet të kenë dimensione dhe hapësirën e treguar, dhe të mbushen me ngjitës e bashkues të parambushur. Të mbahet mbushësi në vend në mënyrë të sigurt gjatë vendosjes dhe përfundimit të betonit. Të përdoren mbështetëset metalike për të mbështetur mbushësin dhe për të ruajtur materialin nga dëmtim gjatë veprimeve me betonin. Një mur ndarës kur ai përdoret, duhet të ketë fuqinë e mjaftueshme për të qëndruar drejt nga njëra anë tek tjetra e copës së betonit kur ai vendoset mbi të. Të lidhen këto mure në vend në mënyrë të sigurt me kënde të drejta për akset në gjatësi dhe transversale dhe sipërfaqet e betonit. Të vendosen kunjat metalike për të mbajtur mbushësin plotësisht në pozicion. Të depozitohet betoni dhe ngjeshet para se muri të hiqet. Të mos hiqen kunjat deri sa betoni të ketë përfunduar. Në asnjë rrethanë nuk duhet lënë betoni mbi materialin zgjerues ose bashkime të përtejshme në ndonjë pikë. Të pritet betoni me kujdes i cili kapercen anet e fugave pranë kallepeve pas heqjes se kallepeve.

Të vendosen seksionet e materialit ngjitës ngushtësisht së bashku për të parandaluar që betoni të futet në hapësirën e bashkimeve.

9.3.4 Puna në të Nxehtë

Ruajtja e cilindrave prej gazi në depo nëntokësore, në shkallë, korridore dhe hapësirat e shpëtimit është e ndaluar. Gjatë punës me materialet prej gazi të nxehta pajisjet e mbrojtjes ndaj zjarrit të mbajtura në dorë në përputhje DIN EN 3 duhet të jenë të gjindshme në mënyrë të menjëhershme ngjitur me zonën e punës.

9.3.5 Gjeotekstil për Strukturat

9.3.5.1 Pëlhura me Filtër Plastik (Gjeotekstil)

Pëlhura me filtër plastik do të vendoset në ose kundrejt një sipërfaqeje të përgatitur me kujdes, pa ngrehina, mbetje ose të dala të cilat mund të dëmtojnë pëlhurën. Pëlhura duhet të vendoset lehtazi dhe jo

të përhapet me palosje ose ngrehina. Materiali i dëmtuar do të riparohet ose zëvendësuar nga një copë gjeotekstil i cili është mjaftueshëm i madh për të mbuluar zonën e dëmtuar dhe për të përmbushur kërkesat për tejkalim. Pëlhura duhet të mbivendoset nga një minimum prej 450mm tek të gjitha bashkimet, palosjet dhe ngjitjet.
Materiali i përçueshëm duhet të vendoset në shtresa horizontale dhe tërësisht të konsoliduar.
Pëlhura me filtër plastik mund të jetë një pëlhurë jo e thurur e cila përbëhet nga të paktën 95% filamente polimerike të pëlhurës jo të thurur si me polipropilene, polietilen, poliestër, poliamide ose polivinil dine kloridi të formuar në një rrjet stabël në mënyrë që filamentet ose thurjet të ruajnë pozicionin relativ ndaj njëri tjetrit, duke përfshirë tegelat. Plastika bazë duhet të përmbajë stabilizues dhe/ose parandalues për ti bërë filamentet rezistente për përkeqësimin nga drita ultra-vjollcë (për kushtet e ekspozuara) nxehtësia, dhe kimikate mundësisht të dëmtueshme në mjedisin përreth.

Pesha e pëlhurave do të klasifikohet jo më pak se 140g/m^2 (0.46 ons për këmbë katrore) dhe të kenë një trashësi minimale prej 0,5mm (1/50"). Klasa e pëlhurës do të jetë 1 me material të ngjeshur rimbushës në më shumë se dendësi të thatë prej 95% MDD (AASHTO T 99). Për kushte më pak të vështira ose kushte të vështira instalimi, mund te përdoret Gjeotekstil i klasit 2. Të paraqiten kushtet e instalimit për pëlhurë para se të prodhohet Gjeotekstil.

Pëlhura duhet të rezistojë presion prej 70,5kN/m^2 (10.,PSI) dhe stres elastik të shkaktuar nga ky presion me një maksimum prej 25mm bashkimi betoni të parafabrikuar dhe njësi të zhytura. Koeficienti i tejçueshmërisë për filtrimin transversal duhet të jetë10-3 dhe 10-1 cm/sek (të matet në kushte të njëjta me ato në kantier). Fuqia elastike e matur në rripat e gjerë prej 5cm nuk do të jetë më pak se 600 N/5cm, me 10-85% zgjatim nëçarje. Në rastin e pëlhurës së transheve gjithashtu duhet të jetë në gjendje të mbështesë shtresat e sipërme të rrugëkalimit, me një fuqi elastike jo më pak se 1,200 N/5cm ose 1,500 N/5cm.
Karakteristikat e kërkuara te Gjeotekstil-it (pëlhura) listuar si më poshtë:

9.3.5.2 Mbështjellja

Kërkesat Gjeotekstile	Klasi Gjeotekstil			
	Klasi 1		Klasi 2	
	Zgjatimi <50%	Zgjatimi >50%	Zgjatimi <50%	Zgjatimi >50%
Fuqia Kapëse (min)	1,400N	900N	1100N	700N
Fuqia e tegelit të qepur (min)	1,260N	810N	990N	630N
Fuqia e grisjes(min)	500N	350N	400N	250N
Fuqia e shpimit (min)	500N	350N	400N	250N
Tejçueshmëria (maks)	0,5/sek			
Madhësia e dukshme e hapjes (maks)	0.160 mm			
Qëndrueshmëria ultra vjollce (Fuqia e Ruajtur) (maks	50% pas 500 orë ekspozimi			

9.3.5.3 Përforcimi

	Zgjatimi <50%	Zgjatimi >50%		
Fuqia Kapëse(min)	300kN/m	160kN/m		
Fuqia e tegelit të qepur (min)	220kN	140kN		

Fuqia e grisjes(min)	40kN	25kN		
Fuqia e shpimit (min)	10kN	5kN		
Tejcueshmëria (maks)	0,25/sek			
Madhësia e dukshme e hapjes (maks)	0.250 mm			
Qëndrueshmëria ultra vjollce (Fuqia e Ruajtur) (maks	50% pas 500 orë ekspozim			

Gjeotekstilet duhet të jenë subjekt të marrjes shembull dhe testimit për të verifikuar përputhjen me këtë specifikim.

9.3.6 Drenazhimi

9.3.6.1 Gërmimi i tokës për kanalin e kullimit

Pas gërmimit është e nevojshme të verifikohet nëse ka tuba infrastrukture dhe riparimi i tyre nëse është e nevojshme.
Gjatë procesit, përgjatë perimetrit të ndërtesës në shesh ndërtmimi, do të vendoset tub plastik Ø 200 mm, i mbuluar me shtresë gjeotekstile.
Kanali i kullimit do të jetë i mbushur me zhavorr dhe materiale të tjera specifike, të cilat janë të nevojshme për të përfunduar punimet në kantier.

9.3.6.2 Membrana e papërshkueshme

Në bitumin polimer elasto-plasto-merik, me një shtresë të fibrave të qelqit ose përforcimit të fletëve të poliestrës, me peshë minimale 3kg/m^2. Materiali duhet të çertifikohet si kompatibël me materialin izolues për të parandaluar humbjen e plastifikatorit. Karakteristikat:
- zgjatje në thyerjen e përbërësit të paarmuar (NFT46002) 2000%,
- rezistenca ndaj tërheqjes gjatësore 90 transversale 80 Kg / 5cm,
- zgjatje në thyerje gjatësore 50% transversale 50%
- rezistenca ndaj lodhjes në plasjen aktive në 0°C për 10.000 cikle - në -10°C pë 1.000 cikle,
- fleksibilitet i të ftohtit - 25 ° C.

Membranë me rezistencë ndaj lagështirë për themelet, me trashësi 4mm, me bitum elastomerik të polimerit të aplikuar në shtresën e betonit bituminoz.

9.3.6.3 Pëlhurë Plastike me Filtër (gjeotekstil) në mur në bodrum vertikal

Gjeotekstili duhet të vendoset në ose kundrejt një shtrati ose sipërfaqeje të përgatitur me kujdes, pa kokrriza, mbetje apo teprica që mund të dëmtojnë strukturën. Pëlhura duhet të shtrihet lirshëm, jo e shtrirë me ndonjë rrudhë ose palosje. Materiali i dëmtuar duhet të riparohet ose të zëvendësohet me një copë gjeotekstili që është i madh mjaftueshëm për të mbuluar zonën e dëmtuar dhe për të përmbushur kërkesat e mbivendosjes. Gjeotekstili duhet të mbivendoset me një minimum prej 450mm (18 ") në të gjitha nyjet, shtresat dhe skajet.

Materiali i depërtueshëm duhet të vendoset në shtresa vertikale dhe të konsolidohet tërësisht.

10. RIFINITURA E MURATURES

10.1 PJESA 1 –E PËRGJITHSHME

10.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi deri në masën e marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm nga përcaktimi i tyre bazë.

10.1.1.1 Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare

10.1.1.2 Standardet dhe Normat Evropiane

DIN 18550-3	Suvatimi - Izolimi termik i sistemeve të suvatimit të kryera prej llaci me ngjitës mineral dhe duke përdorur polistiren (EPS).
DIN V 18559	Sistemet e përbëra për izolimin termik; konceptet, përshkrimi i përgjithshëm
DIN 4102	Sjellja ndaj zjarrit e materialeve dhe elementëve të ndërtimit – Klasifikimi i materialeve të ndërtimit – Kërkesat dhe testimi
EN 12667	Performancë termike e materialeve dhe produkteve të ndërtimit – përcaktimi i rezistencës termike duke përdorur një pllakë të nxehtë dhe metodat me rrjedhje të nxehtësisë – produktet e rezistencës termike të lartë dhe të mesme

10.1.2 PARAQITJET

Paraqit si më poshtë:
Shembujt
Suvatimit: të paraqiten 4 panele me përmbajtje të ndryshme prej 900mm për miratimin e Mbikëqyrësit. Pas përzgjedhjes së një teksture të pranueshëm, te ndërtoheti një shembull. Shembulli duhet të paraqesë murin dhe të gjitha aspektet e punës me fino, duke përfshirë por jo të kufizuara tek fugat e ekspansionit, fugat e kontrollit, dhe zgjatimet e kendore. Te ruhet nga demtimet kampioni i murit kryer si shembull.
Veshja me gurë natyror
Udhëzimet e Prodhuesit
Paraqit udhëzimet e printuara të përziera të prodhuesit për finon për përzierje të gatshme dhe përfundimin e finos akustike.

10.1.3 SHPERNDARJA , RUATJA DHE TRAJTIMI

Materialet e prodhuara te dergohen në paketimin origjinal të prodhuesit të cilat janë të etiketuar në mënyrë të qartë me emrat dhe markën nga prodhuesi. Të ruhen materialet e llacit dhe çimentos të thata dhe larg sipërfaqes së tokës, të mbuluara dhe larg mureve që kullojne dhe sipërfaqeve të tjera të lagështa deri sa të jetë gati për përdorim.

10.1.4 KUSHTET MJEDISORE

10.1.4.1 Stukim me Allçi

Të ruhet një temperaturë ambienti prej jo më pak se 10 gradë C kur përdoret llac e fino në mënyrë të vazhdueshme dhe lejohet tharja.

10.1.4.2 Fino prej Çimentoje dhe Stuko

Të ruhet një temperaturë ambienti prej jo më pak se 5 gradë C në mënyrë të vazhdueshme ku fino e çimentos dhe punimet me stuko do të lejohen.

10.1.4.2.1 Ruajtja nga Dielli dhe Erërat e Thata

Gjatë aplikimit të dorës së fundit, dhe për një periudhë prej 48 orësh pas përfundimit të dorës përfundimtare për çdo zonë, të ruhet sipërfaqja e stukos dhe finos nga dielli dhe erërat e drejt për drejta. Përdorimi i mbulesave dhe materialeve të tjera të përkohshme është i pranueshem.

10.2 PJESA 2 – PRODUKTET DHE MATERIALET

MATERIALET

10.2.1 PARETE NDARES GIPSI

Furnizimi dhe instalimi i ndarjeve me gips me katër flete (dy për anë), me trashësi totale 150/200 mm (në bazë të skicave) të përbëra nga një strukturë metalike në profile çeliku të galvanizuar (6/10 në trashësi perimetrave "U" me guidën kryesore me trashësi 50/75/100mm dhe vertikalisht "C" me ndarjet në distancë të barabartë prej 60cm), mbi të cilat shtresat e gipsit vidhosen; çdo shtrese nuk do të jetë më pak se 12,5mm e trashë.

Instalimi në strukturat metalike
Rendi i aplikimit te operacioneve te mëposhtme:
Të vendosen ndarjet dhe të shënohen në dysheme dhe tavan me një vijë shkumësi dhe nivelues magnetik të aplikohet materiali jo elastik izolues dhe mbylljet në profilin metalike (si në formë "U" dhe "C") duke i ngulitur ato me vida, kapëse dhe gozhda;
Të kontrollohet pozicioni dhe drejtimi; nëse aplikimi i udhëzuesit të dyshemesë është në kuzhinë /banjë, vendosni një shtresë bitumeni ose fletë polietilene nën profilin metalik, me kllapa vertikale deri në 2cm për mbrojtjen totale të profileve dhe shtresave dhe depërtimi i ujit;
Vendosni profilet "C" (me një gjatësi prej rreth 1cm sesa më pak sesa distanca ndërmjet bazës dhe udhëzuesit "U"), të gjithë të orientuara në një drejtim, duke vendosur fillimisht ato të cilat janë ngjitur me dyert ose të vendosura tek ndërthurjet e mureve të tjera, që i lidhin ato me shinat duke përdorur vida në distancat e vendosura;
Të vendosen shtresat (me të njëjtën lartësi sa dhoma në të cilën janë minus 1cm nga toka) nëmënyrë që të gjendet lidhja me shtresat ngjitur përgjatë kolonave metalike; bashkimet përgjatë njërës anë të murit ndarës duhet të jenë të shkallëzuara në respekt me anën tjetër, për sa i përket ndarjeve me dy shtresa në shtresën e parë duhet të jenë të ndërthurura përkundrejt të parës; bashkimet horizontale duhet të jenë të shkallëzuara nga të dyja anët;
Shtresat e gipsit duhet të vendosen me vida në një distancë jo më pak se 1cm nga cepat e gjatësisë dhe 1,cm nga cepat/anët transversale/përkundrejt; Distanca ndërmjet vidave duhet të jetë rreth 30cm me një shtresë nga secila anë e kornizës; për ndarjet me dy shtresa, shtresa e parë e brendshme do të vendoset me vida në përreth 80 cm distancë te barazlarguar, kurse shtresa e dytë e jashtme do të vendoset me vida në përreth 25cm distancë te barazlarguar;
Te vendoset material izolues mes paneleve (pambuk mineral);
Bashkimi i finos dhe llaçit përgjatë fundeve të shtresave dhe bashkimeve; një shirit përforcues duhet të aplikohet përgjatë të gjithë gjatësisë së bashkimit në finon akoma të freskët, dhe një shtresë tjetër fino duhet të vendoset për të mbuluar shiritin dhe të gjitha gozhdët ose kokat e vidave;

Pas tharjes totale bashkimi duhet të mbulohet me shtresën përfundimtare, me të paktën 5cm tejkalim në secilën anë; më pas një shtresë e dytë duhet të vendoset për të mbuluar shtresën e parë më një gjerësi më të madhe prej përreth 30cm;
Pas tharjes së shtresës së fundit, sipërfaqja duhet të trajtohet më gërryes.

Aksesorët e instalimit
Në bazë të llojeve të ndryshme të bashkimeve, vida të ndryshme duhet të aplikohen:
"C" strukturë + profil – kapëset e vidave (upat),
Shtresë + kapëse metalike – vida fosfati me koka shpimi të kryera dhe majë të filetuar, të gjatësive të ndryshme,
shtresë+shtresë – vidat me koka tëkundërfiletuar dhe maje vendosëse si dhe me kokë heliktike,
aksesorët metalikë – vidat vetë fletuese me kokë të rrumbullakët.
Ruajtja e anëve të brendshme dhe kendeve
Të gjithe kendet dhe anët e brendshme duhet të përforcohen dhe ruhen me shirit përforcues ose me kënde metalike përgjatë gjithë gjatësisë së tyre.

Fugat
Aty ku ndarjet me mure gipsi bashkohen me muret e ndërtuar me tulla ose me elementë të tjerë, ose për ndarje me dimensione të mëdha/ndarje me mure gipsi jo të vazhdueshëm (> 15m2, prezenca e hapjeve të dyerve dhe të dritareve) bashkimet e ndarjeve duhet të realizohen, 1/1,5 cm të gjera, përgjatë të gjithë gjatësisë e trashësisë së ndarjes. Fundi i bashkimit duhet të jetë i mbyllur mirë në thellësi (i padukshëm) me një material të përshtatshëm elastik.
Ekzekutimi i fugave mund të nënkuptojë:
Pudër allçie e cila ngjitet shpejt, thahet shpejt,
Mbushës baze gati për tu përdorur.
Sistemet e ankorimit të duhur duhet të përfshihen për mbajtjen e orendive të banjës.

Izolimi akustik
Performancat e materialeve të parandalimit të ndotjes akustike duhet të garantohen për çdo lloj ndarjeje në përputhje me treguesit ekzekutiv. Vlerat e përcaktuara nga eksperimente duhet të jenë më të larta se sa ato të përshkruara me tolerancat e mëposhtme: shuma e nivelit të ndryshimeve ndërmjet vlerave të kërkuara dhe atyre të matura nuk duhet të kalojë 12dB dhe gjithashtu shmangia maksimale për secilën frekuencë nuk duhet të jetë më e lartë se sa 5dB

Performanca e hidroizolimit
Për hapësirat e lagura/njoma shtresa e izoluesit të brendshëm duhet të aplikohet, certifikuar në bazë të kushteve të caktuara. Variacionet e lagështisë brenda hapësirave ku shtresat e izolimit nuk janë të instaluara nuk duhet ti krijojë atyre shtresave ndryshime dimensionale, ose degradimin e materialit.

Rezistenca ndaj tronditjeve
Muret duhet të jenë në gjendje të rezistojnë 3 goditje trupore të buta me një impakt energjetik prek 250J (përreth 25kgm) dhe mpakte të forta trupore me një impakt energjetik prej 10J, duke ruajtur pas këtyre integritetin strukturor, duke parandaluar kalimin e trupit pertej shtresës, të mos kalojë nëpërmjet skeletit, duke mos mundësuar copëza të cilat shkëputen dhe mund të shkaktojnë plagosje aksidentale apo dëmtime tek njerëzit. Procedurat e testimeve duhet të jenë në përputhje me standardet ICITE-UEATC.

Rezistenca ndaj pajisjeve që varen ose fiksohen

Vetë muri dhe pajisjet lidhëse duhet të jenë në gjendje të rezistojnë, pa deformime ndryshimeve permanente dhe pa dëmtime të dukshme, një ngarkese prej 100kg të aplikuar paralel me sipërfaqen e murit, në një distancë prej 30cm nga ai dhe i shpërndarë në një gjatësi prej 50cm në drejtimin e gjatësisë. Pajisja testuese dhe ngjitëse duhet të furnizohet nga prodhuesi.

Rezistenca ndaj ngrohtësisë rrezatuese
Muri i gipsit duhet të përballojë pa ndryshime të dukshme dhe deformime permanente, shkeputje, ndryshime në formë dhe dukje, apo thyerje nxehtësie të shkaktuara nga rrezatimi i një llambe 250W.

10.2.1.1 Panele standarte gipsi

Shtresat e gipsit standard (DIN 18180 GKB klasifikimi) për përdorim të brendshëm duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:
Klasa e reagimit ndaj Zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,
Faktori i rezistencës ndaj lagështisë μ: 10 (thatë), 4 (njomë),
Përçueshmëria termike λ: 0,20 W/mK,
Dendësia ≥ 680 kg/m3
Pesha e fletes se gipsit: ≥ 8,5 kg/m2 për 12,5mm trashësi, ≥ 13,3 kg/m2 për 15mm trashësi,
Ngarkesa ne perkulje: ≥ 550 N në gjatësi dhe ≥ 210 N transversale për 12,5mm trashësi, ≥ 650 N në gjatësi dhe ≥ 250 N transversale për 15mm trashësi.

Performancë e lartë për fletet e gipsit te para përfunduara (DIN 18180 GKFI klasifikim), 12,5mm trashësi, për përdorim të brendshëm duhet të kenë karakteristikat si më poshtë:
Klasa e reagimit ndaj Zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,
Rezistenca ndaj lagështisë μ: 10 (thate), 4 (njomë),
Përcjellshmëria termike λ: 0,25 W/mK,
Dendësia: ≥ 1000 kg/m3
Pesha e shtresës: përafërsisht 12,8 kg/m2,
Ngarkesa në përkulje: ≥ 725 N në gjatësi dhe ≥ 300 N transversale,
Forca e sipërfaqes: ≤ 15 mm Ø,
Kapaciteti thithës i ujit: ≤ 10%

10.2.1.2 Pllakat e gipsit REI

Shtresat e gipsit rezistente ndaj zjarrit (klasifikimi DIN 18180 GKF) për përdorim të brendshëm, me fiber mineral dhe përforcues të shtuar per një lidhje më të mirë atomike, duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:
Klasa e reagimit ndaj zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,
Faktori i rezistencës së avujve të ujit μ: 10 (thatë), 4 (njomë),
Tejçueshmëria termike λ: 0,20 W/mK,
Dendësia: ≥ 820 kg/m3
Pesha e shtresës: ≥ 10,5 kg/m2 për 12,5mm trashësi, ≥ 13,5 kg/m2 për 15mm trashësi,
Ngarkesa ne perkulje: ≥ 550N në gjatësi dhe ≥ 210N transversale për 12,5mm trashësi, ≥ 650N në gjatësi dhe ≥ 250N transversale për 15mm trashësi

10.2.1.3 Pllake gipsi kundra lageshtires

Panele gipsi kundra lageshtires (klasifikimi DIN 18180 GKI) për përdorim të brendshëm me trashësi 12,5 mm, me përbërje $CaSO_4x2H_2O$ me absorbimin specifik ndaj lageshtires duhet të ketë parametrat e mëposhtme:
Reagimin ndaj zjarrit, klasa EN 13501-1: A2-s1, d0,
Rezistence ndaj faktorëve të avullit të ujit μ: 10 (thatë), 4 (njomë),
Përçim termik λ: 0,20 W/mK,
Densiteti: ≥ 760 kg/m
Pesha e pllakës ≥ 9,5 kg/m2,
Pesha e përkuljes ≥ 550 N për së gjati dhe ≥ 210 N transversale
Absorbimi i ujit pas dy orë zhytje totale të jetë jo më shumë se< 10%e peshës së pllakës.

10.2.1.4 Pllakë çimento e jashtme Akuapanel

Aquapanel Exterior është një pllakë e ashpër çimentoje, për përdorim të jashtëm. Ajo është e përbërë prej çimentos Portland dhe një rrjetë të përbërë prej fibre qelqi, të mbështjella në sipërfaqet e pasme dhe të përparme, me trajtim të veçantë të reduktimit të absorbimit të ujit. Fundet janë me seksion katror dhe skajet janë të përforcuara dhe rifinuara pa probleme.

10.2.2 VESHJE GIPSI DOPIO PANEL

Paisjet dhe instalimet e veshjes së murit me pllake gipsi dopiopanel trashësia totale nga 125/250 mm (sipas vizatimeve) e përbërë nga një strukturë metali të galvanizuar të profileve të çelikut me trashësi(6/10 në perimetër, udhëzuesi në formë "U" 50/70/100 mm trashësi dhe profilet vertikal "C" 60 cm distancë te dyaneshme), në të cilën vidhosen pllakat e gipsit; çdo pllakë/tabele do të jetë jo me pak se 12.5 mm.

Montimi në strukturën metalike
Te ndiqet renditja sipas veprimeve per aplikim:
Pjesët duhet të vendosen në një vend të rrafshët dhe të izolohen me veshje termike dhe nivelin magnetik dhe apliko izolimin me materiale izoluese jo plastike në profilet metalike të perimetrit (në të dyja si në Profilet "U" dhe ato "C" duke i bashkuar ato me mentesha, vida, gozhdë;
Kontrolloni pozicionin e shtrirjes me ane të një spangoje; nëse sipërfaqja ku po montoni është e ashpër si pllaka/banje/kuzhine vendosni një shtresë bitumi ose polietileni nën profilet metalike me një lartësi vertikale 2 cm për mbrojtjen eplotëtë profileve dhe pllakës së gipsit nga depërtimi i ujit
Vendos profilet "C" (me një gjatësi rreth 1cm midis udhëzuesitnë formë "U") tëgjithatë orientohen nëtë njëjtin drejtim, fillimisht vendosni ato qëpozicionohennë kornizat e dyerve ose ato që do të vendosen midis dy mureve, bashkoni ato në shina në distancën e paracaktuar;
Vendos pllakat (në të njëjtën lartësi me dhomën 1cm mbi dysheme) me qëllim vendosjen dhe përputhjen midis pllakave të ngjitura përgjatë distancuesit metalik në forme kryqi (kryq metalik që vendoset midis dy shtresave të xhamit, gipsit përtë ofruar një distancëtë caktuar midis dy sipërfaqeve), bashkimi duhet tërenditët në respekt edhe të krahut tjetër, si një pllakat dopioshtrëngimet/saldimet duhet të bëhen njësoj në të dy pllakat; bashkimet/saldimet horizontale duhet të renditen në të dy krahët.
Pllakat duhet të shtrëngohen me vida jo me pak se 1 cm nga kulmet gjatësore dhe 1.5cm nga kulmet transversale, distanca midis vidave do të jetë 30 cm në çdo pllakë në të dy krahët e kornizës, për ndarëset dopio të pllakave, pllaka e parë (e brendshme) do të vidhoset me vida 80cm në distance të përbashkët nga njëra tjetra dhe pllaka e jashtme do të vidhoset në distancën 25cm; Vendosni materialin izolues (pambuk mineral/xhami) duke suvatuar me fino te skajet dhe bordurat e kornizave izolantngjitës duhet të vendoset mbi finon e freskëtnë shtresën e dyte fine, (patinimi) duhet ti vendoset përtë mbuluar ngjitësin dhe vidat:

pas tharjes së plotëtë suvatimit një shtresëpërfundimtare patinimi duhet tëpërdoret si shtresëpërfundimtare me tëpaktën 5cm që rrjedh nëtë dy krahët, më pas një shtresëtjetërdytësore duhet të aplikohet shtesëpërtë mbuluar shtresën e parë me gjerësi rreth 30 cm, pas tharjes e gjithësipërfaqja duhet tërrëshinohet me përdaf grafiti.

Aksesoret e instalimit
Në përputhje me llojet e ndryshme të ngjitjes, vida të ndryshme duhen përdorur: strukturë profilesh "C" kunja ose vida zgjatuese, distancues metalik të pllakave me vida fosfati me kokë kundra oksidimit dhe majë të trefishtë, të gjatësive të ndryshme bashkimi, pllake me anëtë vidave me kokë kundra ndryshkut me majë treshe dhe të drejtuara në forme spirale.
Aksesorët metalik, vide, kokë rrumbullake, vetmbushëse.

Mbrojtja e kulmeve dhe cepave të brendshëm.
Të gjithë kulmet dhe cepat e brendshëm duhet të përforcohen dhe mbrohen me shirit mbrojtës ose profile këndore, mbrojtës në cepat e shtresave dhe përgjatë aneve.

Fugat
Kur paretet e gipsit takohen me muratura dhe elemente të tjerë të ngjashëm ose ne rast përmasash të mëdha, me ndërprerje të pareteve te gipsit (>15 m2, prezenca e dyerve dhe dritareve që duhen hapur) fugat duhet të realizohen nga, 1/1,5 cm të gjera, përgjatë gjithë gjatësisë dhe trashësisë së paretit. Fundi i fugave duhet të puthitet ne thellesi në mënyrë qëtë mos jetë e dukshme me një material të përshtatshëm elastik.
Zbatimi i fugave mund të nënkuptojë:
Vendosjen e shpejtë të pluhurit te allcise/stuko, lehtesisht i thashem.
Sisteme të përshtatshme ankorimi duhet të përfshihen për fiksimin e paisjeve te banjos.

Reagimi ndaj ujit.
Për lagështinë dhe sipërfaqet e lagështa veshja kundra ujit duhet të përdoret dhe të jetë e certifikuar sipas kushteve tëcaktuara. Ndryshimi i lagështisë në hapësirat ku do të vendoset panelet e veshjes kundra lageshtires nuk duhet të ndikojë në degradimin e materialit dhe të vete veshjes.

Rezistenca ndaj tronditjeve
Muri duhet ti rezistojë goditjeve të një serie treshe të një trupi me fuqi 250 J me një energji përplasjerreth (250 kilogram për metër) dhe të një trupi të fortë 10 J, energji përplasje, duke ruajtur formën e strukturës duke mos lejuar kalimin e trupit pertej veshjes dhe duke mos shkaktuar dëmtime dhe rrëzime copëzash që mund të shkaktojnë dëmtime aksidentale të ndonjë njeriu. Procedurat e testimit duhet të jenë konform standardeve të ICITE-UEATC.

Rezistencë ndaj fiksimit dhe varjes se pajisjeve
Pajisjet qe duhet te varen dhe muri në vetvete duhet të jetë i aftëtë ti rezistoje deformimeve dhe ndryshimeve te vazhdueshme, si dhe te mos kete demtime te dukshme, per nje ngarkese 100 kg e cila vendoset në një paralel në një distance prej 30 cm nga platforma dhe e shpërndarë në një sipërfaqe me drejtim lateral prej 50 cm. Pajisja testuese duhet të ofrohet nga fabrika që ofron materialet.

Rezistenca ndaj rrezatimit të ngrohjes.
Pllaka e gipsit duhet të jetë e qëndrueshme pa alterime dhe deformime të dukshme dhe të përhershme apo dëmtime të pjesshme ne forme, pamje, si dhe plasaritje të shkaktuara nga energjia e rezatimit te një llambe 250 Ë.

Veshje gipsi dopio panel
Pllakat standarde te gipsit, dopio panel (klasifikimi DIN 18180 GKB) për përdorim të brendshëm (në Godinë) duhet të kenë parametrat e mëposhtëm:
Klasa e reagimit ndaj zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,
Rezistence ndaj faktorit avullues μ: 10 (thatë), 4 (lagështi),
Përçim termik λ: 0,20 W/mK,
Dendësi : ≥ 680 kg/m3
Pesha e pllakës: ≥ 8,5 kg/m2 për 12,5 mm trashësi, ≥ 13,3 kg/m2 për 15 mm trashësi,
Perkulja nga ngarkesa ≥ 550 N gjatësor dhe ≥ 210 N transversal për 12,5 mm trashësi, ≥ 650 N gjatësi dhe ≥ 250 N transversal për 15 mm trashësi.

Pllake gipsi e parapergatitur me efikasitet te larte (klasifikimi DIN 18180 GKFI), 12,5 mm trashësi për përdorim të brendshëm (nëgodinë) duhet të kenë parametrat e mëposhtëm:
Klasa e reagimit ndaj zjarrit EN 13501-1: A2-s1, d0,
Rezistence ndaj faktorit avullues μ: 10 (thatë), 4 (njomë),
Përçim termalλ: 0,25 W/mK,
Dendësi ≥ 1000 kg/m3
Pesha e pllakës: përreth 12,8 kg/m2,
Perkulja nga ngarkesa: ≥ 725 N nëgjatësi dhe ≥ 300 N transversal,
Fortësia e sipërfaqes ≤ 15 mm Ø,
Kapaciteti i përthithjes se ujit: ≤ 10%.

10.2.3 SHTRESAT E IZOLIMIT TERMIK

Izolimi termik i fasadave do të realizohet me panele me lesh guri mineral, me densitet të larte të fibrës minerale, me përçim termal λ_0 0.035 W/mK, koeficienti i shpërndarjes se avujve μ 1, shmangie >10 kPa, delaminimi 10 %, forca ne ngjeshje >30 kPa, Klasa e reagimit ndaj zjarrit A1 – material i padjegshëm.
Instalimi
Është e rëndësishme në rastet ku vendi ku do vendosen panelet cilësohet si i rrezikuar nga zjarri, panelet detajet e fiksimit/saldimit të këtyre paneleve për te rezistuar në raste zjarri për ketë qellim;
Të gjithë fiksuesit duhet të jenë prej çeliku dhe jo prej alumini.
Kënde çeliku/ kanalet të jenë minimumi 1.6 mm të trashë,
Të gjithë vidat të jenë prej çelikutë kalitur.

Izolimi termik i brendshem do të realizohet me panele mineral lesh guri, me densitet të larte të fibrës minerale, përçimi termal λ_0 0.035 W/mK, koeficienti i difuzionit μ 1, delaminimi 10 %, forca ne ngjeshje >30 kPa, Klasa e reagimit ndaj zjarrit A1 – material i padjegshëm.

Instalimi
Është e rëndësishme në rastet ku vendi ku do vendosen panelet cilësohet si i rrezikuar nga zjarri, panelet detajet e fiksimit/saldimit të këtyre paneleve për te rezistuar në raste zjarri për ketë qellim;
Të gjithë fiksuesit duhet të jenë prej çeliku dhe jo prej alumini.
Kënde çeliku/ kanalet të jenë minimumi 1.6 mm të trashë,
Të gjithë vidat të jenë prej çeliku të provuar.

10.2.4 SUVATIMET

10.2.4.1 Produktet dhe materialet

Në përputhje me specifikimet, standardet dhe kërkesat e specifikuara këtu. Te sigurohen materiale pa përbërje asbesti. Në përgjithësi suvaja duhet të jete në përputhje me DIN 18550-2

10.2.4.1.1 Stukimi

Stukimi

10.2.4.1.2 Patinimi

Shtrese kompakte patinimi

10.2.4.1.3 Suvatim me baze cimentoje

Suvatim me baze cimentoje

10.2.4.1.4 Fino me baze çimentoje

Fino me baze çimentoje

10.2.4.1.5 Gëlqere e hidratuar

10.2.4.1.6 Agregatet

Rërë per stukimin
Imtësia e rërës – maksimumi i kokrrizes 1 mm.
Rërë për finon
Imtësia e rërës – maksimumi i kokrrizes 1 mm.
Rërë për shtresen me baze cimentoje
Imtësia e rërës: maksimumi i kokrrizes 2 mm.

10.2.4.1.7 Uji

Të jete i përshtatshëm për konsum shtëpiak pa minerale dhe substanca organike të cilat ndikojnë në fortësinë dhe qëndrushmërinë e suvase ose ose stukos.

10.2.4.2 Përmasat e përzierjes

Nëse nuk specifikohet ndryshe, materialet janë të specifikuara në bazë volumi dhe duhet të maten në enë për tu siguruar që masa të specifikuara do të kontrollohen dhe përdoren me kujdesin e duhur gjatë procesit të punës. Te pergatitet perzjerja e allcise, cimentos gati per perdorim dhe te shohet uje.

10.2.4.2.1 Stukimi

Rëra është opsionale ne stukim

10.2.4.2.1.1 Rëre dhe stukim

Te perzihet shtresa e ashper me masen 45 kg allci e paster se bashku ne jo me shume se 56l rere te lagur, te perzihet shtresa me ngjyre kafe me masen 45 kg allci e paster se bashku ne jo me shume se 85l rere te lagur, ose shtresa e ashper dhe ajo kafe mund te perzihen bashke me masen 45 kg allci e paster ne jo me shume se 70l rere te lagur . Te perzihet baza e shtresave per dyfishin e sasise me masen 45 kg allci gipsi e paster ne jo me shume se 70 l rere te lagur ne paretet e gipsit dhe jo me shume se 85 l rere te lagur ne murature

10.2.4.2.2 Patinimi

Te pergatitet pluhuri i gelqeres në përputhje me udhëzimet e printuara nga prodhuesi. Te perdoret duke zbatuar sasite e duhura ose duke ndjekur periudhat e përdorimit që rekomandohen nga fabrika
Shtresa per patinim (shtresa e bardhe) te perdoret mbi pllaken e gipsit. Te perzihet shtresa finale ne sasine e 1 porcioni allci e paster ne nje volum stuko te holluar.
Kjo mase perzjerje duhet te jete ekuivalente me 1 thes 45 kg allci e paster ne:
jo me shume se 4 thase 22.5 kg stuko ose
jo me shume se 127l stuko e holluar.

10.2.4.2.3 Suvatim me baze çimentoje

10.2.4.2.3.1 Suvatim me baze cimentoje Porland

Shtresat baze janë dy llojesh para se të vendosim shtresën përfundimtare. Këto dy lloje përbëhen nga shtresa e ashpër dhe ajo në ngjyrë kafe. Përziej shtresën e ashpër me masën e një sasie volumore çimento Portland, 0 deri në ¾ e sasisë të volumit të përgjithshëm, të jete pluhur gelqere i hidratuar dhe 2 e 1/2 të katër pjesëve te jete rërë. Përziej shtresën ngjyre kafe me masën e një sasie volumore të çimentos Portland, 0 deri në ¾ e sasisë të volumit të përgjithshëm të jetë pluhur gelqere i lengshem dhe 3 nga 5 pjese rërë (volumi i rërës në raport me çimenton dhe trashësinë e llacit).

10.2.4.2.4 Fino me baze çmentoje

Përziej shtresën përfundimtare me masat e një pjese sasi volumore çimento Portland me jo më tepër se një pjesë gelqere të lëngshme dhe jo me tepër se katër pjesë volumore rëre të lagur
Përdorimi gjatë punës do të jetë përcaktues i sasisë të gelqeres dhe rërës që përdoret në shtresën përfundimtare, brenda limiteve që përshkruhen me poshtë.

10.2.4.3 Ngjyra

Ngjyra e finos duhet të jetë e aprovuar nga prodhuesit e bojërave sipas kërkesës për ngjyrën e nevojshme.

10.2.4.4 Përzierja

10.2.4.4.1 Perzjerja e materialeve gjate punes

Përzierja e materialeve zakonisht bëhet me pajisje mekanike ndërsa në rastin e shtresës përfundimtare mund të bëhet me dorë. Përzierësit mekanik duhet të jenë të aprovuar në mënyrë të tille që ta përzjenë ne menyre uniforme mirë masën që ndodhet brenda tyre me sasine e ujit. Kur perzjerja behet me dore, duhet të ketë ngjyrë uniforme në kovën e pergatitjes, te shtohet uje dhe te perzihet në mënyrë uniforme e të vazhdueshme.

10.2.4.4.2 Materiale të gatshme të përziera dhe të paketuara

Materialet e gatshme të përziera të suvase per gips suvase me çimento duhet te jenë në përputhje me udhëzimet e printuara tëfabrikës.

10.2.4.5 BOJRAT

10.2.4.1 Ngjyra dhe motivi

Ngjyrat e bojes dhe motivet duhet të zgjidhen sipas katalogut dhe standardeve të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet referuar nga prodhuesi, jane per identifikimin e gjyres dhe moivit por nuk limitojne zgjedhjen per produkte te ngjashme ne ngjyre dhe motiv nga prodhues te tjere.

10.2.4.2 Boje plastike

Bojrat e perdorura per hapesira te brendshme duhet te jene me baze terpentine dhe cilesi te larte gome te paster, kur treten me vajra lini ato duhet te paraqesin nje siperfaqe te shkelqyeshme. Përdorimi i produkteve të gomës nga distilimi është e ndaluar.

Vinil me baze uji per lyerje muresh.
Bojërat me baze uji - gjendje ujore të një substance jo organike, mundesisht mbartin ngjites ose emulsione substancash sintetike makro molekulare.

Temperat - gjendje ujore e pigmenteve dhe mbushesve (gelqere, qymyr, pluhur i holle kalcium karbonati) mbartin ngjites natyrale ose sintetike të lidhesve (si ngjitës PVA, etj). Për tu përdorur vetëm në parete gipsi te hapesirave te brenshme. Muret duhet të jenë tërësisht të thatë në momentin e lyerjes. Temperat kane aftesi te mira mbulimi të njollave dhe jane lehtesisht te lashme.

Tiparet e lyerjes me vinil
Për lyerje e muresh dhe tavanesh në suva, në suva te parapergatitur, panele gipsi dhe suvate zjarr durue. Bojërat mat akrilike me baze ujë bazohen në sezinat akrilike të shpërbëshme në ujë dhe pigmente të rezistueshme ndaj dritës, rezistente ndaj motit dhe agjenteve industrial, e pastrueshme e pa depërtueshme nga avujt e ujit:
Aplikimi: me furçe, me rryl ose spërkatje.
Holluesi: ujë,
Cikli i lyerjes (në mur të ri): 1 shtrese 40% e holluar me ujë, shtresa përfundimtare të hollohet në masën 25%,
Përbërja: e bërë prejrezines akrilik edhe pigmentet e tretshme në ujë,
Përbërja solide: 33%,
Pesha specifike mesatare : 1.70 kg/l,
Viskoziteti mesatar: 6750 cps në 20° C,
Sasia: 5-6 m^2 për 1 kg (dy duar),
Trashësia pas tharjes: 50 Me (dy duar),
Paraqitja e shtresës: satin,
Pershkrueshmeria nga avujt e ujit: 25 g/m^2 pas 24 orësh.

10.2.4.3 Veshja e korimanove metalike me PVC

Materialet dhe instalimet e korimanove duhet ti përmbahen profileve të veçanta me aftësi të mirë amortizuese me bashkues të dyfishte gome në çdo profil, rezistente ndaj goditjeve ku te jete aplikuar

material vinili (minimumi 120mm lartësi), vete-fiksues me sipërfaqe kundër gervishtjeve, e lyer në trup, rezistente ndaj disifektimeve mekanike dhe kimike, zjarrdurues në përputhje me legjislacionin Evropian B-S1-dO. Trashësia në mm 2.0 mm. Vendosja në mure me mbështetjen e përshtatshme në polikarbonatin vete-fiksues si dhe vendosja e mbrojtesave (parakolpet) rreth 76 mm nga muri. E gjithë struktura ka funksion të dyfishtë për korimano dhe mbrojtese nga perplasjet dhe perfundon me kapak vet-fiksues polikarbonat.

10.2.4.4 Mbrojtëset e këndeve

Materialet dhe instalimeti mbrojtëseve të këndeve konsiston në një profil alumini të përforcuar me një gjerësi prej 50 mm në çdo krah të cilit i është montuar material pvc rezistues ndaj goditjeve, me vete-fiksim me sipërfaqe kundërgervishtjeve, e lyer në trup, rezistente ndaj disinfektimeve mekanike dhe kimike, zjarrdurues në përputhje me legjislacionin Evropian B-S1-dO. Trashësia në mm 2.0 mm. te fiksohet ne mure me dhe te perfundoje me kapak vet-fiksues polikarbonat.

10.2.5 BOJRAT SINTETIKE

Lyerja dhe motivi

Bojrat sintetike dhe motivet duhet të zgjidhen sipas katalogut dhe standardeve të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet referuar nga prodhuesi, jane per identifikimin e gjyres dhe moivit por nuk limitojne zgjedhjen per produkte te ngjashme ne ngjyre dhe motiv nga prodhues te tjere.

10.2.5.1 Bojrat sintetike

Enameli është i përbërë nga resine sintetike natyrale, vajra, mbushes mineral dhe disa pigmente oksidues. Ato duhet të kenë një aftësi të mirë fshehje të njollave, lehtesisht te aplikueshme, rezistente dhe me shekelqim.
Bojrat te pajisura nga resine sinteike dhe llak, me pigmente dhe mbushes ne solucion organik te resines sintetike, mund te permbajne dhe agjent thares (vaj, akrilik, oleo-alkid, chloro-vinil, epoksi, poleritane, poliestër, gome të klorinuar, silikoni). Tharja e shpejte e kthen siperfaqen ne nje shtrese te forte dhe rezistuese ndaj agjenteve atmosferik, drites dhe goditjeve.

Tiparet e bojës sintetike
E pastrueshme, me bazë uji me cilësi të lartë e me aftësi të mira mbuluese. Prezenca e përbërëseve shtesë mbron murin nga myku, karakteristikat kryesore:
Përbërja e lidhesave - bazohet ne emulsionin e rezines akrilike
Pamja e shtresës – opake,
Specifika të gravitetit - 1.64 ± 0.05 kg L at 20 ° C,
Viskoziteti- 7000 ± 1000 cP Brookfield G6 V10 at 20 ° C,
Mbulimi praktik - 12-13 m2/L për rshtresën,
Rezistence ndaj pastrimit – Klasi2sipas standardeve UNI EN 13300 ISO11998,
Tharje e murit – e ulët UNI 10792.

10.2.6 BOJRAT E TJERA

Bojra gelqerore -konsistojne në emulsionin gelqeror ose puder gelqere e holluar ne te cilen treten pigmente inorganike qe cilat nuk veprojne ndaj hidroksidit të kalciumit. Ngjitja me llacin përmirësohet nëpërmjet ngjitësit artificial ose natyral. Gjithashtu aplikohet në mure te sapo suvatuar duke perdorur pigmente natyrale.

Bojra silikate – përftohen nëpërmjet mbajtjes pezull të pigmenteve jo-organike ose pluhurave të kaolinit, solucioneve të pudrës ose shkumesit ne uje (silikat i sodiumit dhe potasiumit). Duhet të sigurohet një bashkim i qëndrueshëm me mbështetjen, të përgatitet nëpërmjet zhdukjes komplete të bojërave paraardhëse. Ajo nuk duhet aplikuar ne siperfaqe te lyera me bojra gelqerore.

Lyerjet e çimentos gjendja ujore e çimentos se ngjyrosur qe permban ngjites. Ato duhet të përgatiten në sasi të vogla për shkak të kohës së shpejtë të mpiksjes. Duhet të aplikohet brenda 30 minutave para se të forcohet. Pas fazës së forcimit tretja ne uje per perdorime te metjeshme duhet të ndalohet.

Bojë anti-ruxho dhe anti gërryerjes duhet të ketë lidhje me llojin e materialit i cili duhet të ruhet ndaj kushteve mjedisore. Lloj i bojës do të diktohet nga supervizorët e punës.

Boje intumeshente ka aftesi të krijoj një shtresë që fryhet në rast zjarri duke prodhuar pore ajri dhe duke mbrojtur sipërfaqen ku apikohet zjarr dhe nxehtesi. Duhet të jetë e cilësisë më të mirë dhe të sigurohet ne amballazhe të vulosura dhe të prodhuara se fundmi. Të përdoret vetëm me udhëzime te sakta te Mbikqyrësit te punimeve.

10.3 PJESA E 3 - ZBATIMI

10.3.1 Përgatitja e sipërfaqes për suvatim

Te pastrohet sipërfaqja nga pluhuri grimca të hedhura apo çdo materiali të jashtëm para vendosjes se paneleve te gipsit, suvase ose stukos. Te mos vendoset suvatimi direkt mbi sipërfaqet murale ose prej betoni që janë të veshura me bitumen ose me agjentë të tjerë kundra ujit, te lyera ose plastifikuar më parë. Para se të filloje suvatimi te lagen me ujë të pastër sipërfaqet murale ose të betonit për të arritur kushtet e duhura të lagështisë. Te kontrollohen dyshemetë metalike, kthesat e këndeve dhe gjithçka tjetër të jetë e vendosur në vijën e duhur para se të fillohet puna. Te mbulohen të gjitha veglat dhe kovat të cilat mund të mpiksen gjatë suvatimit. Mbulimi i këndeve duhet të ofrohet në të gjithë këndet deri në lartësinë 2 m mbi nivelin e dyshemesë dhe duhet suvatuar në pozicionin ku ndodhen.

10.3.2 MJESHTERIA E SUVATIMIT

10.3.2.1 Testi i trashësisë së shtresë

Te vendoset suva manualisht ose me makineri. Gjate vendosjes se finos me makineri, te kontrollohet hollimi i pluhurit te gelqeres dhe te mos kalojë trashësinë 75mm gjate testimit, suvaja e çimentos dhe fino duhet të kenë një trashesi jo më të lartë se 65 mm gjate testimit, duke perdorur 50x100x150 mm.

10.3.2.2 Aplikimi

Te aplikohet vendosja e tre shtresave (dy shtresa baze suvatimi dhe nje fino). Suvatimi nuk duhet të jetë i vazhdueshëm përgjatë fugave te ekspansionit dhe atye te kontrollit, që ndodhen në mur, ne pjesë të veçuara dhe tavane. Te perfundohet nivelimi, me plumbce , skuader dhe gjithçka tjetër me një tolerance 3 mm në 2500 mm, pa valëzime, plasaritje apo rrudha, çngjyrosje, cepa apo çdo lloj tjetër mangësie. Suvatimi te vendoset me kujdes në cepa dhe konture dhe deri në bashkime. Te tregohet kujdes mos shkaktohen rrjedhje të vazhdueshme gjatë vendosjes së suvase. Nuk duhet të ketë shenja të dukshme në shtresën pas përfundimit të një ditë pune apo edhe tënesërmen.

10.3.2.3 Kontrolli dhe zgjerimi i bashkimeve

Te vendosen fugat e kontrollit ne vendet e percaktuara para se te aplikohet fino. Fugat vertikale duhet të jenë të vazhdueshme ndërsa ato horizontale në të kundërt të atyre vertikale. Te kontrollohen fugat e ekspansionit, kontrollit, si dhe aksesoret per te siguruar levizjet e papermbajtura, shiritat metalik te mos jene të vazhdueshëm pas fugave si dhe si dhe siperfaqja mes fugave mos ti kaloje 14 m^2.

10.3.2.4 Trajtimi

10.3.2.4.1 Stukimi

Para stukimit, te sigurohet kontrolli i siperfaqes per te parandaluar tharjen e shpejte. Pas vendosjes se suvase, te sigurohet tharje e shpejte e saj për te rritur fuqine.

10.3.2.4.2 Suva çimentoje dhe stukim

Te mundësohet trajtimi me lagie (spërkatja e shtreses baze) para vendosjes se finos. Te laget shtresa baze menjhere para aplikimit te finos. Ne kushte nxehtesie, thatesire apo ere, siperfaqet e lagura te mbulohen me polietilen per te shmangur avullimin e ujit.

10.3.3 PUNIME SUVATIMI DHE STUKIMI

Ky sistem kerkon nje dore shtrese suva te ashper, pjesërisht të thate dhe një shtresë suvatim ngjyrë kafe.

10.3.3.1 Kriteret e trashesise te suvatimit dhe stukimit

Sipërfaqja vertikale;
Trashësia totale e suvatimit të jete nga 13 mm deri në 15 mm;
Sipërfaqja horizontale;
Trashësia totale e suvatimit të jetë 7 deri në 10 mm.

10.3.3.2 Punimet e shtresës bazë suva dhe stuko

Te vendoset shtresa e ashpër 5 deri në 6 mm për të mbuluar bazën me material të mjaftueshëm dhe për të krijuar presion dhe një lidhje të mirë mbi siperfaqen e murit apo tavanit. Te ferkohet sipërfaqja ne menyre qe te perftohet sa me e forte dhe kompakte. Te aplikohet nje dore suva me shtrese kafe për të treguar shtresen e llacit, te ngjeshet dhe te peforcohet siperfaqja pa aplikimin e ujit dhe te fërkohet ose kruhet për të perftuar shtresen finale.

10.3.3.3 Shtresa përfundimtare me fino

Te sperkatet dhe laget në mënyrë të moderuar shtresa bazë e cila është tharë para se të vendoset fino. Te përshpejtohet fino nëse është e nevojshme për të mundësuar kohën e qëndrimit të finos jo me tepër se katër orë nga koha e përzierjes së saj.
Te vendoset stuko ose perberes te bardhe mbi shtresën bazë, te fërkohet në mënyrë të njetrajtshme, te mbush boshllëqet dhe te ngjeshet mirë mbi sipërfaqe.
Te lihet te thahet për disa minuta dhe pastaj te spërkatjet me ujë. Te ushtrohet fuqi maksimale me qëllim të ngjeshjes së shtresës përfundimtare dhe duke mundësuar siperfaqe te paster e te rregullt. Te aplikohet me mistri fino mbi shtresën bazë, sa më imët të jetë e mundur, 2-3 mm, vecanerisht aty ku jane krijuar krijuar plasaritje apo njolla.

10.3.4 PUNIME SUVATIMI ME BAZE ÇIMENTOJE

Te aplikohet suva me baze çimento ne siperfaqet e brendshme dhe te jashtme te cilat mund të jene te ndjeshme ndaj gërryerjeve, lagështisë.

10.3.4.1 Kriteret e trashësisë se suvatimit me baze çimentoje

Sipërfaqja vertikale;
Trashësia totale nga 13mm deri në 15mm.

10.3.4.2 Punimet e suvtimit me baze cimentoje

Te vendoset shtresa e ashpër për të mbuluar bazën me material të mjaftueshëm dhe për të krijuar presion dhe një lidhje të mirë mbi siperfaqen e murit apo tavanit.
Te fërkohet sipërfaqja horizontale. Te vendoset shtresa kafe pasi ka kaluar periudhën e nevojshme prej 24 orësh të spërkatjes dhe lagështisë. Te aplikohet me mistri fino mbi shtresën bazë, sa më imët të jetë e mundur, per te perftuar nje siperfaqe te drejte dhe te paster

10.3.4.3 Punimet e shtreses fino

Pasi shtresa kafe te jete lagur për jo më pak se 24 orë dhe ka të paktën 5 ditë, te aplikohet shtresa përfundimtare me një trashësi jo më të madhe se 3 mm. Pasi te thahet shtresa e vendosur, te sperkatet me uje para aplikimit te shtreses finale.

10.3.5 KRITERE TE PËRGJITHSME TE SUVATIMIT TE BRENDSHEM

10.3.5.1 Mbulimi i elementeve metalike (ne fasade)

Davancialet e dritareve, tubat dhe te gjitha paisjeve te varura ne mure duhet të mbulohen me suva me rrjete teli në mënyrë që të parandalohet zgjerimi i mundshëm i dëmtimit të shtresës të suvase.

10.3.5.2 Nivelimi i suvase se brendshme

Nivelimi i suvase te muret duhet të vazhdojë dhe të pastrohet deri në kufinjte e tavanit. Çdo mbetje suvaje që mund të prek tavanin duhet te eleminohet. E njëjta gjë duhet bërë me dysheme, perjashtohen rastet kur aplikohen sisteme te vecanta dyshemeje.

10.3.5.3 Suvatimi ne tavanet e parapergatitur

Minimumi i suvatimit 5mm, te gjitha fugat te lidhen me fashature. Suva me trashësi më pak se 3 mm nuk duhet të aplikohet në tavan.

10.3.5.4 Pastrimi dhe dorëzimi

Dhomat duhet të jenë të fshira dhe pastruara mirë para se te dorëzohen nga punimet e suvatimit.

10.3.5.5 Tharja e përshpejtuar

Nëse programi i punës së kontraktorit kërkon që te aplikohen njësi dhe pajisje mekanike për nje tharje të përshpejtuar te suvase, atëherë duhet të bihet dakord me Mbikëqyrësin e punimeve dhe me përdorimin e matësit të lagështisë.

10.3.5.6 Suvatimit në dhoma me lagështi

Në dhoma me lagështi nuk duhet te perdoret allci si material lidhes .

10.3.6 KRITERE TË PËRGJITHSHME TË SUVATIMIT TË JASHTËM TË (GODINAVE)

10.3.6.1 Përgatitja dhe pastrimi i fasadave

Duhet të kushtohet kujdes gjatë pastrimit të fasadave me ujë me presion, por ne menyre qe uji mos të depërtojë midis tullave nëpërmjet plasaritjeve apo fugave të plastikës. Nëse uji përdoret në mënyrë agresive, aty ku ka dhe agjente apo materiale shtesë reagues ndaj presionit dhe që mund të rrezohen, atëherë uji nuk duhet të derdhet në toke por të grumbullohet në konteniere të përshtatshme.

10.3.6.2 Ruajtja e fortesise

Fortesia e suvase nuk duhet të jetë më e vogël se fortesia e nëntokës. Kur është ekspozuar jashtë çdo shtresë suvaje do të pesoje nje dobësim të fortesise.

10.3.6.3 Tharja midis shtresave

Çdo shtresë suvaje duhet lejuar të thahet para se ti mbivendoset shtresa tjetër. Koha normale e tharjes është 1 ditë për çdo cm trashësi të shtresës.

10.3.6.4 Materialet e paqëndrueshme të nëntokës

Në situatën kur nëntoka është e përbërë nga materiale të ndryshme atëherë për të krijuar një shtrese homogje, duhet aplikuar nje shtrese e ashper suvaje e cila mund të mpikset për një javë para se të vendoset dora tjetër e suvase. Te aplikohen në qendër ose në 1/3 e sipërfaqes rrjeta përforcuese të cilat jane rezistente .

10.3.6.5 Suvaja mbi korrnizime

Kornizimet me materiale druri apo metalike, nuk duhet te lidhen mekanikisht me suvane si dhe te shkeputen prej saj.

10.3.6.6 Suvaja rezerve per riparime.

Të paktën 10 kg llaç duhet të mbahet rezervë për të riparuar fasadën ose krisjet në të.

10.3.6.7 Qëndrueshmëria e ngjyrës dhe e tekstures.

Kujdes duhet treguar për të pasur qëndrueshmëri të ngjyrave trashësisë dhe përmbajtjes se suvase së jashtme. Paregullsite duhen të klasifikohen si defekte madhore. Nëse duhet përdorur suva duhet të sigurohemi që ajo është e një dore.

10.3.6.8 Plintusat mbrojtëse

Plintusat në pjesën fundore të seksionit të fasadave duhet të jene izoluese.

10.3.6.9 Rrjetat përforcuese

Rrjetet përforcuese duhet të fiksohen rrafsh me sipërfaqen (pa rrudhosur). Gjate hapjes se rrjetës ajo duhet të hapet në mënyrë diagonale nga këndet e shpalosjes. Mbivendosjet duhet të jenë minimalisht 100 mm. Mbivendosja në nyje lidhëse ose elementët e tjerë të godinës duhet të jenë 300 mm. Rrjetat duhet të instalohen në fugat midis dy materialeve nën tokë dhe kur fillon suvatimi.

10.3.6.10 Plasaritjet

Plasaritjet në suvatim, me të gjera se 0.2 mm duhet të konsiderohen defekte.

10.3.6.11 Perpuethshmeria e Suvatimit me nëntokën

Kur përzgjidhet vendosja e suvse, duhet marre ne konsiderate dhe tipi i nentokes. Me punimet e reja të tullës Moduli i Elasticitetit nuk duhet të tejkalojë 2500 N/mm^2.

10.3.6.12 Paisje kundra ndryshkut

Te perdoren paisje kundra ndryshkut kur te shtrohen shtresat e suvase.

10.3.6.13 Depozitat e kripës

Depozitimet e kripës duhet të hiqen nga sipërfaqja e nentokës duke përdorur një furçë të tendosur (jo metalike) pas lenjes se murit per tu tharë.

10.3.7 NJOLLAT DHE SHENJAT

Të prerat ose njollat, plasaritjet, dëmtimet ose ngjitjet difektoze gjate suvatimit, duhet të jenë në përputhje me formën e tekstures finale, si dhe me të njëjtën ngjyrë me pastrimin përfundimtar që është vendosur në sipërfaqe suvatimit. Fillesa e punës përmbledhëse ose e punës së përfunduar duhet kryer në mënyrë të pastër. Te hiqen derdhjet e pikave ose plasaritjet nga sipërfaqja. Te lihet e paster për lyerje ose fino.

10.3.8 PUNIME ME BOJËRA VINILI DHE SINTETIKE

Parametrat e materialit
Bojërat me bazë uji dhe vaji duhet të jenë prodhime te fundit, të mos kenë copëzime, mpiksje, qime ose xhelatinizim. Ato do të ofrohen në vendin e punës të vulosura, në enët përkatëse me udhëzimet e prodhuesit, si: lloji i cilësisë që duhet përdorur, mënyra e ruajtjtjes dhe konservimit të produktit, datën e skadencës etj. Ena do të hapet vetëm në momentin e përdorimit dhe në prezence të Mbikëqyrësit të punimeve. Produktet duhet të jenë gati për përdorim, pas hollimit sipas udhëzimeve të dhëna nga prodhuesi. Ato duhet të kontribuojnë në sipërfaqet ku pritet dhe të japin efekt brenda kohës.
Produktet për muraturat duhet të jenë të llojit jo cipe formuese. Testime që kane lidhje me karakteristiken e materialit, do të zhvillohen para dhe pas vendosjes: shembujt, pigmentin bazë, hollësinë e grimcave të finos, konsumin e energjisë, shpejtësinë e tharjes, trashësinë rezistencën ndaj agjenteve atmosfere, agjentet kimik, deri tek ciklet termale, rrezet ultra vjollcë, lagështia. Në çdo rast produkti duhet të ketë aftësi të mira penetrimi dhe përputhshmëri me sipërfaqen ku do të vendoset duke garantuar ajrosje të mirë. Këto tipare do të mbizotërojnë në kohëzgjatjen e ngjyrave.

10.3.8.1 Përgatitja e sipërfaqes

Betoni – për trajtimin e mureve prej betoni dhe mureve prej betoni të përforcuar referojuni kapitujve perkates.
Hekuri dhe çeliku - për trajtimin e sipërfaqeve metalike referojuni kapitujve përkatës.
Suvatimit dhe pllakave te gipsit- te pastrohet siperfaqja qe do të lyhet, nivelimi i parregullsive me ane të stukimitme, stukos dhe rëres përkatëse. Çdo njollë vaji apo graso duhet të hiqet me anë të përdorimit të solucioneve.
Trajtimi paraprak do të jetë me konsolidimin e shtresës, 0.2 l / m me bazë rrëshire të veçantë dhe vajrash tretës alifatike jo më pak se 0.85 Kg / m^2 peshë specifike.

10.3.8.2 Aplikimi i cikleve dhe materialeve

Metoda duhet të çoje në aplikimin uniform të bojës, teknikisht të kënaqshëm. Para se të fillojë lyerja duhet njoftuar dhe rënë dakord me Mbikëqyrësin e punimeve për datat e inspektimit. Lyerja që tregon mpiksje ose shenja përkeqësimi kur hapet duhet të hidhet. Nëse ajo ka krijuar një cipë të hollë mbi sipërfaqen e bojës atëherë te hiqet cipa para përdorimit. Përzierja e komponentëve të ndryshëm me hollues dhe ose me forcues duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet dhe raportin e të dhënave nga furnizuesi. Dy komponente lyerje duhet të përdoren në kohën e specifikuar nga prodhuesi. Lyerja mund të kryhet me furçë, spraj, me ose pa ajër, ose me një kombinim të këtyre metodave sipas udhëzimeve të prodhuesit. Aplikimi duhet të kryhet nga një bojaxhi me përvojë, trashësia e shtresave të ndryshme të bojës duhet të jetë uniforme dhe sipërfaqja e lyer duhet të jetë e pastër pa lënë shenjat e furçës, fryrje, plasaritje dhe defekteve të tjera. Kujdes i veçantë duhet treguar që rastësisht gjatë punës të mos bie boje mbi: dyer, tavane, dysheme, bimësi, etj. Përfundimisht e gjithë boja që mund t ëketë rënë në to duhet të hiqet menjëherë. Vëmendje e veçantë gjatë lyerjes duhet t'i kushtohet qosheve, kapakëve dhe zonave të vështira për tu arritur. Shtresa e parë duhet të vendoset brenda 24 orëve pas përgatitjes së sipërfaqes. Nëse sipërfaqja është me bazë rëre, atëherë preferohet që boja të vendoset brenda 6 orëve dhe për çdo rast tjetër, nëse ndryshojnë standardet e pastërtisë se sipërfaqes.

10.3.8.3 Kushtet klimaterike

Lyerja nuk duhet kryer në rast se bie shi, borë, mjegull, stuhi rëre ose në asnjë lloje kushti atmosferik që mund të shkaktojë kondensim dhe avullim të sipërfaqes që do të lyhet. Shenjat e lagështisë duhet të largohen nga sipërfaqja brenda 5 minutash. Lyerja nuk duhet kryer nëse ndryshueshmëria e lagështisë në ajër është me e madhe se 85%, kur temperaturat janë nën 5 grade celsius dhe mbi 45 gradë celsius, lyerja duhet të aprovohet vetëm nga prodhuesi.

10.3.8.4 Lyerja e nënshtresave deri te finalja.

Para se të vendosni çdo nënshtresë fillimisht ato duhet të jenë të thata plotësisht ose e mpiksur mjaftueshëm. Para se të vendosen shtresat e tjera çdo dëmtim i mundshëm në shtresën ekzistuese duhet të riparohet duke përdorur të njëjtën lloje boje. Çdo shtresë e re boje duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga ato të mëparshmet, për të shmangur zona të humbura dhe për të lehtësuar inspektimin.

10.3.8.5 Trashësia e lyerjes

Matjet shërbejnë për të kontrolluar trashësinë e shtresës mbrojtëse si dhe uniformitetin e vendosjes se bojës në të gjithë gjerësinë e saj. Verifikimi duhet bërë nës htresën e bojës së njomë dhe në shtresën

e thatë. Raporti i trashësisë të bojës së njomë dhe të thatë do të tregohet nga personi përgjegjës për marrjen e mostrave. Në asnjë zonë trashësia nuk duhet të jetë më pak se sa nevojitet.
Në rast se trashësia minimale e përshkruar nuk është arritur, në zona të caktuara duhet vendosur dhe një shtrese tjetër boje. Trashësia e lyerjes nuk duhet të jetë më e lartë se minimumi i përcaktuar në mënyrë që të mos ndikojë në pamjen apo performancën e lyerjes.

10.3.8.6 Mbrojtja dhe pastrimi

Pas çdo dorë lyerje duhet te aplikohet një pastrim tërthor i ambjentit
Punimet duhet të mbrohen nga goditjet aksidentale dhe sulmet e mundshme fizike apo kimike.

10.3.8.7 Kontrollet dhe sistemet e kontrollit

Para lyerjes, te kontrollohet që përgatitjet për lyerje janë bërë në përputhje me standardet. Sipërfaqet e lyera do t'i nënshtrohen ekzaminimit vizual për të kontrolluar pamjen dhe vazhdimësinë e lyerjes. Zonat ku dyshohet se mund të ketë porozitetit ose ndërprerje te bojës do të kontrollohen me instumenta të përshtatshme. Trashësia e bojës së njomë mund të kontrollohet me instrumentet e duhura. Trashësia e shtresës së thatë të lyerjes do të kontrollohet me instrumenta të përshtatshme. 5 matje dhe testime duhen kryer (rezultati i përgjithshëm i matjeve duhet të japë rezultatin ne leximin e trete) çdo pesë pikë për çdo 10 m^2 ose më pak. Mesatarja e 5 matje/testime nuk duhet të bjerë nën trashësinë e kërkuar.

11. VESHJET E DYSHEMEVE DHE MUREVE (PUNIME SHTRESA)

11.1 PJESA 1- TË PERGJITHSHME

11.1.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara me poshtë formojnë një pjese të specifikimeve dhe referencave shtese. Publikimet që referohen në ketë tekst janë vetëm ato themelore.

11.1.1.1 Zbatimi sipas ligjeve dhe normave Shqiptare

11.1.1.2 Normat dhe standardet Evropiane

DIN 18195	Hidroizolim i ndërtesave dhe strukturave; hidroizolim i shtresave që i nënshtrohen presionit hidrostatik nga brenda; projektimi dhe mjeshtëria profesionale
DIN EN 87	Dysheme dhe mure me pllaka qeramike -Përkufizimi, klasifikimi, karakteristikat dhe marka.
DIN EN 186-1	Pllaka qeramike -pllaka qeramike kundra ujit që ta kenë përthithjen e ujit në mes të 3% dhe 6% sipas (Grupit A IIa)
DIN EN 176	Pllaka qeramike prej pluhuri të presuar që e kanë përthithjen e ujit të ulët (E deri në 3%) – Grupi BI
DIN EN 177	Pllaka qeramike prej pluhuritë presuar me përthithjen e ujit të klasit E nga 3% deri në 6% (Grupi B IIa)
DIN EN 1347	Kollë për vendosje pllakash – përcaktimi i kapacitetit të lagështisë
DIN EN 12808	Kollë dhe llaç për pllakat -Pjesa 1 përcaktimi rezistencës të agjentëve kimik Reagimi ndaj rrëshirës Kolle dhe llaç për pllakat - Pjesa 2: Përcaktimi dhe rezistenca ndaj gërryerjes/abrazionit

Kolle dhe llaç për pllakat – Pjesa 3: Përcaktimi i fleksibilitetit dhe fuqisë ngjeshëse.
Kolle dhe llaç për pllakat – Pjesa4: Përcaktimi i tkurrjes
Kolle dhe llaç për pllakat - Pjesa 5: Përcaktimi i përthithjes së ujit
DIN EN 13888 Kolla dhe llaçi për pllaka – Përkufizime dhe specifikime

11.1.2 PARAQITJET

Publikimet e Listuara me poshtë formojnë një pjesë të specifikimeve dhe referencave shtesë Publikimet që referohen në ketë tekst janë vetëm ato themelore.

Te paraqiten mostrat e mëposhtme për miratim:

Pllaka qeramike për shtrim dyshemeje -100m katror shtrim duhet te tregoje: ngjyren, shtresen, motivin, formen, tipin, fugat mes pllakave për vendosjen e bojakut.
Pllaka qeramike për mure - set me 4 pllaka, duhet te tregoje: permasat, formen, shtresen, tipin dhe motivin, fugat mes pllakave për vendosjen e bojakut.

Aksesore për pllaka qeramike- copëza për çdo lloj që të tregojnë ngjyrën, shtresen, llojin dhe modelit, Në përgjithësi produktet që vijnë nga një fabrikues tjetër nuk duhet të aplikohen në të njëjtën siperfaqe.
Të gjitha dyshemetë do të bëhen me metodat dhe materialet e ndërtimit që janë në përputhje me legjislacionin aktual për llojet e pershtatshme të dyshemeve. Të gjithë mostrat e materialeve duhet të nënshtrohen për aprovim, ne lidhje me ngjyren e perhershme. Materialet me përbërje dhe prodhues të njëjtë ku origjina dhe cilësia është provuar duhet të përdoren në të gjithë sipërfaqen e dyshemesë.
Gjatë shtrimit të dyshemesë muret dhe të gjithë orenditë e tjera duhet të mbulohen dhe mbrohen që të mos dëmtohem gjatë procesit të punës. Për të pasur kohën e duhur të tharjes së dyshemesë dhe në çdo rast tjetër deri në 10 ditë pas mbylljes së punës.Të vendosen barriera paralajmëruese që të mos lejojnë shkeljen e dyshemesë, që do të thone të sapo vendosura dhe te pakalueshme për momentin.

Dyshemetë PVC, siperfaqet dhe/ose te forta, të mbuluara me rere dhe te pastruara, do të mbrohen deri në mbërritjen e klientit së bashku me materialet si (pllaka, takot e drurit, tallashi etj.) të cilat janë vendosur për të shmangur dëmtimin e sipërfaqes së dyshemesë së shtruar.

Para dorëzimit, dyshemetë duhet të lahen pastrohen dhe thahen me produkte të veçanta në përputhje me udhëzimet që ka dhënë fabrika për larjen dhe pastrimin e produktit. Detergjente me përqendrim të lartë ose hollues që nuk janë aprovuar nga fabrika ose Mbikëqyrësi, nuk duhet të përdoren mbi dysheme.

Dyshemetë të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj shiut ngricës ose nxehtësisë nga rrezatimi diellor do të mbrohen në mënyrë të përshtatshme. Çdo lloj shtrimi kërkon kohë të mjaftueshme për tu bërë gati të shkelet vendosja/shtrimi i sipërfaqes së tij duhet të marrë kohën e duhur dhe jo të përshpejtohet por brenda limiteve kohore të përcaktuara që mos të ketë ndikim në fortësinë dhe cilësinë e përgjithshme të shtrimit. Në rastet që përshkruhet në projekt ose në përputhje me pragun, zona të ndryshueshme në lartësi të dyshemesë etj, kulmet dhe cepat e dyshemesë dhe/ose shkarkimet, duhen mbrojtur nga rreziqet e dëmtimit të instalimeve, ngjitjeve të përshtatshme të PVC-së, të gomës, çelikut normal apo atij special, bronzit dhe gurit që të kenë karakteristikat e përshtatshme për të rezistuar nga trafiku i pritur.

Diametri i brendeshem i tubave duhet te jete te pakten 1,3 here diametrin e rrethit te jashteshkruar tufes se kabllove te futura ne te dhe nuk duhet te permbaje kabllot per rrjetet e dedektimit te zjarri, rrjeti LAN dhe te telefonise.Ky koefiçient i zmadhimit duhet te rritet deri ne 1,5 kur kabllot jane te tipit te plumbuar ose me veshje metalike;diametri i tubit duhet te jete aq i madh sa te futen e te rifuten me lehtesi ne te kabllot ne menyre qe te mos demtohen as kabllot as tubat. Megjithate diametri brendeshem nuk duhet te jete me i vogel se 14mm;

Kurbat duhet te kryhen me rakorde ose tubat duhet te instalohen me pendence te tille qe nuk demton apo bllokon kalimin e kabllove;

Ne çdo kthese te forte eshte e nevojshme struktura murale te lejoje qe kabllot te kalojne lehte ne tuba dhe per cdo derivim nga nga linja kryesore ne sekondare ne cdo dhome fundi i tubit duhet te perfundoje ne kuti shperndarese per lidhjet; bashkimet e percjellesave duhen te kryhen ne kutite e degezimit duke perdorur morsetat shtrenguese e nevojshme;

Kutite e degezimit duhet te jene te tilla qe gjate instalimit te mos jete e mundur nderhyrja e trupave te huaj dhe te kryhet shperndarja e nxehtesise qe prodhohet ne to.

Mbulesa e kutive duhet te jete e garantuar me fiksim dhe e hapshme vetem me vegla te posaçme.

Keshtu eshte pranuar te vendosen kabllo ne te njejtin tub dhe ne te njejten kuti, perderisa nuk jane te izoluar per tensione te ndryshem dhe kutite e veçanta te jene te pajisura me membrane, qe mund te hiqet vetem me veglat perkatese ndermjet morsetave te destinuara per te shtrenguar percjellesa qe u perkasin sistemeve te ndryshem.

2.5.9 Kanalinat

Kanalinat do te formojne nje sistem te kalimit dhe do te jene minimumi 60 mm te larta. Duhet te jene te prodhuara me baker te zinkuar qe nga fabrika. Do te perfshijne edhe aksesoret e ndryshem si kapket, kapeset ne tavan dhe fiksueset. Fiksuesit duhet te mbajne nje ngarkese me te madhe se vete kanalina per te pasur sigurine brenda dhe duhet te jene te prodhuar nga fabrika qe prodhon kanalinat. Rrezja e kthesave duhet te jete 140mm ose me shume.

- Kryqezimet e kanalinave:

Madhesia sic tregohet nga 100, 200 deri ne 600mm gjeresi.

- Kanalinat ngjitese:

Madhesia sic tregohet nga 100, 200 deri ne 600mm gjeresi, me ndarje maksimale te hapesirave ne 300mm

- Kanalinat tip:

Kanalinat do te jene te prodhime te gatshme me ndarje jo me shume se 115mm nga qendra.

2.6 Celsat dhe prizat

Kutit e instalimit per celesat dhe instalimet e tjera jane pjese e artikujve te references. Vetem kuti me montim me vida te filetuara jane perdorur per instalimin e celsave dhe prizave ne kuti brenda murit.

Kutite per instalim brenda murit ne mure prej tulle te plote dhe betoni jane te fiksuar sipas rregullave te pergjithshme me cimento dhe duhet te mbushen siper me suvatim. Kuti te vecanta te pershtatshme jane perdorur per muret e gipsit dhe materialet e tjera.

Në muret e gipsit, duhet të kihet kujdes për tu siguruar që kabllot dhe përçuesit nuk janë të fiksuar vetëm ne gips, por edhe ne konstruksion metalik me mjete të përshtatshme. Kutite e instalimit do te jene gjithashtu ne menyre te ngjashme.

Çelesat janë instaluar kryesisht si njësi të veçanta të cilat mund të mbulohen me nje kapak te përbashkët. Instalimi kurriz me kurriz i celesave dhe celesa-prizave nuk lejohet.

Te gjithe celesat on/off, te series deviat, inverter, dhe pulsantet e komandimit jane 10 A, 220 V. Te gjithe celesa-prizat jane 230 V, 16 A, 230 V. Për ngarkesat e lidhura ne më shumë se 10 A, jane perdorur celesa-prizat e tipit CEE.
Te gjithe celesat-prizat qe jane 400V dhe 230V me ngarkesa me shume se 10A jane te tipit CEE sipas ngarkeses se kerkuar. Gjithashtu duhet te furnizohen prizat perkatese.

Ne pergjithesi eshte perdorur instalim i maskuar. Instalimi ne mure tulle dhe ne dhoma te lageshta do te jete i fshehur dhe ne ambjente mekanike do te jete jashte murit.

Kutite e celesave te instaluara brenda murit jane te fiksuara me llaç. Kur eshte e mundur keto kuti mund te perdoren edhe si kuti shperndarese.

Kapaku eshte i kapur me vida dhe eshte me ngjyre te bardhe per celesat dhe celesa-prizat. Per pajisjet kunder lageshtires kapaku mund te jete me ngjyre gri.

Celsa-prizat e emergjences jane me ngjyre te bardhe me kapak portokalli. Cdo pajisje emergjente eshte shënuar "emergjente" në krye e shenuar me shkronja të zeza jo me pak se 6.3 mm lartesi (inç një e katërta).
Nuk lejohen llojet te ndjeshme ndaj shtypjes.
Koridoret jane te pajisur me celesa-priza te tipit njepolar 230V me hapesira deri ne 10m maksimumi. Pervec kesaj, celesa-priza te tipit njepolar 230 V jane te insatluar ne secilin nga pajisjet portable.

Instalimi i kutive ne tavan te varur do te behet me jo me teper se 4 kabllo ose percjellesa.
Materialet me difekte ose materialet e demtuar nga testet do te riparohen nga kompania kontraktuese. Materialet per instalime ne siperfaqe do te testohen nga lageshtira, celesa-prizat e testuar nga lageshtira jane te pajisuar me kapak.

Celesat, celesa-prizat dhe kutite e percjellesave per instalimet ne siperfaqe jane te kapura me kunja.

Percjellesat jane instaluar me te njejten distance nga tavani. Ne kete rast linjat mund te arrihen me dore dhe kutite jane te mbyllura me kapak. Kur eshte e mundur, ato do te instalohen vertikalisht siper celesave. Ne zonat me tavan te varur percjellesat jane mbi tavanin e varur. Shtresa respektive e tavanit do te etiketohet me shenja.

Te gjitha celesat dhe prizat e kerkuara jane pergjithesisht te tipit te dy-polar. Celesat dhe prizat e pajisjeve ne koridore jane te tipit nje-polar. Ato jane te fiksuara me vida jo me morseta. Celesa-prizat 230V te tipit dy-polar jane nje kombinim i dy celesa-prizave nje-polar, poshte nje kutie te mbuluar, p.sh. me dy kuti instalimi.

Lidhjet e percjellesve nga kutia shperndarese ne kutine e celsave dhe prizave duhet te behet me nje percjelles 1.5 mm^2.

Kutite per celesa dhe celesa-priza jane drejtekendore. Kombinimet prane deres jane vertikale, celesa-prizat dy-polare jane te instaluar horizontalisht. Per kombinime perdoren kapak te ndryshem.

Për të lehtësuar vendndodhjen e kutive te fshehura pas suvatimit, të gjitha kutitë shperndarese te fshehura janë te mbyllura me një mbulesë të veçantë për të mundësuar qe kuta shperndarese e fshehur të gjendet pa dëmtuar suvane e përfunduar.

Te gjitha materialet qe nuk duken duhet te llogariten duke perfshire furnizimin e kutive te celesave dhe punimet ndihmese sic jane pjese te vecanta, montuese, etj.
Te gjitha siperfaqet e montimit te materialeve perfshijne furnizimin me kunja, vida, pjese te vecanta, etj. Kutite ne ambjentet kirurgjikale dhe laboratore, ne depot e dorezimit te medikamenteve, atyre kardiake, ne njesite e kujdesit intensiv dhe ne ambjentet e infermiereve pajisen me kuader dhe me etiketimet e numrit te qarqeve.
Etiketimet jane te bardha, te shenuara me shkronja te zeza, jo me pak se 6.3mm mbi kuti dhe jane te kapura me vida.

Prizat qe jane te sigurta ndaj femijeve, jane parashikuar ne te gjitha qendrat e pritjes dhe te terrenet e lojerave.

2.6.1 Lidhjet

Të gjitha pajisjet e lidhur në mënyrë të përhershme jane te lidhura me kuti shperndarese. Kabulli ushqyes në një pajisje vjen nga muri ne nje kuti lidhese. Një kabllo fleksibël lidhje, në mes kutisë lidhëse dhe pajisjes, furnizon pajisjen.
Lidhjet e kordonit te shperndarjes nuk do të kundërshtojnë kodin e dhënë mbrojtjes për kutinë lidhëse dhe pajisjen

Para fillimit te punes, kontraktori duhet të koordinojnë me kontraktorin për sistemet mekanike, vizatimet e kantierit te objektit dhe duhet te filloj instalimet në përputhje me vizatimet e kantierit te objektit të miratuara.

Sipërfaqja e montuar e instalimeve elektrike të sistemit të emergjencës që nuk është në

kanaline është e mbrojtur mekanikisht nga instalimi në tuba metalik te forte.

2.7 Sistemi i rrjetit telefonik

Do te instalohet një sistem telefonik që ka karakteristikat e mëposhtme. Ky sistem duhet të realizohet në përputhje me normën EN0173 (Standarde Europiane të instalime elektrike te strukturuar) dhe të normës VNM / TIA 68B (Standartit Amerikan të instalimeve elektrike të Strukturuar, që është përmendur nga pothuajse të gjitha produktet në treg). Për më tepër, ajo duhet të marrë çertifikatat përkatëse të miratimit nga ana e Kontraktuesit.
Sistemi telefonik duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme të përgjithshme:

2.7.1 Centrali telefonik

Sistemi duhet të realizohet nga centrali telefonik i instaluar në dhomën e sistemeve te veçanta te godines.
Centrali telefonik duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Njësinë elektronike PABX te programueshme
- N ° 4 linjat jashtme urbane
- N ° 60 linjat e brendshme
- Predispozicion per komunikim te brendshem dhe te jashtem
- Grupi i furnizimit me back-up akumulatoret me 30 minuta te autonimise

Centrali telefonik duhet të jetë i lidhur me perçjellesin telefonik me n.10 kopje kablli shume fijesh te perdredhur TR 10x2x0,6 / HR.
Perçjellesit për lidhjen e linjave të jashtme të centralit telefonik janë të përjashtuar nga kjo kontratë.

2.7.2 Centrali kryesor (ck)

Ne dhomen teknike te sistemeve speciale do te vendoset nje central telefonik kryesor me permasa 800x800 mm me nje rack 19" dhe do te pajiset me :

- Module te testuara te sinjaleve telefonike nga centrali kryesor
- Module te testuara te sinjaleve telefonike te perdoruesve te rrjetit telefonik
- Module te testuar te sinjaleve telefonike dhe perdorimit te transmetimit te te dhenave data, sic pershkruhet me poshte.
- Pajisje aktive per transmetimin e te dhenave sic pershkruhet me poshte.
- Aksesore lidhje dhe patch cord.

2.7.3 Dalja e prizave telefonike

- Në pikat e treguara në vizatimet e projektit jane percaktuar pikat e prizave telefonike te pajisura me prize RJ45, lidhur me centralin e godines nepermjet nje kablli CAT5 dhe UTP te skermuar LS0H.
- Për pikat e prizave telefonike procedurat e mëposhtme te ekzekutimit janë dhënë për:
- Pikat e prizave brenda murit jane te lidhura me kutinë me ane te kanalinave te shpërndarjes dytesore elektrike për rrymat TU përmes tubave pvc RK1, me diametër 20 mm.
- - Pikat e prizave jashte murit jane te lidhura me kutinë me ane te kanalinave te shpërndarjes dytesore elektrike për rrymat TU përmes tubave pvc RK1, me diametër 20 mm IP44 min.

2.7.4 Shenime te pergjithshme mbi daljet e prizave telefonike

Pozicioni instalimit te pikave te prizes, te treguara në vizatimet e projektit duhet të konsiderohet vetëm një tregues. Pozicioni përfundimtar do të thuhet gjatë ekzekutimit të punimeve në bazë të mobiljeve dhe informacionin e dhënë nga drejtuesit e punimeve.
Përveç pikave te treguara në vizatimet e projektit bashkangjitur, kontraktuesi duhet të sigurohet për realizimin e pikave të mëposhtme te prizave të mëtejshme:
- n ° 1 pikat e prizave jashte murit
- n ° 1 pikat e prizave brenda murit

2.7.5 Tipologjia

Kabllot horizontal do te instalohen ne nje tipologji yll, ku cdo prize pune do jete e lidhur nepermjet kabllit te shtrire ne menyre horizontale nga centrali telefonik (kabineti)
Gjithashtu shtrirja e kabllit vertikal do behet me ane te tipologjise yll, ku do lidhet me Rackun e cdo kati.

- Kabllo bakri dyfijesh me shume perdredhje.
- Racku kryesor i lidhjes prane sistemit te centralit te telefonise.

Kabllot do te shtrihen vertikalisht ne shaft ne tuba te mbyllur te montuara ne mur, ne kanalina metalike horizontale ne tavan te varur, ne tavan normal, ne tuba fleksibel te mbyllur te cilet montohen ne siperfaqe brenda dhomave te destinuara per zyra.
Ne dhoma teknike do te instalohen minimumi 1 Rack (si rregull 2 Rack-e).
Secili Rrack 19" perbehet prej celiku, i gjithi i mbyllur, te lyer me boje dhe te pajisur me dere (pergatitur prej cilindri, cylinder i tipit landlord) me moduli prize schuko te integruar.
Ne panelet te pajisur me bashkues (RJ45, Cat5 UTP, 68B) per kabllo bakri te centralit te telefonise.

Cdo post pune do te pajiset me nje dalje prize (RJ45, Cat 6e FTP, 68B) nje perdoret per kompjuter dhe tjetra per telefoni.
Seciles dhome do ti shtohet nje kuti prizash (RJ45, Cat 6e FTP, 68B) per te shtuar nje telefon ose pajisje te tjera ne dhome.

2.8 Sistemi i transmetimit te te dhenave

Eshte parashikuar nje sistem transmetimi te dhenash, kategoria 6, me karakteristikat e meposhtme.
Kabllimi i sherbimit te IT duhet te perputhet me rregulloren EN 50174 klasa E. Secili kabell duhet te jete tip FTP cat 5e per instalime te brendshme. I gjithe sistemi kabllor duhet te matet pas instalimit. Raportet e shkruara duhet ti dorezohen klientit pas punes per ti treguar rezultatet.
Ne pergjithesi te gjitha postet e punes jane te pajisure me nje prize RJ45 cat 5. furnizimi do behet me nje linje FTP cat6 bazuar ne sistemin e struktures se kabllimit. Linjat duhet te lidhen ne cdo fund te gatshme per veprim.Etiketimi duhet te behen nga te dyja anet. Per secilen dalje, duhet te kete nje dalje ne patch panel. Raku eshte model baze i prodhuar nga fabrika me komponente perkates: dere e perparme me pamje sigurie 3mm dhe celes te pershtatshem te mbyllur, dere celiku flete e gjere 2mm nga mbrapa me hapje 130°.
Dimensione te peraferta jane 2200x600x600mm dhe eshte i pajisur me patch fuqie 220V, e priza universale schuko 10A dhe automat 2 polar 16 A.

2.8.1 Pajisjet per transmetimin e te dhenave te Serverit Kryesore

Sistemi i transmetimit te te dhenave duhet te nise nga serveri kryesore (BD), sic e pershkruam me lart edhe per sistemin telefonik. Pervec moduleve qe vertetuam per linjen telefonike,ajo duhet te jete e pajisur me komponentet e meposhtem per te dhenat e transmetimit:

- Module te testuara te sinjaleve komnjuterike te perdoruesve te sinjalitte transmetimit te te dhenave
- SWITCH interneti me 24 dalje RJ45 Cat. 6E
- Modul prizash(dalje) per furnizimin e pajisjeve aktive
- Ventilator ftohes
- Pajisje instalimi dhe kabllo rrjeti

2.8.2 Daljet e prizave te transmetimit te te dhenave

Ne pikat e tregura ne vizatimet e projektit elektrik, duhet te realizohen daljet e prizave te transmetimit data e pajisur me prize RJ45, te cilat komunikojne te gjitha me serverin kryesor duke perdorur kabell S-FTP 4x2x0, Cat. 6E me veshje LS0H.

Per daljet e prizave te transmetimit te te dhenave eshte dhene procedura e ndjekjes se veprimeve.

- Pikat e prizave brenda murit jane te lidhura me kutinë me ane te kanalinave te shpërndarjes dytesore elektrike për rrymat TU përmes tubave pvc RK1, me diametër 20 mm.
- Pikat e prizave jashte murit jane te lidhura me kutinë me ane te kanalinave te shpërndarjes dytesore elektrike për rrymat TU përmes tubave pvc RK1, me diametër 20 mm IP44 min.

2.8.3 Shenimet e pergjithsme ne daljet e prizave te transmetimit te te dhenave

Pozicioni i instalimeve te daljeve te prizave qe tregohen ne vizatimet bashkengjitur duhet te konsiderohen thjesht vetem si nje tregues. Pozicioni final do te vendoset gjate zbatimit te punimeve ne baze te mobilimit dhe informacionit te dhene nga drejtuesit e punimeve.
Pervec pikave te treguar ne vizatimet e projektit bashkengjitur, Kontraktuesi duhet te siguroje pervec daljeve te prizave edhe pikat e meposhtme:

- n.°1 daljet e dukshme te prizave
- n.°1 daljet e padukshme ne mure te prizave.

Ne fund te zbatimit te punimeve, Kontraktori duhet te testoje cdo dalje prize te transmetimit te te dhenave, duke leshuar nje Certifikate te sistemit ne Kategorine 6E

2.9 Sistemi i alarmit te zjarrit

Puna e përshkruar ne kete kapitull përfshin instalimin e sistemit të alarmit të zjarrit me pulsante manuale, detektorë tymi dhe optik si dhe sirena akustike.
Materialet dhe komponentet e nevojshme duhet të jenë në përputhje me rregulloret e Shqipërisë dhe kodeve të punes.

2.9.1 Ekzekutimi

Transmetimi alarmit te zjarrit kryehet me anë të sirenave te alarmit.

Paneli lajmërues
Paneli lajmërues do te instalohet para hyrjes kryesore. Ky panel do te mund që të për-doret edhe për zgjerimin e sistemit.

2.9.2 Paisjet e alarmit

Pulsantet manual do te montohen 1.4 m mbi dyshemen e perfunduar. Ata do te jene me ngjyrë të kuqe dhe të etiketuar në anglisht.
Instalimi i tyre do të behet i jashtem.
Dedektoret optik te tymit dhe detektorët e temperatures do te jene detektorë automatike.
produktet

2.9.3 Central kontrolli dhe menaxhimi i zjarrit

- Inteligjent i adresueshem ,
- Maksimumi dy mikromodule,
- Maksimumi me dy module loop-i me bus analog,
- Me rezistence loop-i vepruese ne qark te shkurter dhe qark te hapur,
- Instalim loop-i me kabell I-Y(ST)Y 0.8 mm per gjatesi maksimale deri ne 3,5km, deri ne 127 pajisje(detektore zjarri, butona manuale) / me zona detektimi per cdo loop.
- Deri ne transpondera ne bus per cdo lup / veprim me komponente te pakablluar,
- Lidhje me mbikqyrjen grafike nepermjet nje WINMAG nderqafesi (SEI),
- Panel veprues me pamje alfanumerike, LCD 4x40,
- Me memorje per me shume se 10,000 ngjarje,
- Nderfaqes printeri per printer te brendshem,
- Dy bateri me qark monitorues,
- Hyrje te monitoruar per per njesi furnizimi te jashtme
- Furnizim BUS, i sinkronizuar ne kontroll, akustik, pajisje sinjalizuese alarmi si ne DIN EN 54-3 me ton alarmi si ne DIN 33404. Me certifikate VDS

2.9.4 Detektor multisensor

Multi-sensor optik dhe temperature i integruar. Pjesa matese optike eshte e perber me nje sensor te ri te perparuar ne teknologji, duke mundesuar detektimin e zjarrit te hapur, zjarrit qe sapo ka nisur dhe zjarr me nxehtesi te larte. Vecanerishtper zjarr te hapur, teknologjia klasike e jonizimit e implementuar ne detektor jonik eshte zevendesuar me teknologjine e re te detektimit. Detektori eshte i gatshem te identifikoje testet e zjarrit TF1 dhe TF6 te pershkruara ne specifikimet
EN 54-9:1982. Multisensori eshte detektor inteligjent me
- analize sinjalizuese te lidhur me kohen
- sinjal te lidhur me te dhenat e sensorit
- inteligjence te decentralizuar,
- funksion automatik me test te brendshem,
- menyre deshtimi te CPU,
- pershtatje automatike me kushtet mjedisore
- me memorje te dhenash per alarm dhe veprim,
- me tregues alarmi dhe program te adresueshem.

Ne ngjyre te bardhe, e ngjashme me RAL 9010. Detektori eshte i pajisur me izolator te integruar dhe nje tregues paralel detektori mund te lidhet me te. Me certifikate VDS

2.9.5 Sinjalizator tregues per detektore

Pjesa e kuqe eshte qe aktivizohet ne vazhdimesi ose te pulsoje me ndricim nga 3 lloje LED. Ne ngjyre te kuqe. Me certifikate VDS

2.9.6 Sirene e brendshme alarmi per centralin e zjarrit

Pershkrimi : Transmetuesi i alarmit ofron nje perzgjedhje me 32 alarme te perfshira ne alarme e specifikimeve DIN si dhe alarme te ndryshme sipas vendit perkates.
Konfigurimi behet me ane te nje celesi me 5 pin DIL. Me shume se dy alarme mund te aktivizohen.
Dizajn i sheshte; Aplikohet me 12 dhe 24 V ne tension veprues; me rregullator alarmi; me rregullator volumi nga pajisja.
Te dhena teknike:
Tension veprues 18-28 V DC
Rryma e alarmit ne 12V DC rreth 3mA
Rryma e alarmit ne 24V DC rreth 5mA
Nivel zeri ne 24V DC 103dB(A)
Temperatura e ambientit -25 °C ... 70 °C
Tipi i mbrojtjes IP 54 dhe IP 65
Mbulese ABS VO
Ne ngjyre te bardhe, e ngjashme me RAL 9010
PErmasat Ø: 93 mm H: 63 mmØ: 93 mm H: 91 mm (duke pershire bazen)
Aksesoret: pllake IP 65 e kuqe
Me certifikate VDS

2.9.7 Sirene e jashtme

Pajisje sinjalizuese alarmi IP65. Me baze IP65 te adresueshme, e furnizuar totalisht me bas dhe pajisje sinjalizuese alrmi me rezistence qark te shkurter ose te mbyllur ne perputhje me EN 54-3 me me shume se 20 alarme te ndryshme duke perfshire alarmet e DIN ne perputhje me DIN 33404 Pjesa 3 per sinjalet e alrmit optik dhe akustik.Volumi mund te rregullohet ne 8 nivele te ndryshme. Dizajni i sheshte i pllakes mbeshtetese pershtatet me ambientin ku instalohet. Eshte e perber nga plastike rezistene ndaj thyerjeve ose plasaritjeve. Zakonisht, bazat e sirenes duhet te kene vend per te hyre kablli anash dhe mbrojtje nga koha (IP65) mund te instalohen, ne ngjyre te kuqe. Me certifikate VDS

2.9.8 Buton alarmi

Modul elektronik i adresueshem i pershtatshem per perdorim bus dhe ne lup per centralin e zjarrit. Lidhje opsionale per MCP konvencionale. Pa lidhje BUS, detektori operon si MCP konvencional. E ndertuar ne lup te izoluar me buton thirrje manuale. Ne ngjyre te kuqe. Me certifikate VDS, CNBOP.

2.9.9 Kontakt elektromagnetik

Per hapjen e deres ne rast alarmi 24 V E liron nga vendi i mbyllur deren me ane te nje butoni te nryshueshem ne te majte ose ne te djathe.Kablli mund te montohet nga mbrapa pajisjes ose nepermjet bazes nga e majta ose e djathta duke perfshire tubin mbrojtes. Ne kombinim me pllaken e montuar ne kend pajisja mund te instalohet ne dysheme ose ne mur. Mbrojtje e polarizuar e kthyeshme e integruar. E testuar ne perputhje me EN1155.

2.9.10 Kombinator Telefonik

Eshte nje telekomande thirrese GSM. Kontrollon 5 linja te ndryshme te konfiguruara ne shume drejtime si hyrje dhe dalje. Pasi ka kontrolluar ambientin dalja mund te menaxhohet nga nje thirrje telefonike, mesazh i shkruar ose mesazh zanorme njohje te thirresit. Numrat jane te lirshem ti shtohen thirrjeve,SMS, protokolleve dixhitale Kontakt ID. 5 terminale qe mund te programohen si hyrje dhe/ose dalje, 8 numra telefonike qe mund ti shtohen per te lajmeruar ngjarjen dhe te tjera gjera. Ne ngjyre te kuqe. Me certifikate VDS, CNBOP.

2.9.11 Instalimi

Të gjitha kabllot do te instalohen në tuba te forte (si dhe ne kanalina). Kapaket e kutive te instalimit si dhe te kutive te bashkimit duhet të jetë me ngjyrë të kuqe.
Instalimi i sistemit te zjarrit është i ndarë nga instalimi i energjisë elektrike. Kabllot e zjarrit duhet të etiketohen në skajet e tyre për tu identifikuar qartë se jane kabllo te alarmit zjarrit.

Eshte parashikuar te realizohet nje sistem sinjalizimi zjarri sipas standardit ICE UNI 979 me këto karakteristika të përgjithshme:

Ndërtesa do te kete te instaluar nje central te programueshem elektronik analog te dedektimit te zjarrit (sipas normës EN 4-2) komplet kompatibel (per te dyja, si për tipologjinë e komunikimit dhe të përdorimit ashtu dhe per ndërfaqen e programimit) me njësine ekzistuese në dhomën e mbikëqyrjes të qendrës spitalore.
Centrali i ri i zjarrit duhet të jete i afte te beje kontrollin e 16 loopeve analogjike te shpërndarë neper godine.
Centrali i ri i zjarrit duhet të jetë i pajisur me ndërfaqes RS-232 serial dhe RS-48 per tu lidhjur me qendrën e mbikqyrjes se alarmeve te zjarrit. Vendndodhja e saj është treguar në vizatimet e projektit.
Centrali i zjarrit duhet të jetë në gjendje te kryeje funksionet e mëposhtme:
- Vleresimin e gjendjes se dedektorit
- Vlefshmerine e te dhenave qe lexon
- Perpunimin e ndryshimit te gjendjeve
- Zbulimin lokal dhe menaxhimin e alarmeve dhe anomalive
- Vetë-diagnostikimin e brendshem nga monitorimi

- Adresimin dhe individualitetin e çdo detektori
- Alarmet dhe / ose anomalit, komunikimin me pajisjet në nivelin e sipërm
- Vleresimin e sinjaleve ne menyre te dyfishe ne nivelin e siperm te komandes ose pas perpunimit lokal
- Testet automatike dhe manuale te funksionalitetit te detektorëve

Mesazhet që, pas kerkeses, do të dërgohen nga cdo pajisje në centralin e alarmit te zjarrit janë:

- Nuk ka ndryshim gjendje
- Ndryshim i gjendjes se : nje dedektori te vetem, zonave (hyrese dhe dalese), pajisjeve te ushqimit me informacion në lidhje me kriteret e alarmit, dështimet, riformatim etj.
- Humbja e komunikimit midis centralit kryesor dhe centraleve lokale.
- Mesazhet e diagnostikuara si: ristart periferik, humbja e konfigurimit, dështimi i orës, shume alarme ne te njejten kohe etj.

Njësia duhet të jetë në gjendje të përmbajë: grupin elektronik te furnizimit, bateri emergjente dhe pajijset e karikimit qe kontrollojne nivelin e karikimit dhe bejne rregullim e tensionit të baterive në varësi të temperaturës.

2.9.12 Qendra e kontrollit te alarmit te zjarrit

Centrali i sistemit te detektimit te zjarrit do te instalohet ambjentitn e monitorimit dhe do te , e perbehet nga:

- Kompjuteri Personal INTEL Pentium IV - HD 120MB - RAM 12MB -ETHERNET card 100/1000 (konfigurim minimal) i pajisur me karta ndërfaqe për kyçje në rrjetin LonWorks
- Printeri
- Monitor 17 "

PC i qendrës së mbikëqyrjes se alarmit te zjarrit duhet të jenë i pajisur me software të mirëmbajtjes dhe ruajtjes te të gjitha alarmeve te regjistruara nga njësitë e dedektimit të zjarrit në ndërtesë.

Ky program duhet të shfaqe gjendjen e dedektorit në hartat videografike në shumë nivele dhe duhet te ruaje historinë e ngjarjeve nëpërmjet tabelave.

Nëpërmjet mirëmbajtjes se softwerit te sistemit te dedektimit të zjarrit, do të jetë e mundur qe, me një ndërfaqe të thjeshtë grafike, te realizohen të gjitha kontrollet ne zonat e dedektimit te zjarrit.

2.9.13 Paneli i perseritjes se alarmit

Paneli përsëritjes se alarmit do te instalohet ne cdo kat tek te gjitha dhomat e infermierise. Gjithashtu ne dhomat e infermierise eshte parashikuar nje ekran i cili ne rast zjarri do te japi sinjal digjital alfanumerike dhe sinjal akustik. Sistemi i dedektimit të zjarrit është i pajisur me bateri me autonomi prej 24 orësh për funksionalitetin e plotë të tij (24 orë sistemi i zbulimit të zjarrit dhe ai i kontrollit te dritareve qe hapen dhe mbylljen per nxjerrjen jasht te tymit per

te pakten 1 ore). Sistemi qendror duhet të jetë i zgjerueshem dhe te mbuloje të gjithë ndërtesën.

2.9.14 Detektoret, butonat dhe relete

Detektorët optik te tymit (te adresueshem) do te instalohen ne çdo dhomë, me përjashtim të banjove. Ato duhet të instalohen në tavan, me efekt Tyndall në bazën e tyre.
Pozicioni dhe numri i detektorëve duhet te jete i tille qe sistemi të jetë në gjendje të mbuloje te gjithë sipërfaqen e zones së mbrojtur.
Treguesi i alarmeve në njësine qendrore duhet të jete ne gjendje të identifikoje saktësisht dhomën ose pikën e veçantë ku ndodh alarmi.

Ky funksionim duhet të realizohet nëpërmjet detektorëve analogjik, te cilet jane te aftë qe te tregojne me përpikmeri cdo alarm zjarri në cdo rast.
Në nje zone të pajisur me shume pulsante alarmi zjarri, duhet të sigurohet moduli i adresuar për keto pulsante.
Në nje zone te paisur vetem me nje pulsant per alarm zjarri, duhet të sigurohet moduli i adreses per kete pulsant.

Detektorët e tymit duhet të instalohen në ambientet e mëposhtme:
- Ne fillimin e cdo kanali ajri.
- Në tavanin e çdo ashensori.
- Në pikën më të lartë të cdo shafti elektrik dhe shafti te sistemeve te tjera.

Për çdo kat duhet të sigurohet një modul kontrolli për secilin nga veprimet e mëposhtme:
- Lirimin e dyerve qe mbahen me magnet në qoftë se marrin komande nga centrali i zjarrit.
- Lirimin e mbajtesave te damperave te zjarrit.
- Venjen ne pune te filtrave te ventilimit.
- Veprimin e sirenave.

Këto module të kontrollit duhet të aktivizojne kontaktoret e instaluar prane kontakteve magnetike 24V te dyerve REI.
Në mes të çdo njesie te trajtimit te ajrit dhe portave përkatëse duhet të sigurohet një modul kontrolli për hapjen me rrotullim ne celesin kryesor të çdo UTA ne Bordin e tij.
Për çdo porte zjarrshuese duhet të sigurohet një modul i adresueshem i cili duhet të jetë i lidhur me mikro-çelesin për të sinjalizuar gjendjen e qepenave, portave në ekranin e centralit të zjarrit. Sinjalizimi ne ekran duhet te tregoje gjendjen e portave hapur / mbyllur.
Të gjithe detektorët e tymit, detektorët termike, modulet e adreses dhe modulet e kontrollit duhet të lidhet me centralin e zjarrit me anë të loope-ve analogjike me kabell 2x1mm2 i perdredhur dhe i skermuar, i cili shtrihet në kanale te përcaktuara dhe tubacione te predispozuara për sistemet CD. Kabllot e paisjeve te alarmit dhe paisjeve qe nxjerrin tymin nga dritaret duhet të durojne zjarrin për 90 minuta, gjithashtu dhe komponentet e tjere te nevojshem per instalimin e kabllove te zjarrit (Kapeset, morsetat etj) duhet ta durojne zjarrin per 90 minuta. Ne disa raste kabllot instalohen minimumi 2cm nen suvan e murit (për

shembull ne instalimet vertikale, në shkallë apo në shafte). Nuk lejohet për të instaluar kabllot e zjarrit poshtë sistemeve, komponentëve, pajisjeve te kabllove etj të cilat kanë një rezistencë të ulët se kabllot zjarrit. Nëse kabllot e zjarrit do të jetë te instaluar jashte murit vertikal, te gjithe kabllot duhet të fiksohen cdo 30 cm (me fasheta) ne menyre qe mos te krijojne dredha. (Masa sigurie qe kabujt te mos varen). Ngjyra e kabllove te zjarrit duhet të jetë e kuqe dhe instalimi i tyre eshte i ndare nga instalimet e tjera. Lidhja duhet te jete ne seri.
Sistemi i dedektimit të zjarrit duhet të kete nje software i cili eshte i nevojshm për funksionimin e sistemit dhe per nderhyrjet e korrekte te releve.

Magnetet mbajtes per dyert REI dhe relete per hapjen e dritareve.

Në pikat e treguara në vizatimet e projektit bashkangjitur, duhet te sigurohet furnizimi i dyerve antizjarr Rei bashke me modulin e aktivizimit te tyre.

Këto magnete mbajtes dhe relete për hapjen e dritareve duhet të furnizohen nga percjelles 2x4 + T direkt nga nga blloku i ushqimit 24V i dedikuar per Dyert REI. Ky bllok ushqimi duhet të jetë i pajisur me një burim ushqimi 24Vcc për të garantuar një furnizim normal dhe te vazhdueshëm te magneteve, madje edhe në rast të mungesës së furnizimit nga gjeneratori (për shkak të kohës së ndërhyrjes se gjeneratorit elektrik ne rrjet).

Pozicionet e instalimit te elementeve të sistemit të dedektimit të zjarrit tregohen në vizatimet e projektit.

Mbrojtja nga zjarri

Të gjitha rruget inkaso te kalimit (muret dhe dyshemete/tavanet) ku jane shtrire kabllot dhe linjat duhet të jenë të mbyllura për të siguruar mbrojtjen nga zjarri dhe parandalimin e zhurmës në përputhje me rregulloret.
Ne të gjitha rastet ku kemi shtirje te kallove te zjarrit përmes mureve, kanalet duhet të mbyllet me izolues F90 në përputhje me rregulloret. Hapesira rezerve per instalimet gjithashtu duhet të jenë në përputhje me rregulloret.

Instalimi i kabllove te zjarrit brenda shafteve të disiplinave të tjera nuk lejohet.

Materialet dhe përbërësit e sistemit te zjarrit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Shqipërisë dhe kodet e punes.

Ofertuesi është i detyruar të paraqesë verifikimet zyrtare për marrjen e masave të mbrojtjes nga zjarri të ofruara prej tij. Verifikimet zyrtare mund të jenë:
- Certifikata Testimesh
- Certifikata produktesh dhe
- Aprovimin nga supervizori

Duhet të sigurohet nga kontraktuesi që ndarja e ambienteve te mrojtura nga zjarri eshte realizuar ne perputhshmeri me vendimet e miratimit të prodhuesit te zgjedhur.

Nëse nuk është e mundur që kontraktori të realizoje ndarjen e zonave siç duhet, një kompani përkatëse e specializuar per kete pune duhet te pershihet për zbatimin ose krijimin e kompartimenteve te zjarrit.

Kontraktori duhet të llogarise qe nje zjarr me fuqi prej 7 kWh / m² eshte i parandaluar ne rrugekalimet e kabllove dhe shtrirjet e linjave ne rruget e evakuimit. Nëse linjat kabllore janë të shtrira nëpër korridore ose në qoftë se linjat kabllore shtrihen ne më shumë se 2 zona te zjarrit, atehere masat përkatëse duhet të merren në koordinim me mbikëqyresin e punimeve. Kontraktori duhet të mbulojë shpenzimet me kursin e duhur për ndryshimin e rrugekalimeve në rast se do te jete e nevojshme për të bere te mundur realizimin e instalimeve sipas kritereve te mesiperme.

2.10 Sistemi i thirrjes se infermieres

2.10.1 Sistemi i thirrjes nga dhomat e pacienteve dhe banjot per invalidet

Qe te realizohet një sistem i thirrjes se infermieres duhet qe kur shypim butonin ne mur ose butonin qe ndodhet tek koka e krevatit ose butonin me litar qe ndodhet ne banjo, sistemi duhet të transmetoje sinjalet e mëposhtme:
- Sinjalizimin e thirrjes ne dhomat e infermieres per cdo repart. Sinjali do të realizohet me një alarm akustik dhe në panelin alfanumerik te centralit do te shfaqet numri i dhomes/banjos.
- Llamba e sinjalit ne koridor ka 3 gjendje, llambë thirrje, llambë e qetë, dhe llambë kur ka infermiere brenda.
- Sinjali optik akustik qe bie ne centralin brenda dhomës se infermierise, caktivizohet nga infermierja kur shkon ne dhomen e pacientit dhe aktivizohet llamba e qetë. Në çdo central thirrje duhet të transmetohet sinjali akustik dhe gjendja e llambave per te gjitha dhomat pavarsisht nese tek ai central nuk ka thirrje.

Një sistem thirrje me dritë do te instalohet në ambjentet e dhomave te shtrimi të çdo departamenti per komunikim nga dhoma e pacientit dhe blloku sanitar qe ndodhet aty. Thirrja do te transmetohet në stacionin qendrore (Nurse Station / Mbikqyrjes) në të njëjtin nivel. Komunikimi i realizuar vetem nepermjet drites nuk eshte menduar si zgjidhje.
Dhoma qe therret shfaqet ne central ne forme teksti ose me numrin e dhomes ne ekran. Drita e dhomes siper deres gjithashtu aktivizohet ne te njejten kohe kur eshte bere thirrja.

Në qoftë se një infermiere është në një dhomë te caktuar, ajo do të shtypni butonin që tregon se ajo është e pranishme në këtë dhomë. Thirrjet nga dhomat e tjera me pas do te ransmetohen atje.

Prania e infermieres dhe thirrja e pacientit duhet të pasqyrohen ne dritën e dhomës me ngjyra të ndryshme. Komunikimi midis reparteve nuk eshte parashikuar.

Butonat e thirrjes do të vendosen në çdo shtrat pacienti dhe në blloqet sanitare. Një thirrje nga WC mund të fshihet vetëm brenda bllokut sanitare. Nje thirrje e pacientit gjithashtu mund te shkaktohet duke terhequr litarin e butonit te thirrjes.
Butona te tjere te thirrjes do te vendosen në banjot e pacienteve dhe WC per invalitet. Thirrjet nga atje (tualetet normal dhe tualetet e invaliteve) do të dërgohet ne dhomen e infermiereve te atij sektori.

Te gjitha ngjarjet qe ndodhin ne sistem duhet të regjistrohen, te ruhen si dhe te vlereso-hen kur te kërkohet. I gjithe sistemi do të furnizohet me energji elektrike me tension 24V, i cili është buffer me një bateri qe siguron energjine ne rast se nderpritet energjia nga rrjeti. Bateria duhet të llogaritet per të paktën 1 ore autonomi ne pune normale te sistemit. Defektet qe mund te ndodhin në sistem do të zbulohen automatikisht dhe do të dërgohen ne stacionin qendror.

Te gjithe kabllot dhe linjat e rrjetit te thirrjes jane perfshire ne instalim.
Pergatitja e sistemit, futja e te dhenave, dhe konfigurimi i tij do te behet nga kontraktori para komisionimit.
Sistemi i thirrjese se ndihmes me drite do te instalohet komplet ne gjendje pune sipas kritereve teknike te vendit perkates.

2.11 Tokezimi, rrjeti ekuipotencial, rrufepritesi

2.11.1 Tokezimi dhe rrjeti ekuipotencial

Për parandalimin e krijimit te ngarkesave elektike dhe krijimin e një potenciali elektrik te njejte, të gjitha sipërfaqet e mëdha metalike janë të lidhura midis tyre.

Materialet dhe komponentët

Si materialet dhe komponentet qe do te perdoren, ashtu dhe sistemi ekuipotencial në impiantet e ngrohjes, ujit, ventilimi ne dhomat teknike, duhet të jenë në përputhje me rregullat e fundit të Shqipërisë dhe kodeve të punes.

Ekzekutimi

Të gjithe tubat metalike, qofshin ato te uijt të ftohte, ujrave të zeza, ngrohjes, gazit, vakumit dhe çdo sipërfaqe e mëdhe metalike të cilat janë përgjegjës për mbartjen e ngarkesave elektrostatike, të tilla si tavolina pune, kolona te shkarkimit te gazit, pajisje mjekësore, kabinete metalike, prizat ekuipotenciale, etj janë përfshirë në sistemin ekuipotencial. Të gjitha pajisjet dhe trasete janë të lidhura në mënyrë individuale me një tel tokezimi (4 mm^2 bakri ngjyre verdhë / jeshil) qe ben komunikimin me zbaren ekuipotenciale.

Në çdo dhomë të trajtimit jane të paktën 2 priza ekuipotenciale, keto priza ekuipotenciale jane instaluar per tu sherbyer paisjeve mjekesore portabel qe mund te perdoren ne dhome.

Prizat ekuipotenciale për pajisjet portative mjekesore janë të dizajnuara në mënyrë te tille që telat lidhës të përfundojë në një kuti te fshehur shperndarese (zakonisht pas dere) ku ne kuti bashkohen te gjithe ne nje pike.

Zbarat ekuipotenciale janë instaluar në dhomat qendrore teknike. Me keto zbara me ane te telave ekuipotencial eshte i lidhur : themeli i nderteses (me shirit çeliku 30 x 3), sistemi i tubacioneve dhe kanalet e ventilimit. Tubat individuale të sistemeve të ngrohjes, vakumit, ajrit të ngjeshur dhe ujit janë të lidhura së bashku përmes zbarrave ekuipotenciale.
Edhe kanalet e ventilimit janë të lidhura gjithashtu së bashku dhe bashkohen me këto zbara me percjellesin e tokes.
Sistemet e antenave telefonike bashkohen me këto zbara me tel verdhe/jeshil me seksion 16 mm^2.
Per realizim e ketyre lidhjeve te sistemit ekuipotencial me token jane perdorur morseta ose saldime te cilat sigurojne nje lidhje te qendrueshme, dhe te mbrojtur nga korrozioni.

Kabllot ekuipotencial duhet te shtrihen te panderprere nga zbarra ekuipotenciale deri në nje pikë të veçantë te lidhjes, dhe duhet te jene vetem me nje ngjyre verdhë / jeshile.
Të gjithe percjellesit nga zbarrat ekuipotenciale duhet të jenë individualisht te ndashëm dhe te qarte, ne menyre permanente dhe te sigurte te tregojne linjat perkatese.

Edhe shirita zinku te galvanizuar 30 x 3 mm jane parashikuar paralel me kabllot e furnizimit, pervec atyre qe jane lidhur me shiritat e tokezimit te themeleve.

2.11.2 Rrjeti i tokezimit, TM/TU kabina e transformatorit elektrik dhe gjeneratori elektrik

Brenda ambjentit teknik te kabines elektrike TM / TU,eshte realizua nje kolektor ekuipotencial prej bakri i fiksuar me kapese ne mur. Ai duhet gjithashtu te lidhet nepermjet morsetave me rrjetin e tokezimit dhe ate ekuipotencial me percjelles te zhveshur bakri ose me percjelles N07V/K, ngjyra Y / G si me poshte:

REF.	PERSHKRIMI	TIPI(1)	N°xSEKSIONI (mm2)
1	Elektrode tokezimi	EC	2 x 50
2	Kuadri kryesor i tensionit	EQP	2 x 50
3	Kornize transformatori TM/TU	EQP	2 x 50
4	TM/TU Ylli i transformatorit	PE	2 x 240
5	Zbare ekuipotenciale GLVB-EN, EC	PE	2 x 240
6	Zbara ekuipotenciale GLVB-ES15	PE	2 x 240
7	Ylli i peshtjellave te Gjeneratorit	PE	2 x 240
8	Paneli i Kontrollit te Gjeneratorit elektrik	PE	2 x 240
9	Depozita e Naftes te Gjeneratorit elektrik	EQP	1 x 25
10	Kuadri elektrik fiks	EQP	10 x 25
11	Kanalinat metalike qe dalin nga Paneli	EQP	10 x 25
12	Struktura metalike e dyshemese teknologjike	EQP	4 x 25
13	Struktura metalike e themeleve te betonit te godines	EC	2 x 50
14	Kablli ekuipotencial for Sistemin hidraulik te mbrojtjes nga zjarri	EC	1 x 50
15	Kablli ekuipotencial Sistemin e furnizimit me uje te ngrohte	EC	1 x 50
16	Kablli ekuipotencial Kaldajat	EC	1 x 50
17	Shinat e ashensorit	EQP	2 x 50
18	Panelet elektrike te vecante te TU seksioni EN-ES0	PE	1 x 95
19	UPS seksioni ES0,5	PE	1 x 95
20	UPS seksioni ES0	PE	1 x 95
21	Shinat e ashensorit per njerez/krevate 1/2	EQP	1 x 25
22	Tubacionet e gazit mjekesor	EQP	1 x 25
23	Tubacionet e oksigjenit	EQP	1 x 25

24	Tubacionet e Peroksidit	EQP	1 x 25
25	Tubacionet e ajrit	EQP	1 x 25
26	Tubacionet e ujit te ngrohte sanitar	EQP	1 x 25
27	Tubacionet e ujit te ftohte sanitar	EQP	1 x 25
28	Tubacionet e ujit te ngrohte CDZ	EQP	1 x 25
29	Tubacionet e ujit te ftohte CDZ	EQP	1 x 25
30	Kanalinat dhe struktura e kabllimit duke filluar nga Dhoma e TU te godines.	EQP	1 x 50
31	Kablli kryesor i lidhjes ekuipotenciale te zbares se UTA	EC	1 x 50
32	Kablli ekuipotencial i zbares se repartit te radiologjise	EC	1 x 50
33	Kablli ekuipotencial i reparteve te thjeshta/qendrim i shkurter ne spital/ne vezhgim	EC	1 x 50
34	Kablli ekuipotencial i dhomave te ekzaminimit	EC	1 x 50
35	Kablli ekuipotencial i repartit te pergjithshem te shtrimit ne spital	EC	1 x 50
36	Kablli ekuipotencial i repartit te kujdesit intensiv	EC	1 x 50
37	Kablli ekuipotencial i ambjenteve te hidroterapis	EC	1 x 50

Shenim:
(1)EC = PERCJELLESI I TOKES
EQP = PERCJELLESI I EKUIPOTENCIAL
PE = PERCJELLESI I MBROJTJES

Percjellesi ekuipotencial i panelit duhet të vendoset në nje pozicion të dukshem dhe të lehtë për tu arritur.
Skerma elektrostatike e telave te TM duhet të jetë e lidhur me tokën nepermjet zbares ekuipotenciale te MVB.
Te gjithe përcjellesit PE te qarqeve elektrike të furnizimit, duke filluar nga kabinetet e TM / TU te kabines se transformatorit do te realizohen me percjelles me ngjyre V/J dhe shume polar dhe zbara elektrike dhe do te fillojne nga zbara ekuipotenciale deri tek panelet elektrik specifik.
Të gjithe percjellesit e tokes, si ato ekuipotencial ashtu dhe ato te mbrojtjes, që i përkasin zbarave ekuipotenciale, duhet të jenë në gjendje qe te shkeputuen ne menyre te vecante nga zbara respektive dhe ne terminalet e tyre duhet te vendosen etiketa qe bejne te mundur identifikin e tyre.
Të gjitha dyshemete teknologjike duhet te lidhen në të njëjtin potencial me anë të kapikordave te kabllove N07V/K 2.5 mm2, ngjyre V/J. Qe te realizohet rrjeti ekuipotencial duhet qe zbarat ekuipotenciale te ambientit te lidhet me 2 percjelles (jo 1 percjelles) qe vijne nga anet e kunderta te dhomes. Pra rrjeta ekuipotenciale e dyshemese kapet me zbaren ekuipotenciale ne 2 pika.

2.11.3 Rrjeti ekuipotencial per ambientet teknike teknologjike

Ambientet e mëposhtme teknologjike:

- Plani hidraulik i mbrojtjes nga zjarri
- Ambienti i Ujit te Ngrohte Sanitar
- Ambienti i sistemit te ngrohjes
- Ambienti i Oksigjenit
- Ambienti i Vakumit
- Ambienti i Peroksidit
- Ambienti i Aijrit Mekanik
- Per cdo ambient te mesiperm duhet te kete te pakten nje zbare ekuipotenciale me karakteristika te njejta me ato te zbarave te kabines se transformatorit TM / TU. Per cdo zbare ekuipotenciale do te realizohet lidhja me rrjetin ekuipotencial me percjalles V/J 2.5 mm2 per elementet e meposhtem:
- Tuba metalike qe sherbejne per transportin e lengjeve
- Depozita metalike të gazit mjekësor
- Depozitat e naftes qe sherbejne per sistemin e ngrohjes

2.11.4 Sistemi kryesor i tokezimit per godinen

Percjellesit qe do te perdoren per mbrojtjen e sistemeve elktrike ne ambientet teknike duhet te jene ngjyre V/J dhe shumepolar dhe duhet te kene etiketen qe tregon origjinen (identifikimin se kujt ambienti i sherben) ne zbarat brenda ambienteve teknike.

Në banjot me vaskë dhe/ose dushe duhet të realizohet një lidhje shtesë ekuipotenciale e elementeve të mëposhtem:

Tubat e sistemit të ujit të ngrohte.
Tubat e ujit sanitare

Lidhjet duhet të realizohet me anë të përcjellseve N07V/K, ngjyre V/J dhe seksion 6 mm2, duke filluar nga zbara ekuipotenciale në një kuti shperndarese të instaluar brenda banjos.

Zbarat ekuipotenciale te banjove duhet te lidhen me zbaren ekuipotenciale te zones me te afert nepermjet një percjellesi N07V/K, ngjyrë të V/J dhe me seksion 2.5 mm2. Për çdo dhomë mjekësore që i përket Grupit 1, që jane dhomat e meposhtme:

- Dhome Pacienti

- Dhome vizitash
- Dhomat EKG, EEG, EMG, dhe EHG
- Dhome Endoskopie
- Departamenti i ambulatoreve
- Dhomat e Radiologjise dhe Radioterapise

dhe për çdo dhomë mjekësore që i përket Grupit 2, që jane dhomat e meposhtme:

- Dhoma e Reanimacionit
- Dhoma e Kujdesit Intensive

do te realizohet rrjeti ekuipotencial i dhomave te grupeve te mesiperme, dhe do te lidhen me percjelles N07V/K, ngjyre V/J dhe seksion 6 mm2

REF.	PJESA QE DO TE LIDHET	SHENIM
1	Mburoja metalike e transformatoreve izolues	
2	Rrjeta mbrojtese nga interferenca e valeve elektro-magnetike	
3	Masa te jashtme	Pjeset metalike qe jane brenda dhomes ne lartesine <2m qe paraqesin ne terren nje rezistence <200Ω(per dhomat ne grupin 2 qe paraqesin rrezik)
4	Trupi	Kasetat e fancoil-ve dhe llambat te testaletat
5	Terminali i tokes tek prizat	

Çdo nyje ekuipotenciale duhet të lidhet veçmas ne zbaren ekuipotenciale te dhomes siç tregohet më lart.
Duke filluar nga nyjet ekuipotenciale te dhomave, lidhjet ekuipotencial duhet të vijne direkt per çdo pjesë të vetme të lidhur. Vetëm një nyje e ndërmjetme (sub-node) mund të futet ndermjet trupi dhe pjeses se jashtme, ose ne polin e tokezimit dhe ne zbaren e dhomes, ne menyre qe te siguroje mbrojtje te ndryshme ose qe nje percjelles ekuipotencial te mbuloje nje tjeter. Per shembull, kjo nen-zbare mund te realizohet te llampat e testaletes, prizat e gazit mjekesor, ose grupe prizash.

REALIZIMI I ME SHUME SE NJE NYJE EKUIPOTENCIALE NE TE NJEJTEN DHOME NUK LEJOHET.

Për këtë arsye, është e nevojshme që kutia qe përmban nyjen ekuipotenciale të dimensionohen në vendin ku eshte me e lehte te behen lidhjet e nevojshme dhe te kete mundesi zgjerimi me 30 % qe te perputhet me integrimin e mundshem ne te ardhmen.
Nyja ekuipotenciale duhet të vendoset brenda dhomës, në nje pozicionin të dukshem dhe të arritshem (gjatë kryerjes se punimeve duhet edhe të vlerësohet vendndodhja e mobiljeve ne dhomë). Secila nyje duhet të shënohet me nje numër të qartë serigraph në kopertinën e kapakut te kutise qe përmban kete nyje.
Lidhjet e linjave në nyjen ekuipotenciale duhet të realizohet nëpërmjet kapikordave dhe duhet të jenë në gjendje të shkyçen në mënyrë individuale.
Të gjithe përcjelllesit qe hyjne në një nyje ekuipotenciale duhet të pajisen me etiketat e identifikimit te sakte sipas rregullit te meposhtem:
"n1.n2"
Ku:
n1 = numri i nyjes qe i perket
n2 = numri progresiv i lidhjes ne te njejten nyje

2.11.5 Sistemi i mbrojtjes dhe i shkarkimeve

Ndërtesa do të mbrohet me një sistem rrufepritesi.
Në të gjitha skajet e jashtme te ndërteses do te montohet nje grup shiritash te perbera prej celiku te galvanizuar me permasa 30x3. Ky grup shiritash do të lidhet së bashku për të ndërtuar një mase në majë të ndërtesës (madhesia maksimale 20x10m gjerë).
Tek të gjitha pajisjet metalike, komponentet më të gjatë se 1 m do të jenë te lidhur me sistemin e mbrojtjes se rrufepritesit. Të gjitha objektet më të larta se sipërfaqja e kulmit duhet të jene te mbrojtura tërthortë me shufra vertikale.
Një komponent ka mbrojtje indirekte nese ai eshte brenda një koni me kend 45 ° te shufres ose nje grupi te tere.
Të gjitha pajisjet elektrike në çati, ose komponentet metalike të cilat lidhen me një pajisje elektrike brenda ndërtesës duhet të jetë e lidhur me sistemin e mbrojtjes se rrufepritesit me një shkarkues toke dhe duhet të jenë te mbrojtura ne menyre indirekte.
Lidhja midis rrjetes se rrufepritesit ne tarrace dhe stokes do te realizohet nepermjet zbritjeve vertikale (shirit i galvanizuar 30x3 mm) i pozicionuar ne skajet e nderteses sipas vizatimeve, qe perfundojne ne nje unaze te mbyllur rreth 1m larg nderteses.

Sistemi tokezimit do të bëhet nga shirita celiku te galvanizuara 30x3mm te futura ne toke ne nje thellesi minimumi 30cm. Sistemi është ndërtuar ne tipologji yll duke filluar nga shtizat e rrufepritesit. Rrjeti i zbritjeve dhe i tokezimit do te bashkohen 1m mbi nivelin e tokes (ku do te instalohet shkeputesi per matje)
Rezistenca e tokezimit duhet të jetë më e ulët se 4 ohm.
Do te kryhen matjet për të verifikuar rezistencën e nevojshme.

Cdo pajisje metalike qe do te montohet ne afersi prej 2m nga shiritat e zbritjes se rrufeprite-sit do te lidhet me sistemin e tokezimit.

Nje sistem shtese i tokezimit do te instalohet per te realizuar rrjetin ekuipotencial. Ky sistem tokezimi lidhet me shufra bakri ekuipotenciale te ndodhura ne dhomen tensionit e ulet.
Rrjeti ekuipotencial eshte komplet i tipit yll dhe i vecante, pa lidhje me sistemet e tjera te tokezimit.

Komponentët e mëposhtëm duhet të jenë të lidhura me shufren kryesore ekuipotentiale te jashtme
• Ndricimi
• Kuadri kryesor i tensionit te ulet / kuadrot e shperndarjes se tensionit te ulët - Kuadrot elektrike te jashtem metalike me komponente elektrik ne të (për shembull kolektoret e mbledhjes se ujit)
• Shufrat kryesore ekuipotenciale qe jane pranë shaftit te kabllove në pjesën kryesore të ndërtesës dhe të gjitha pjesët e mëdha metalike dhe hapesirat e konstruksioneve jane te pershkruara më siper.

Nga shufra kryesore ekuipotenciale prane shaftit ne te majte kabllot shtrihen njelloj si ne godine
• Kabineti i kabllove te strukturuar
kanalinat metalike te kabllove (të përcaktuara brenda të gjithë gjatësisë) kanalina metalike, tuba, dhe sistemet e HVAC (ngrohjes, ventilimit, ajrit te kondicionuar)
(Furnizimi 10mm2, min lokale. 16mm2)
Mobilje kuzhine (16mm2, 6mm2 lokale)
Konstruksione ne tavan te varur (16mm2, 6mm2 lokale)
portat (10mm2)
dush (6mm2)
Nëse është e nevojshme për të lidhur më shumë se një komponent me kabllot e furnizimit ekuipotencial ne nje zone te caktuar, atehere kontraktori duhet te instaloje shufra shtesë ne ate zone nën-equipotenciale.

Sistemi i mbrojtjes se rrufepritesit është per tu instaluar në ndërtesën e re , duke perdorur si tokezim dhe pjesen metalike te konstruksionit.
Në ndërtese sistemi ekzistues i mbrojtjes se rrufepritesit duhet të rivleresohet në përputhje me rregulloret e Shqipërisë dhe kodit te punes.

Lloji i taraces: tarace e sheshte me zhavorr
Lloji i mbuleses: fletë prej bitumi
Ulluqet dhe spotet e poshtme: Material prej zinku
Komponentet metalike në çati: parapet ne siperfaqe prej alumini te zinkuar, pajisjet e ventilimit qe ndodhen ne tarace, grila, etj.

Llojet e duhura te terrenit/tokes do të merren në konsideratë per tokezimin. Testet e sistemit

te mbrojtjes se tokezimit si dhe vizatimet e kantierit dhe specifikimet do ti dorezohen perdoruesit ne tre kopje.
Do te vendosen shufra çeliku te galvanizuar, me diameter 8 mm, të instaluar si një rrjetë ne tarace të lidhur me morseta, si nje rrjete mbrojtese per shkarkimet atmosferike.

2.11.6 Zbatimi

Rrjeta e shiritave te rrufepritesit do te instalohet ne tarracen e objektit . Hapesirat midis shiritave te rrjetes nuk duhet ta kalojne 1.0m ne cepat e catise dhe 2.0m ne siperfaqen e saj.

Per te lidhur themelin e godines me sistemin e tokezimin e godines do te perdoret nje shirit metali i galavanizuar 30x3mm.
Midis elektrodave te tokezimit dhe shkeputesit per matje, vendoset nje shirit 30 x 3 mm.
Te gjitha lidhjet ne toke duhet të jenë të mbrojtur, anti korrodues.

Perçjellesat e zbritjes, do te jene me diameter Ø 10 mm dhe do të vendosen poshtë fasadës deri në pikat shkepusit per matje.

Nëse nuk mund te arrihet rezistenca e kerkuar si me siper atehere do te shtohet numri i elektrodave. Elektrodat do te futen ne toke ne zonen e pershtatshme me dhe rrotull objektit. Shirita zbrites do te instalohen cdo 20 m dhe deri tek kutia e shkeputesve per matje ku do te lidhen me rrjetin e tokezimit. Elektroda e tokezimit do të jetë gjithashtu e lidhur me këto kuti. Për të shkëputur sistemin e tokezimit nga rrjeti i rrufepritesit, duhet të sigurohet pikë shkëputje per matje. Të gjitha pikat e shkeputjes, do të numërohen me numra plastik rezistent ndaj kushteve klimatike. Identifikimi duhet të jetë në përputhje me planet e godinave.

2.11.7 Mbrojtja kunder goditjeve indirekte te rrufese

Mbrojtja kundër goditjeve indirekte te rrufese, për shkak të mbi-tensionit në linjat elektrike dhe linjat hyrese te sinjaleve që vijnë në strukture, realizohet nëpërmjet instalimit te shkarkuesve te zgjedhur, te cilet duhet te jene te dimensionionuar dhe të vendosur në përputhje me normat e 81-8 te standardit ICE.
Karakteristikat e shkarkuesve të mbi-tensionit të instaluar në panelet elektrike jane projektuar ne perputhje me skemat elektrike.
Në linjat e jashtme te telefonise, te cilat futen ne objekt duhet të jetë i instaluar SDP për cdo linjë telefonike me ISN kA 8 / 20μs.

2.11.8 Te tjera

Çmimet ne njesi te ofruara, duke përfshirë edhe çmimet e lëndëve të para si bakri dhe alumini, janë çmime fikse. Ndryshimet në njoftimin qe jep DEL për elementet e bakrit dhe aluminit nuk janë të njohura dhe për këtë arsye duhet të merren parasysh në llogaritje. Pretendimet e mëtejshme me kete teme nuk do të merren parasysh.

Për arsye të thjeshtësimit, të gjitha shprehjet të tilla si: "Furnizim, komplet asamblimi, vendosje, prodhimi, lidhje të gatshme për punë, mjete, për të siguruar mjetet dhe skela, per të realizuar

masat mbrojtese dhe masat e sigurisë mbrojtëse kuptohen si të dukshme dhe të njohur në tekstin e specifikimeve te shërbimeve.

Implementimi i cdo zeri te identifikuar ne menyre individuale konsiderohet si pune e mbyllur plotesisht dhe sherbim i kryer ne perputhje me rregulloret perkatese.
Në parim, çdo ze/njesi ne specifikimet e shërbimeve përfshin furnizimin, ansamblimin, dhe lidhje të gatshëm për tu futur ne pune (kjo gjithashtu përfshin punën e programimit), si dhe të gjithë sherbimet e tjera, sic jane sherbimet dytesore edhe pse nuk u përmenden vecmas.

Kur behet llogaritja e çmimeve, duhet të kihet parasysh që të gjitha prizat, kutite, percjellesat dhe tubat bosh gjate zbatimit nuk do te konsiderohen vecmas por gjithcka e perfshire ne te.

2.12 Sistemi i lajmerimit zanor

Ne korridoret dhe shkallët e nderteses do te instalohet nje sistem i shperndarjes se zerit qe do te sherbeje per evakuimin dhe do te varet nga njesia qendrore e shperndarjes se zerit, e cila do te instalohet ne dhomen e serverit qe ndodhet ne katin 1 te godines se spitalit.
Ne vecanti ndertesa duhet te pajiset me bokse zeri 6W, te instaluar ne pozicionet e treguara ne vizatim, dhe te lidhur me nje zone te pershtatshme ku do te vendoset njesia qendrore nepermjet kabllove kundrra zjarrit sipas standarteve CEI 20-45, tipi FG10OM1 0.6 / 1kV 2x4 mm2, te shtrire ne kanalinat e rrymave te dobeta.

2.12.1 Kerkesat e pergjithsme

Kërkesat kryesore që duhet të permbushi ky sistem janë:

- Funksionalitet dhe përdorim të lehtë dhe të sigurt
- Pune të vazhdueshme në kohë pa ndërprerje
- Besueshmërinë
- Mundësia e ndërfaqes për sistemet e tjera

Sistemi duhet të jetë i projektuar dhe i strukturuar për të minimizuar avarite e mundshme apo keq-punimet. Kjo do të realizohet me nivelet e nevojshme të vetë-diagnozës për t'iu përgjigjur normës EN 60849 (NEQ 100-55). Përsëri, sipas kësaj norme, ky sistem duhet te mundesoje monitorimin e funksionimit dhe gjendjen e sistemit, ne menyre qe te kontrolloje funksionalitetin e dhe te detektoje nese mund te shfaqen probleme me vone ose te kete keq-funksionim.

Sistemi i shperndarjes se zerit do të lejojë për të dërguar mesazhe me zë zonave të frekuentuara, dhe në cdo dhomë shërbimi te sistemit, përveçse muzikë difuze ose mesazhe automatike alarmi.

Sipas standardit të CEI 100-55 qëllimi kryesor i këtij sistemi do të jetë për të lejuar një evakuim te kontrolluar nga ndërtesa në rast zjarri ose emergjence tjetër. Sistemi do të jetë në gjendje qe të lidhet me njësinë e zjarrfikësve, dhe do të programohet te jetë në gjendje për të transferuar sinjalet e mëposhtme:

- 19 alarme të ndryshme te mundura për t'u zgjedhur gjatë fazës së programimit
- Sinjal alarmi te rregjistruar me perpara
- Mesazh evakuimi te rregjistruar me perpara
- Përparësi absolute mesazheve zanore te drejtperdrejta

Çdo funksion duhet të kryhet nga operatori kryesor (mbikqyresi kryesor i cili ka edhe ekranin dixhital te kontrollit)

Në çdo zonë duhet te jete e mundur (nëse kërkohet) te lidhet nje sistem amplifikimi autonom me kontrollues zeri, CD dhe mikrofoni per shperndarjen lokale te zerit ose muzikes ose mesazheve zanore direkte.

Gjithsesi, sistemi autonom do te varet nga sistemi kryesor persa i perket prioriteteve te menaxhimit ne rast emergjence.

Të gjithe komponentët e përfshire në menaxhimin e sinjaleve emergjente do të kontrollohen dhe monitorohen vazhdimisht nga CPU e sistemit. Ajo duhet të tregojë dështimet e mundshme apo keq-funksionimin e këtyre pajisjeve brenda 100 sekondave nga shfaqja e tyre (siç kërkohet nga norma CEI 100-55). Nepermjet aplikimeve duhet të kontrollohet dhe mbikëqyret integriteti i "rruges kritike". Kjo është menduar si rruga e sinjalit akustik nga kapsula e mikrofonit emergjent dhe / ose gjenerimi i mesazhit në vijën e folësit përmes amplifikatorit: çdo dështim në lidhje me mikrofonin, me kabllot e saj ne lidhje me njësinë qendrore, me amplifikatorin dhe në vijën e folësit duhet të sinjalizohet saktesisht.

Eventualisht, sistemi do të lejojë te kryhet, nëpërmjet folësit, përhapja e sinjaleve te tipologjive të mëposhtme (të listuara sipas një rritje e rendit prioritar):

– Përhapjen e muzikës se ambientit në repartet e kërkuara (niveli i ulët prioritet)

– Te percohet nje mesazh zanor ne nje zone specifike nga nje mikrofon i dedikuar (kur kërkohet)

– Te percaktohet nje mesazh zanor ne nje zone ose grup zonash, në zona te frekuentuara dhe në të gjithë zonat e shërbimit të strukturës;

– Shperndarjen e alarmit automatik dhe / ose mesazheve te sigurise (në nje zonë ose grup zona)

– Thirrje emergjente zanore (ne nje zone ose grup zonash); perdorimin e sinjalit te emergjences (prioritet maksimal)

2.12.2 Arkitekura dhe funksionaliteti

Si një i tërë, sistemi i shperndarjes se zerit do të perbëhet nga:

- Një njësi qendrore për amplifikimin me kontrollues dixhital që ofron kontroll per te gjithe funksionet e sistemit (mund te shtohet deri në 36 zona por e predispozuar për 18 zona)

- Nje njesi kompjuter workstation per mbikqyrjes me kontrool dixhital i lidhur me njesine qendrore

- Sistem autonom amplifikator me tuner, CD dhe mikrofon për muzikë dhe mesazhe lokale

- Nje mikrofon rrjeti për përhapjen e zerit në fusha të ndryshme shërbimi.

Arkitektura e njesise qendrore amplifikuese duhet të bazohet në një sistem modular, fleksibël, dhe te lehtë për tu zgjeruar me mundësinë për të zgjeruar shërbimet, perhapur mesazhet emergjente, dhe të aftë për tu lidhur me njësinë qendrore të detektimit të zjarrit, sipas normës EN 60849 (CEI 100- 55).

Sistemi do të sigurojë përdorimin e nje paneli sinjalesh ku do te jete e mundur te shtohen deri ne maksimumi 20 module. Ne kete panel do te vendosen modulet hyrje/dalje, perzgjedhesit e zonave, linjat e daljes, furnizuesit etj. Ne linjen bus te kartes se pergjithshme do te vazhdoje linja e furnizimit, sinjalet akustike, linja e komunikimit serial, dhe sinjalet e sherbimit (prioritare etj.). Ky panel eshte fiks i vendosur ne shinat e rackut dhe lejon qe te mund te hiqet prej andej dhe te aksesosh te ai pa e hequr plotesisht nga funksioni. Keshtu instalimi dhe mirembajtja e moduleve rezulton jashtëzakonisht e lehtë dhe funksionale. Ne pjesen e perparme te moduleve jane shkruajtur komandat, indikacionet dhe rregullimet e pergjithshme, ndersa nga mbrapa jane prizat lidhese dhe terminalet. Modulet jane lehtesisht te insertueshme ne panel nga pjesa e perparme pa ndonje veprim me kabllo nga brenda panelit ne vetvete.

Sistemi do te lejoje perhapjen e zeri nepemjet bokseve te mesazheve, komunikimeve te sherbimit (mundesisht edhe te alarmeve) brenda zonave te sherbimit, per nje total per 14 zonash shperndarjeje. Gjithsesi, njesia qendrore eshte e predispozuar per 18 zona.

Te gjitha funksionet e sistemit do te kryhen nga mbikeqyrja dhe kontrolli i tastieres. Thirrjet do tju sherbejne 14 zonave te vecanta te linjave te zerit (nje per secilen zone) me mundesine per ti aktivizuar te gjitha sebashku ose per ti ndare ne grupe per sherbime, njoftime ose per te komunikuar per kerkimin e personave dhe per te dhene alarme emergjence te ndryshme. Secila linje zone eshte e lidhur me zonen perkatese te amplifikatorit (numri dhe fuqia e tyre varet nga numri dhe fuqia e bokseve te instaluar ne cdo zone).

Ne varesi nga rrethanat, operatori do te jete ne gjendje te beje nga stacioni i mikrofonit, edhe thirrje te linja perkatese (ose te nje grup linjash), atje ku do te coje mesazhin, dhe nje thirrje te pergjithshme te te gjitha zonat e sistemit.

Mbikqyrja me ane te tastieres do te pajiset me nje mikrofon te kontrollueshem, nje ekran LCD, dhe nje tastiere hekzadecimale per te lejuar te permbushi cdo funksion menaxhimi te

sistemit. Dy module shtese do te shtojne 24 celsa te tastiera ne menyre qe te kryeje thirrje te shpejte dhe te shfaq me ane te nje drite LED gjendjen e zonave te ndryshme.

Nepermjet mbikqyrjes do te jete e mundur:

- Shfaqja e hyrjes se avarive dhe alarmeve me ore/date/minuta

- Te beje thirrje sherbimesh ne secilen zone ose ne nje grup zonash

- Te kontrolloje te gjithe gjendjen e sistemit

Nje celes sigurie do ti lejoje stafit te sigurise:

- Te ristartoje sinjalet e alarmeve te mundshme: kjo ngjarje rregjistrohet ne memorie me date/ore/minute

- Te coje rregjistrime evakuimesh dhe mesazhe alarmi ne zona te vecanta: kjo ngjarje rregjistrohet ne memorie me date/ore/minute

- Te coje mesazhe zanore evakuimi ne kohe reale dhe mesazhe alarmi.

Kur nje avari ndodh, nje sirene afer tastieres do te siguroje nje sinjal akustik i cili eshte i mundur te ristartohet nga tastiera ose nga celesi i sigurise.

Rregjistrimet e evakuimit dhe mesazhet e alarmit do te menaxhohen nga nje modul i kundert. Kjo do te lejoje qe mesazhet te kontrollohen dhe diagnostikohen plotesisht, te pershtatshem per sistemin e evakuimit, konform normave EN 60849 (CEI 100-55). Ne rast rreziku, do te jete e mundur te riprodhohen dy mesazhe ne dy zona te ndryshme ne te njejten kohe. Keto mesazhe mund te dergohen automatikisht (te kontrolluar nga nje kontakt i njesise se detektimit te zjarrit) ose manualisht nepermjet operatorit nga tastiera. Te gjithe sinjalet akustike emergjente (tastiera e mbikqyresit dhe mesazhet e rregjistruara) duhet ti adresohen nepermjet kartave te kanaleve te ndryshme. Keto module menaxhojne, te kontrolluar nga nje sistem modular CPU, adresimin e sinjaleve te emergjences kundrejt amplifkatoreve. Modulet do te kene 6 hyrje programesh dhe 6 dalje per po aq amplifikatore. Ne kushte normale pune (jo ne emergjence) sinjalet e aplikuara ne keto hyrje do ti raportohen ne menyre te besueshme daljeve perkatese. Ne kushte emergjence, sinjalet VES (sinjalet emergjente akustike, rruga e te cileve duhet te jete plotesisht e diagnostikueshme) ne sistemin bus do te merren dhe do tju shkojne daljeve rregjistrimet e programuara te CPU e kontrollit. Nepermjet ketij moduli do te jete e mundur te dergohet ne te njejten kohe alarme te rregjistruara dhe mesazhe evakuimi ne zona te ndryshme.

Njësia e kontrollit akustik do te jete ne gjendje te shfaqi se bashku me centralin e detektimit te zjarrit nepermjet kontakteve I/O (8 karta hyrje/ 8 karta dalje), duke perdorur hyrje dhe / ose dalje dixhitale, kontaktet do te jene ne gjendje te marrin komanda dhe nese eshte e nevojshme te aktivizojne sinjale emergjence te jashtme. Do te jete e mundur te programohet secili kontakt gjate fazes se fillimit, ne menyre qe te coje mesazhe evakuimi ne zonat e rrezikut dhe ne te njejten kohe ti coje mesazhe alarmi zonave ngjitur. Duke perdorur nje kompjuter te lidhur me sistemin nepermjet nje softi te dedikuar do te jete e mundur te komunikohet me sistemin, duke shperndare te dhena relative te konfigurimi dhe te rregjistroje avari te mundshme qe mund te ndodhin gjate punes normale.

Në total, sistemi është në gjendje që të drejtojë zonat e ndryshme te amplifikatori i dedikuar.

Cdo zone furnizohet nga nje njesi modulare fuqie 120/240 ose 500 W RMS (ne varesi te fuqise se kerkuar) me dalje konstante tensioni (100/ 70 / 50 Volt) e siguruar nga mbrojtje termale ne pjeset finale, sistem ventilimi i forcuar dhe karte seriale per kontroll te komanduar te diagnozave. Do te pajiset me rezerve per amplifikatorin me komutim automatik ne rast avarie te pajisjes kryesore. Nje karte modulare mbikqyrese lejon kontrollin e 4 amplifikatoreve dhe rezerves. Do te jete e mundur te grupohet ky kontroll ne nje numer me te madh amplifikatoresh (4/8/12 etj) dhe rezerves.

Te gjitha pajisjet do te montohen ne rack standart 19" te ndryshem. Rack qendror i montuar dhe i testuar do te sigurohet i kompletuar me panel ventilatori, panele fallco per pjese qe nuk perdoren, dyer transparente dhe celes per mbylljen e dyerve.

Impianti i shperndarjes se zerit do te furnizohet nga nje UPS 230Vca monofaze me fuqi totale 6kVA, i plotesuar me gjithe bateri me autonomi 10 minuta.

2.12.3 Paisjet dhe rrjeti i bokseve

1. Tuner / CD / MP3 Player MP02. Kjo pajisje CD / MP3 Player gjithashtu perfshin nje disk flash per te lexuar meazhet e ndryshme. Pajisja mund te komandohet edhe me ane te nje telekomande ne largeis te madhe. mund te lexoje njekohesisht dy dalje te ndryshme.

2.Njësia qendrore e kontrollit të sistemit, së bashku me nje perforcues me kater kanale, formon nje sistem te plote te alarmit zanor për projekte të tilla. Furnizimi emergjent me energji është perfshire në perforcuesin me kater kanale. Për sistemit te alarmit te zërit ne përputhje me DIN VDE 0833-4 dhe sistemet paralajmerimet elektro-akustike emergjente ne perputhje me EN 60849., Të gjithe amplifikatoret e fuqise janë të monitoruar vazhdimisht. Në rast se një përforcues fuqie deshton, ai zevendesohet direkt nga nje perforcues tjeter zevendesues. Kalimi kryhet automatikisht nga Njësia qendrore e kontrollit të sistemit. Kabllot e bokseve monitorohen vazhdimisht për qarqe të shkurtra, shkarkimet ne tokë, nderprerje dhe perngesa te ndryshme. Zonat e bokseve qe nuk punojne jane te izoluara pa patur nderhyrje. Njësia qendrore e kontrollit të sistemit ka kapacitet memorje per mesazhe te ndryshme qe mund te perdoren per raste te ndryshme si sinjale(evakuimi, rreziku) dhe sinjale paralajmeruese(sirenat). Volumi i cdo boksi dhe i cdo kanali te amplifikatorit mund te kontrollohet. Filtra të tjere, të tille si parametra qetesues , filtra të lartë dhe të ulët të, dhe vonesat, janë gjithashtu te gatshme. Në perputhje me standardet, të gjitha shqetesimet zbulohen brenda një kohe të shkurtër, shfaqen dhe zgjidhen. Njësia qendrore e kontrollit të sistemit është e pajisur me katër kanale të pavarur përforcues për të vepruar ne total ne 8 zona altoparlantesh ose katër lupe altoparlantesh në teknologji te larte. Eshte gjithashtu e mundur për te përziere te dyja teknologjite ne një.Njësia qendrore e kontrollit të sistemit gjithashtu ka 12 kontakte hyrese, 8 prej të cilave mund të programohen për të monitoruar, si dhe 8 rezultate potencial, pa rele, një dalje audio-line, deri në 3 hyrje dhe linje audio / ose

deri në 3 hyrje mikrofon, 3 lidhjet DAL dhe një variant TWI lidhes. Ky variant ofron rrjet interneti me pajisje me internet ne kete sistem.

3. Amplifikator me kater kanale , me bateri te brendshme qe vetekarikohet per raste emergjente per furnizimin e njësise qendrore e kontrollit të sistemit. Ai ka kater kanale me 125 W secili ne teknologjine e klasit D. Amplifikatori mund te perdoret se bashku me njësine qendrore te kontrollit të sistemit.

4. Stacion dixhital zeri, Pjese e miratimeve EN54-16, 0786-CPD-20997. Me certifikate VDS. Perdoret per te zgjedhur qarqet e bokseve si dhe per te kaluar nga nje mesazh zanor ne nje muzike apo ne nje alarm. Eshte i pajisur me 12 celesa konfigurues pa pagese, 13 LED dhe nje mikrofon me qafen si mjellme. Njesia e komunikimit mund te lidhet me nje DOM(modul dalje dixhital) ose me nje DAL (linje audio dixhitale) nepermjet nje kablli cat5. Te gjitha sinjalet audio si dhe sinjalet e kontrollit transferohen ne menyre dixhitale. Me shume se kater stacione thirrese dixhitale mund te lidhen nje nje dalje DOM. Secili stacion dixhital mund te prodhoje ne menyre te simuluar dhe te marre sinjale te ndryshme nepermjet lidhjeve dhe sinjaleve te kontrollit ne brendesi te sistemit. Nje stacion dixhital mund te vendoset ne nje largesi me shume se 300 m me ane te kabllit cat5(edhe deri ne 2000m neqoftese perdoret fiber optike) dhe mund te zgjerohet ne me shum se gjashte module dixhitale. Kjo gje rrit ne 120 numrin total te celesave te gatshem per tu lidhur me njesine e komunikimit. Funksioni i mikrofonit ne stacionin dixhital eshte i monitoruar ne menyre te perhershme nga ana akustike. Mikrofoni siguron nje hyrje te brendshme dhe te jashtme audio e cila mund te perdoret per te lidhur pajisje audio si CD player. Ne ngjyre te bardhe e ngjashme me RAL 9010.

6. Boks tavanor per tavan te varur 6- 10 W, boks plastik tavanor me transformator 100 V te integruar dhe me rrjete metalike. Ky lloj boksi eshte perfekt per montim ne tavan te varur. Montohet lehte dhe pothuajse nuk duket fare. Ne ngjyre te bardhe e ngjashme me RAL 9010.

7.Boks mural, 6-10 W, me kualitet zeri, i bardhe e ngjashme me RAL 9016, e afte te riprodhoje muzike dhe mesazhe zanore.

Duke konsideruar karakteristikat teknike dhe funksionale te sistemit, dhe duke konsideruar kushtet mund te nxjerresh mesazhe alarmi, ne menyre qe te mbulosh gjithe zonat e sherbimit duhet te perdoret nje sistem shperndares akustik per te gjithe zonen. Kjo zgjidhje garanton shperndarje optimale te sinjaleve te ndryshme te siguruar, ne te njejten kohe, nje nivel te mire te sinjalit te dhene.
Linjat e bokseve duhet te testohen ne perputhje me normat dhe standartet CEI 60849 (CEI 100-55) (integriteti dhe lidhja me token). Përveç matjeve të rezistencës se linjës se plotë, duhet te vendoset nje mbylles qarku ne fund te linjes per te garantuar dhe kontrollouar

efektivitetin dhe integritetin e linjes ne vetvete. Lidhja e bokseve duhet te behet ne loop (nga i pari te i dyti , te i treti dhe me rradhe)
Boksi qe do te perdoret do te jete inkaso de i montueshem ne mur. Ato do te jene kundra zjarrit, te bardhe me kase ballore metalike. Fuqia e tyre do te jete 6W (e rregullueshme 6-3-1.5 W). Presioni maksimal akustik (energji nominale/ 1m) është 96 dB.

2.13 Sistemi i sigurise ndaj vjedhjeve

Duhet të realizohet një sistem kunder vjedhjeve për të kontrolluar dyert e hyrjes të dhomave të mëposhtme:
- Ambientet e sherbimit te perkoheshem te ilaceve
- Ambientet vezhgimit te mostrave
- Ambienti i mbajtjes se ilaceve te urgjences
- Ambienti i pergatitjes se ilaceve te pergjithshme
- Ambienti i ilaceve te pergjithshme te pacienteve
- Ambienti i kujdesit intensiv

Sistemi i sigurise ndaj vjedhjeve sherben per dhomat e listuara me siper per te siguruar furnizimin dhe vendosjen e një njësie elektronike qendrore të programueshme kunder vjedhjeve, e kontrolluar nga një mikroprocesor në gjendje për të menaxhuar më vete alarmet që vijnë nga çdo dhome e listuar më sipër.
Njësia qendrore duhet të lejojë çaktivizimin e alarmit në mënyrë të pavarur për çdo dhomë ruajtur.
Çaktivizimi i alarmit duhet të jetë në gjendje për tu menaxhuar nga njësia qendrore dhe në nivel lokal nëpërmjet pajisjeve elektronike të koduara të rëndësishme të instaluar jashtë çdo dere të dhomave të ruajtura.
Kontrolli i dhomave duhet të kryhet nëpërmjet instalimit të kontakteve magnetike në çdo derë të dhomave të ruajtura.
Njësia qendrore e hajdut-provë duhet të jetë e instaluar në dhomën e mbikqyrjes në katin e parë të ndërtesës dhe duhet të jetë e gatshme për kontrollin ne distance me anë të një kompjuteri personal.

2.13.1 Linjat e shperndarjes se zerit

Nga sistemi i shperndarjes se zerit i përshkruar më siper, do të realizohen linja të reja të shpërndarjes të sinjalit akustik përmes kabllove me shume fije me veshje FG10OM1 0.6 / 1KV CEI 20-22, 20-37, 20-38 e 20-45 te vendosur në kanalet për shpërndarjen dytesore te rrymave te dobeta në tavanet e rreme në rrugët horizontale të korridoreve, dhe mbi kanalinat e rrymave te dobeta në perputhje me kollonat elektrike.

2.14 Sistemi i monitorimit

Duhet te instalohet nje sistem monitorimi ne gjendje te :
- të marrë informacion në kohë reale në lidhje me gjendjen e pajisjeve dhe parametrat fizike kryesore te tyre;
- per te menaxhuar alarmet dhe anomalite duke monitoruar dhe analizuar informacionin që vjen, per ta filtruar dhe per te bere dërgimin e tyre te stafi i mbikëqyrjes;
- per të ndërtuar një histori të ngjarjeve;
- te raportoje perkohesisht me drite ILED raportin e përkohshme, në mënyrë që të regjistrojnë parametrat kryesorë të sistemit
- per të ndërtuar statistikat dobishme për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e përbërësve;
- per te komanduar me telekomandë, nga secila pikë e aktivizuar, pajisjet me sistemet e kontrollit të sigurisë së lartë.

Në realizimin e pajisjeve, objekt i kësaj kontrate, ky sistem duhet të japë informacion për çdo gjë të nevojshme për ndërfaqjen e gjendjes se pajisjeve elektrike, mekanike dhe të sigurisë, të instaluar në kompleksin e ri multi-funksional, dhe pikërisht per:
- Per të shfaqur të gjitha njësitë periferike të sistemit te vezhgimit vendosur në panelet kryesore dhe dytesore te shpërndarjes elektrike
- Per të shfaqur një sinjal te gjendjes lidhur me sistemin mekanik.

Ndërfaqja do të ndodhë nëpërmjet pajisjeve modulare qe do te instalohen sipas udhezuesit DIN te predispozuar për:

- marrjen e gjendjes nga kontaktet NO dhe NC
- marrjen e komandave përmes një dalje rele
- marrjen e sinjaleve 0-20mA
- marrjen dhe përpunimin e sinjaleve të tensionit
- marrjen dhe përpunimin e sinjaleve aktuale
- marrjen dhe përpunimin i sinjaleve të frekuencave

Pajisjet e përmendura më sipër duhet të jetë te instaluar në kuadro te posacem dhe afër me kuadrot dhe sistemin për të kontrolluar kuadrot elektrike:

Detaje të rëndësishme për përbërjen e kuadrove te ndryshem per tu monitoruar janë raportuar në specifikimet e materialeve.

Pozicioni i intalimit te kutise se pajisjve te monitorimit te sistemit eshte pershkruar ne vizatim.

Komunikimet midis marrjes se sinjalit dhe komandimet e ndryshme me ane te moduleve duhet te realizohen me ane te protokollit LonWorks.

Ky rrjet komunikimi duhet te lidhet mes njeri-tjetrit nga percjelles BELDEN 8471 siç tregohet në projekt.

– Sistemi i Kontrollit të monitorimit duhet të përfshijë 1 post pune me operatore qe do te kontrollojne sistemin një në zyren e kontrollit te spitalit.
– Posti i punes operatore duhet të bëhet nga:
– Kompjuteri Personal me parametra: INTEL Pentium IV - HD 120GB - RAM 1GB - ETHERNET 100/1000 card (Konfigurimi MINIMALE) i pajisur me karte ndërfaqe për kycje në rrjetin LonWorks
– Printer
– Monitor 17 "

Ajo duhet gjithashtu të realizojë nje shfaqje grafike me video te pajisjeve sipas kësaj kontrate. E njëjta gjë duhet të bëhet edhe për sistemet mekanike.

Përshkrimi i të dhënave te sistemit ndodh nëpërmjet video-slideve alfanumerike dhe grafike me rezolucion minimal 640x480 pixel me 16 ngjyra. Çdo video-slide menaxhon mesatarisht 20-3 0 pikë fizike ose pseudo-pikë.

Në postin e punes kryesor të rrjeteve të ndryshme, do të shfaqen tipologji të ndryshme të video-slideve grafike.

Video-slidet e pershtatshme planimetrike me alarme akumulative e drejtojne operatorin ne perzgjedhjen dhe detajimin e sinjalit te alarmit.

2.14.1 Pikat e monitorimit per sistemet elektrike

Duhet te siguroje transferimin e sinjaleve dhe komandimeve te meposhtme te sistemi i monitorimit:

a) Per Kuadrot Elektrik te Pergjithshem te godines:

KUADRI	TIPI I SINJALIT/VEPRIMIT	SASIA Y
	MATJA	
LVSBAB	Matja e tensionit per faze	4
LVSBAB	Matja e rrymes per faze	12
LVSBAB	Matja e fuqise aktive	4
LVSBAB	Matja e fuqise aktive	4
	MARRJA E GJENDJES	
LVSBAB	Celesi i ndezur	98
LVSBAB	Celesi i fikur	98
LVSBAB	Celesi mbroites i hapur	98
LVSBAB	Kontrolli i celesit te dhomes	15
LVSBAB	Telekomandimi i celesit	15
AUXB48VC	Anomali e pergjithsme	1

Q24Vcc Magnet per dyert REI	Anomali e pergjithsme	1
UPS-ES0,5	Anomali e pergjithsme	1
UPS-ES0,5	Mbingarkese	1
UPS-ES0,5	Nuk ka bateri	1
UPS-ES0	Anomali e pergjithsme	1
UPS-ES0	Mbingarkese	1
UPS-ES0	Nuk ka bateri	1
	TELEKOMANDIMI	
LVSBAB	Celesi/Kontaktori i hapur	10
LVSBAB	Celesi/Kontaktori i mbyllur	10
Q24Vcc Magnet per dyert	Kontrolli i gjendjes per dyert kundra zjarrit	10
Q24Vcc Magnet per dyert	Kontrolli i gjendjes per damperat kundra zjarrit	10

a) Per kuadrot elektrike te zones ne ndertese:

KUADRI	TIPI I SINJALIT/VEPRIMIT	SASIA
	MARRJA E GJENDJES	
ALL	Celesi i ndezur	240
ALL	Celesi i fikur	240
ALL	Celesi mbrojtes i hapur	240

KUADRI	TIPI I SINJALIT/VEPRIMIT	SASIA
	TELEKOMANDIMI	
ALL	Celesi/ Kontatori i hapur	40
ALL	Celesi/ Kontatori i mbyllur	40

2.14.2 Pikat e monitorimit per sistemin hidro-mekanik

Duhet te siguroje transferimin e sinjaleve dhe komandimeve te meposhtme te sistemi i monitorimit:

SISTEMI	TIPI I SINJALIT/VEPRIMIT	SASIA
	MARRJA E GJENDJES	
ANA VERIORE NJESI QENDRORE E UTA	Gjendjen e motorreve elektrike (ventilatoret)	4
ANA VERIORE NJESI QENDRORE E UTA	Gjendjen e motorreve elektrike (ventilatoret)	4

2.15 Sistemi i video-citofonise dhe citofonise

2.15.1 Sistemi i video-citofonise

Duhet te insalohet nje video citofoni e jashtme me dy butona ne dhomat e meposhtme:

- Të gjitha hyrjet e spitalit.
- Hyrja nga jashtë te zona e mostrave në katin perdhe
- Hyrja nga jashtë te reparti i ndihmës së parë.

Video citofonite e mesiperme duhet te komunikojne me njesite e brendshme qe ndodhen te dhomat e rojeve ne secilen zone.

Sistemi duhet te dorezohet i kompletuar, te punoje ne rregull dhe te testohet.

2.15.2 Sistemi i citofonise

Duhet të realizohet një sistem citofonie qe tu sherbeje dhomave te meposhtme:
- Dhoma e kujdesit Intensiv
- Dhoma e reanimacionit
- Angiografia

Stacionet e citofonise më sipër duhet të komunikojnë mes njëri-tjetrit dhe me pajisjet e brendshme te instaluara në dhomat e mjekut në secilin repart përkatës.
Aparatet e citofonise duhet te jene te predispozuar qe te komunikojme pa perdorimin e duarve dhe te jene te pershtatshem te instalohen ne ambiente sterile, te perbere prej materialeve me standarte te larta dhe te kene karakteristika per te garantuar jetegjatesine nga produkte qe perdoren neper ambiente qe sterilizohen.
Sistemi duhet te dorezohet i kompletuar, ne pune dhe i testuar.
Pozicioni final do te percaktohet gjate zbatimit, ne perputhje dhe me kerkesat e klientit dhe teknikeve te tij.

2.15.3 Karakteristikat e te pajisjeve citofonike

Citofonia elektronike me tastiere numerike me membrane dhe liste te numrave ne pamje te perparme, inkaso me dimensione 130x265x60mm(LxHxP) qe furnizohet me tension 18 dhe 40Vcc me fuqi 3W.

Shkalla e mbrojtjes IP65

2.15.4 Karakteristika e njesise qendrore

Njesia qendrore me me shume se 16 perdorues me dy kanale te vecanta komunikimi duke perfshire ushqyesin 36Vcc me dimensione 234x396x96 mm; (1 ushqyes 20x155x42 mm) duke pasur karakteristikat e mëposhtme:

- Të zgjerohet deri në 32 përdorues me kabllo;
- me dy menyra komunikimi me ze direkt dhe me butona;
- Të njohin një numër jo ekzistues;
- Të realizoje thirrje emergjente;
- Për të sinjalizuar nëpërmjet një sinjali me drite në rast se përdoruesi mungon;
- E transferimit të thirrjes dhe për të mbajtur linjën te zene, gjatë një bisede dhe gjatë thirrjes së personit të tretë;
- E transferimit te thirrjes te një person i tretë;
- Të ketë, për një përdorues të vetëm, filtrimin e thirrjeve që vijnë nga një përdorues tjetër;
- Për të para-përcaktuar 3 grupe përdoruesish për tju komunikuar nje njoftim te vetem;
- Për të kryer një njoftim të përgjithshem ose një thirrje të urgjencës me anë të një sinjali të veçantë për të gjithë përdoruesit;
- Për të para-përcaktuar një përdorues të cilët i cili mund ti pergjigjet thirrjeve prioritare;
- Të hapë një ose dy dyer me një thirrje që mund të transferohet në një pikë qendrore ose në një pikë tjeter për të identifikuar nga cila dere vjen thirrja.

2.16 Sistemi i vezhgimit me kamera

2.16.1 Te pergjithshme

Eshte parashikuar sistemi i vezhgimit me kamera ne zonat e meposhtme:
- Hyrja e urgjencës
- Hyrja e ambulances
- Vëzhgimi i urgjencës
- Dhoma e Reanimacionit
- Kujdesi intensiv
- Dhoma e pacientëve

Në çdo dhomë të mbikqyrjes të çdo kati duhet të ketë tuba PVC D=20 mm per çdo dy kamera kuti si dhe monitoret e vezhgimit.

2.16.2 Karakteristika teknike

Kamerat:

Kamerat e brendshme IP

Kamerat e brendshme IP permbajne nje shumellojshmeri opsionesh te ndryshme. Kamerat eshte e pajisur me sensor imazhi Super Low Lux CMOS i cili lejon kameren te siguroje nje pamje reale me ngjyra ne erresire. Kamera ka nje porte per mini USB e cila suporton lidhje wireless nepermjet nje adaptori Wi-Fi(i ndryshem) ose duke e ruajtur ne hapesire e jashmte duke persorur nje USB te madhe.

Kerkesat minimale:
- H3D1F2X, 2.5-6 mm VFAI, F1.2,
- Shtrirja e pamjes ne kende horizontalisht: 87.9°Tele: 37.9°,
- Shtrirja e pamjes ne kende vertikale:48. 6°Tele: 21.3°Rrjeti,
- Dite/Nate, me kend shikimi,
- Mini-dome e brendshme,
- Progresiv Scan CMOS 1/4"",
- Rezolucion 720p,
- 24 VAC or PoE IEEE 802.3af
- Klasi 1,
- Lartesia e instalimit264 cm
- Ngjyra e bardhe e ngjashme me RAL 9010

Kamera e jashtme IP

Kamera e jashtem duhet te jete (IP66 and IK10) dhe e dizenjuar per mjedis me temperatura ekstreme. duke qene se eshte kamera dhe per ditene dhe per naten ajo duhet te jete e pajisur me sensor super low lux CMOS me te cilin kamera eshte e afte te siguroje nje pamje reale me ngjyra edhe kur eshte nate.

Kerkesat minimale:

• rezolucion 1080p ne format HD
• me funksion Dite/Nate me filter te zevendesueshem
• Rezistente ndaj vjedhjeve dhe dizajn robust IP-66
• E ndertuar me ndricues IR me 30 m (45*) distance pamjeje
• Rregullimet e jashtme sigurojne akses te lehte
• 3–9mm (10-23mm*) MZF (afrim i motorizuar / Fokus) lente VFAI
• Kendi i shikimit:
▪ Thellesi 93° (W) ~ 38° (T) ± 5°,
▪ Lartesi, 73° (W) ~ 30.4° (T) ± 5°,
▪ Vertikal 56.6° (W) ~ 23° (T) ± 5°,
• Sasi IR LED,
• 16 IR LEDs,
• Nderfaqe,
• Internet 10/100,
• Protokoll, HTTP, TCP, UDP, SMTP, FTP, DHCP, NTP, UPnP, DynDNS, 3GPP/ISMA RTSP, PSIA,
• Vepron ne -20 °C ~ 50 °C / -4 °F ~ 122 °F,
• Lageshtira 10% to 90% (pa kondesim),
• Ngjyra e kuqe e ngjashme me RAL 9010

Rregjistrator Rrjeti i Videos NVR

NVR (Rregjistrator Rrjeti i Videos) rregjistron te dhenat video dhe audio nepermjet rrjetit TCP/IP.
NVR , Memorje 4TB RAID5, 16 kanale, Performance Package NVR duhet te jete nje sistem survejimi i hapur, fleksibel dhe ne shkalle. Duke
perdorur kamerat HD, NVR duhet te jete nje rregjistrator video HD i fuqishem dhe shikon kliente per instalime te medha ose te vogla. Eshte nje platforme e hapur dhe suporton pajisje te treta te integrohen me ane te suporteve sipas standarteve PSIAdhe ONVIF(duke perfshire pajisje te profilit-S), standart protokoll xhirimi ne kohe reale (RTSP) dhe pajisjeje integruese duke perfshire suport per kamera 360°.NVR siguron perdorim te lehte nga kompjuteri dhe programeve telefonike.NVR duhet te jete i pajisur me nderfaqeste perdoruesit i cili ofron nje perdorim te pasur.

Kerkesat minimale:
- Suporton deri ne 16 kanale
- Kapacitet HDD deri ne 4TB RAID5,
- 2 porta interneti RJ-45LAN Port - 2 x Gigabit.
- Sistem vezhgimi - Windows XP/ Vista/ 7,
- Identifikim - ID, password,
- Protokol - TCP/IP, DHCP, DNS, HTTP, FTP, NTP, SMTP, UPnP.
- Menyre rregjistrimi - e vazhdueshme,
- Rregjistrim me levizje te ngadalesuar,
- Rregjistrim me levizje te pershpejtuar,
- Rregjistrim te programuar (ditor, javore, dite specifike),

- Rregjistrim audio,
- Rregjistrim IO,
- Rregjistrim manual.

Kontrolluesi i Sistemit

Kerkesat minimale:
Sistemi kryesor:
Percakton zonen e percaktuar nga vizatimet katrore ne vend te vizatimit te nje linje ne numerimin e objektit dhe alarmit nga nderhyrjet
Zgjat rregjistrimin pertej maksimumit te videos pergjate rregjistrimit te levizje ne menyre qe te filloje secili klip me nje kornize te vecante, i cili nuk lejon nderprerje nepermjet mbarimit dhe fillimit te dy klipeve.

Monitori LCD

Kerkesat minimale:
- ekran i hapur 22" LCD
- Matrice aktive TFT-LCD-16:9
- Pikseli 0.294mm DP
- Niveli i kontrastit: 400:1
- Ngjyrat 16.7m
- Video: Dsub/DVI
- Koha e pergjigjes 20ms
- Kendi i shkalles se shikimit: 160 grade
- Rezolucioni maksimal : 1360x768/1280x768
- I afte te shfaqe me shume se 16 piktura ose te ndahet deri ne 16 ekrane me te vegjel me te njejten madhesi
- i montueshem ne mur ose te rrije ne kembe

Raku

Njesia qendrore e procesimit e nje video rregjistratori dhe lidhjes jane vendosur ne nje rak te mbyllur 19" me hapesire per 36 njesi. Raku eshte model baze i prodhuar nga fabrika me komponente perkates: dere e perparme me pamje sigurie 3mm dhe celes te pershtatshem te mbyllur, dere celiku flete e gjere 2mm nga mbrapa me hapje 130°.
Dimensione te peraferta jane 600x600x1715mm.
Ndertimi i rakut duhet te behet ne perputhje me EN ISO 9000, 9002 and DIN 41488.

2.17 Sistemi i tv - antenes

2.17.1 Sistemi i tv - antenes

Duhet te instalohet nje antene qendrore me njesi amplifikuese dhe miksim modulesh, e vendosur ne cati, e predispozuar per kapjen e sinjalit tokesor analog ne banden UHF dhe VHF dhe sinjalit dixhital satelitor.

Njesia e amplifikatorit duhet te ushqehet me nje linje direkte nga kuadri i sherbimeve te perbashketa te nderteses.
Hekuri i suportit te antenes duhet te kete edhe aksesoret e pershtatshem si kapese dhe bullona, dhe te jete i perbere prej celiku te galvanizuar.

2.17.2 Linja e sinjalit

Linja zbritëse duhet të jetë e perbërë nga kabllo koaksial me sa me pak humbje dhe me veshje bakri me strukture te holle; duhet te instalohet neper tubo te dedikuar ne kollonat elektrike, ne hapesirat speciale te sistemeve dhe ne kanalinat e dedikuara te sistemit ne katet e ndryshme te nderteses.

2.17.3 Prizat e sinjalit TV

Ne pozicionet e treguara ne vizatime duhet te instalohen priza TV ne kuti te dedikuara vetem per kete sistem. Keto priza duhet ti perkasin te njejtes seri si prizat e tjera.

2.18 Sistemi i oreve

Një orë spitali siguron saktesi, sinkronizimin e oreve te te gjithe punonjesve te spitalit. Keto ore duhet te lidhen me njera tjetren dhe me nje ore qendrore. Ky sistem sherben per te siguruar infermieret, doktoret, dhe te gjithe stafin qe ora eshte e njejte ne cdo dhome te nderteses, gje qe eshte e rendesishme per stafin e spitalit per shume arsye.

Nje sistem i ores se sinkronizuar do te mbaje shfaqjen konstante te ores dhe te siguroje qe cdo dhome, korridor tju lejoje infermiereve dhe doktoreve te bejne rregjistrime te sakta edhe kur levizin nga nje pavijon i nderteses ne tjetrin.

Ora qendrore sinkronizon te gjitha oret e tjera dytesore me ane te kabllimit dhe mban precize dhe siguron kohen te te gjihta oret.

Ne nje rrjet kabllimi, oret dytesore mund te sinkronizohen nga impulse rryme ose sinjale dixhitale qe vijne nga ora qendrore.

Pergatiti:

Ing. Deshira Mena

Seksioni 3 - Specifikimet Teknike per Punimet Mekanike

MATERNITETI I RI

Tabela e përmbajtjes

3.1. Instalime e Mbrojtjes Kundra Zjarrit;
3.2. Instalimet e Furnizimit me Uje;
3.3. Instalimet e Shkarkimeve te Ujrave te Zeza dhe te shiut;
3.4. Instalimet e Sistemit te Ngrohje-Kondicionimit.
3.5. Instalimet e Sistemit te Gazit Medikal

3.1. Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri.

3.1.1.1 Tub celiku pa tegel + rakorderi.

- Gjatesia standarde: 6000 mm (+/- 3%)
- Marka e tubave pa saldim (me filetim): EN 10255 S
- Temperatura e punes : -10 ˚C/+110 ˚C
- Prova hidraulike : 50 bar
- Presioni nominal ne temperaturen e ambientit :10 bar

Diametri nominal DN	Diametri i jashtem De	Diametri i jashtem	Diametri i jashtem		Spesori	Pesha
			max	min		
	mm	inc	mm	mm	mm	kg/mt
10	17.2	03-Apr	17.5	16.7	2.3	0.85
15	21.3	01-Feb	21.8	21	2.6	1.22
20	26.9	¾"	27.3	26.5	2.6	1.58
25	33.7	1	34.2	33.3	3.2	2.44
32	42.4	1 1/4	42.9	42	3.2	3.14
40	48.3	1 1/2	48.8	47.9	3.2	3.61
50	60.3	2	60.8	59.7	3.6	5.1
65	76.1	2 1/2	76.6	75.3	3.6	6.51
80	88.9	3	89.5	88	4	8.47
100	114.3	4	115	113.1	4.5	12.2

3.1.1.4 Elektroda Saldimi.

Elektrodat perdoren per proceduren e saldimit dhe jane te bera prej material celiku,me lidhje elementesh te tjere dhe te veshura me material flus anti-skorie.

3.1.1.4 Xhunto Anti-sizmike

Xhunto anti-sizmike eshte e perbere nga metali te kalandruar prej inoksi. Ato vendosen pergjate linjave per te eleminuar efektet e levizjeve te struktuarave per arsye te ndryshme.karaktristikat e tyre jane si me poshte.

Modeli 1



Modeli 2



Mod.	Kompensimi					Permasat				
	D	h+	h-	α ±	e ±	A	Lt	De	Dr	s
1	1/2''	10	10	35	5	18	170	-	-	-
	3/4''	10	10	30	5	20	180	-	-	-
	1''	10	10	25	6	20	200	-	-	-
	1 1/4''	15	15	30	10	20	220	-	-	-
	1 1/2''	20	20	25	10	20	240	-	-	-
	2''	20	20	20	10	25	240	-	-	-
2	65	20	20	20	10	-	150	185	145	24
	80	20	20	25	10	-	160	200	160	24
	100	20	20	25	10	-	170	220	180	26
	125	25	25	4	6	-	250	250	210	28
	150	25	25	4	6	-	250	285	240	28
	*Permasat ne mm									

KARAKTERISTIKAT KONSTRUKTIVE	
Pjeset kontaktuese me fluidin - manikota te filetuar - kalandruar	Inoks AISI 304 /Inoks AISI 321
Fllanxha	Çelik

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE	
Presioni maksimal i jashtem	100 kPa
Presioni i testimit	200 kPa
Temperatura e pranuar	-10 ÷ +450 ºC
Lidhjet e filetuara	M UNI ISO 7/1
Lidhje me fllanxha	PN 16 UNI 2278

3.1.1.6 Elemente Konstruksioni

Konstruksione metalike dhe armatura montimi profile metalike, Prizhonier M12/M10/M8, bulloneri, Fasheta plastike dhe termike, Upa metalike betoni ,perçina, shirit, gozhde, silikon, shkume, ngjites, pe lini.

- Distanca e hapjes – D=132-137 mm
- Permasat e fashetave -deri ne 4”
- h=83 mm
- Largesia B =207 mm
- Ngarkesa max F=400 N
- Momenti i mberthimit= 3 Nm
- Perberja e materialit =Celik inox, EN 10088, AISI 316Ti / AISI 316L
- Rezistenca termike -50 - 120 °C
- Materiali i izolimit te tubit- Gome EPDM
- Durueshmeria e materalit te gomes 50° ±5°
- Izolimin akustike 18 dB (A)



UPA qe perdoren per montim direkt ne mure ose tavan

- Dimensioni i inkastrimit :20 mm
- Gjatesia e inkastrimit 115mm
- Thellesia e shpimit- 85 mm
- Madhesia e celesit 24 mm
- Konfigurimi i kokes – Koke hegzagonale



UPA qe perdoren per montim te varur me prizhinier

- Dimensioni i inkastrimit :M12
- Gjatesia e inkastrimit 50 mm
- Diametri i puntos 15 mm
- Konfigurimi i kokes – Filetim i brendshem
- Perberja e materialit : zingato A4 (SS316)



Fashetat termike - perdoren per montimin e tubave ne taracen e objektit dhe sherbejne per mbrojtjen termike te tyre.

- Diametri – D=711.2 mm
- Largesia e spesorit seksional te kalueshem (bxs) – 140x60mm
- Largesia B =950 mm
- Ngarkesa max F=17000 N
- Momenti i mberthimit= 3 Nm



- Distanca A=900 mm
- Densitet 250 kg/m3
- Rezistenca termike - 45 - 105 °C
- Diametri – D=711.2 mm

Konstruksion metalik



- Lartesia – 41mm
- Largesia -6mm
- Spesori – 2 mm
- Pesha per meter= 2080 g
- Perberja e materialit : S250GD - DIN EN 10346

3.1.2.1 Kartelat e sinjalizimit

Kartelat e sinjalizimit qe i perkasin kategorise paralajmeruse dhe treguese jane te formatit te dimensioneve dhe materialit te meposhtem :

Kartelat e sinjalizimit qe i perkasin kategorise vepruese jane te formatit te dimensioneve dhe materialit te meposhtem. Kartelat e sinjalizimit jane ne perputhje me normen EN ISO 7010.

Simboli conformi D.L. 493 del 14/08/96 - CEE 92/58 - UNI

3.1.3.1 Grupi i lidhjes me autopompen per hidrant, DN70

Grup i lidhjes me autopompen per hidrant, DN70. Vendosja ne kase te jashtme, llamarine çeliku te emaluar ne ngjyre, RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz- Sipas standardit ISO 228. Presioni i punes 1.2MPa.

3.1.3.2 Kaset dhe hidrant zjarri i brendshem.

Kaset + hidrant zjarri i brendshem. Kase brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyre te kuqer RAL 3000 - UNI 9227, me baze rezine. Dimensionet (370x610x190) mm, tub fleksibel 30 m. Aksesoret: Saracineske nderprerese 1½" me fileto sipas standartit to ISO 7-1, lançe DN 45, sipas EN 14540.

3.1.3.3 Fikse zjarri me CO2

Bombel e lyer me boje ngjyre te kuqe (RAL 3000) e levizshme me CO2. Mund te perdoret per fikjen e zjarrit ne pajisjet elektrike si dhe rreth tyre pasi eshte jo percielle. Perdoret vetem nje here. Jane efektiv dhe ne fikjen e zjarreve qe perfshin klasa B e zjarrit. Kapaciteti Normal 5kg. Dimensionet Ø 140 x 765 mm.

3.1.3.4 Fikese zjarri karrelato

Sipas normatives UNI 5867 e lyer me ngjyre të kuqe me pluhur aposidik poliuretanik dhe rezistente ndaj gaditjeve, rrezeve UV , klimës dhe atmosferës gërryese industriale. Është e kompletuar me një valvol 2” prej tunxhi si edhe një valvolsigurie kundër mbipresioneve, një manometër që kontrollon presionin.

3.2. Sistemi i Furnizimit me Uje.

3.2.1.1 Tubo Pex-Sistem i furnizimit me uje sanitar + rakorderi (te ftohte /ngrohte)

Tubo polietilen i rrjetezuar me densitet te larte me barriere antioksigjen, lehtesisht i perkulshem, i termoizoluar me jetegjatesi te larte per kushte dhe presione normale pune dhe temperature pune -40°C ÷95°C sipas standartit UNI EN 53961.



Diametri i jashtem	mm	14	16	18	20	26	32
Diametri i brendeshem	mm	10	12	14	16	20	26
Spesori	mm	2	2	2	2	3	3
Gjatesia e ambalazhimit	m	50	50	50	50	50	25
Densiteti	Kg/m^3	33					
Rezistenca ne terheqe	N/mm^2	>0.18					
Zgjatimi i shtreses izoluese	%	>80					
Pershkrueshmeria e avujve ne shtrese	mg/Pa	<0.15					
Transmetimi i nxehtesiste ne shtresen izoluese	W/mK	0.0397					
Transmetimi i nxehtesise ne tub	W/mK	0.066					

3.2.1.2 Brryla AL-PEX D 16x1/2 F, me presim.

Berrylat AL-PEX sherbejne per lidhjen e linjave te furnizimit me uje te ftohte dhe te ngrohte me pajisjet sanitare-se. Ato duhet te ofrojne lidhje te persosur, rezistence te larte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, pesha te lehta, jetegjatesi mbi 25 vjet dhe qendrueshmerise ndaj goditjes mekanike.

3.2.1.3 Tub plastik PP-R per sistemin e furnizimit me uje sanitar (te ftohte / ngrohte) dhe rakorderite perkatese.

Eshte nje tub i perbere nga 3 shtresa per presion pune Pn 16 , me koeficient bymimi 0.030mm/m° C , sipas standartti DIN 16962, DIN EN ISO 15874.

Diametri i jashtem	mm	20	25	32	40	50	63	75	90	110
Diametri i brendeshem	mm	14.4	18.0	23.2	29.0	36.2	45.8	54.4	65.4	79.8
Spesori	mm	2.8	3.5	4.4	5.5	6.9	8.6	10.3	12.3	15.1
Pesha	kg/m	0.157	0.244	0.391	0.608	0.948	1.490	2.120	3.037	4.546
Mbajtja	lt/m	0.163	0.254	0.423	0.660	1.029	1.647	2.323	3.358	4.999

3.2.1.13 Termoizolim tubi.

Material me cilesi te larte per termoizolimin e tubave hidraulik, per temperature pune - 100 °C ÷ 105 °C. Certifikuar sipas normes UNI EN ISO 9002, DIN 19988.

Temperatura gjate shfrytezimit	-100 °C ÷ +105 °C
Transmetimi i nxehtesiste	Ne temperature mesatare 0 °C λ ≤ 0.034 W/(m.K)
Reagimi ndaj zjarrit	Klasa 1, Normat: UNI 8457, UNI 9174
Faktori i rezistences ndaj difuzionit te avullit te ujit	μ ≥ 5000 (DIN 52615), μ = 125000
Rezistenca ndaj agjenteve	E mire; eshte e nevojshme qe te perdoret per tubat.
Vetite e materialit	Ne perputhje me DIN 1988 pjesa 7 per te shmangur korrozionin ne tuba.
Aromerat	Neutrale
Ngjyra	E zeze
Gama	Spesori nga 6 mm deri ne 32 mm. Spesori i tubit nga 6 mm deri ne 32 mm me diameter nga 6 mm deri ne 160 mm.

3.2.1.20 Saracinesk kendore me hollandez (1"- 3/4")

